



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“TIRANA PARKING, BASHKIA TIRANË”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
FINANCIAR & PËRPUTHSHMËRIE
NË
“TIRANA PARKING, BASHKIA TIRANË”

Korrik 2023

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	2-9
1.	Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit	2
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	2
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8
II.	HYRJA	2
1.	Titulli.....	2
2.	Marrësi.....	2
3.	Objektivat dhe qëllimi.....	2
4.	Identifikimi i çështjes.....	2
5.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	3
6.	Përgjegjësitë e audituesve.....	3
7.	Kriteret e vlerësimit.....	3
8.	Standardet e auditimit.....	4
9.	Metoda e auditimit.....	4
10.	Dokumentimi i auditimit.....	4
III.	PËRSHRIMI I AUDITIMIT.....	5
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	5
2.	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit.....	5
2.1	Pika 1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik	5
2.2	Pika 2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit	32
2.3	Pika 3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	36
2.4	Pika 4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve	64
2.5	Pika 5 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	98
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	101
	Masa Organizative	101
	Masa për Eliminimin e Efekteve Negative	109
V.	Lista e dokumentacionit të auditimit.....	110
VI	ANEKSE.....	111

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së nr.317/1 Prot., datë 18.04.2023, për periudhën nga data 01.01.2019 deri më datë 31.12.2022 si dhe zhvillimin e auditimit “Financiar dhe të Përputhshmërisë” nga data 19.04.2023 deri më datë 12.06.2023 në subjektin Tirana Parking, Bashkia Tiranë, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- E.K (përgjegjës grupi)
- A. F. (anëtarë)
- S. J. (anëtarë)
- K. P. (anëtarë)

Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje	Ref.	Rëndësia	Rekomandimi
1	Tirana Parking nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar dhe përditësuar kuadrin e plotë rregullator të shkruar për këtë qëllim. Për periudhën objekt auditimi nuk është krijuar GMS dhe caktuar koordinatori i riskut, nuk ka hartuar një strategji në menaxhimin e riskut, ku t'i kushtohet rëndësi menaxhimit dhe sigurisë së sistemeve të informacionit; mungesa e GMS ka sjellë mungesën e hartimit të planeve strategjike dhe vjetore të njësisë, planeve dhe raporteve vjetore mbi problematikat që hasen dhe parashikim për zgjidhjen e tyre gjatë veprimtarisë së njësisë publike, nuk ka krijuar një strukturë organizative efektive, mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manuali MFK miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i përditësuar me nr. 108/2016.	2.1	E Mesme	1.2 Drejtori i Përgjithshëm, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin e Planit Strategjik dhe Vjetor institucional dhe Rregullores së konfliktit të interesit, për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për krijimin e GMS dhe caktimin e koordinatorit të riskut, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, të përditësojë Rregulloren e brendshme, gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit të njësisë, ku ti kushtohet rëndësi e veçantë menaxhimit dhe sigurisë së sistemeve të informacionit të implementuara, hartimin e planit të kontrollit të brendshëm të unifikuar të njësisë. 1.2 Nëpunësi Autorizues dhe

				<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, të marrin masa për krijimin e një strukture efektive, ku të përcaktohen kriteret e veçanta për punësim të çdo pozicioni, njoftimin e vendeve të lira në AKPA.</p> <p>1.3 Nëpunësi Autorizues dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme të marrin masa për vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësive, për të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që i atribuon ligji në dobi të komunitetit.</p> <p>1.4 Nëpunësi Zbatues të ofrojë te Nëpunësi Autorizues mbështetje me përgjegjësinë që i ngarkojnë aktet ligjore, në lidhje me ngritjen dhe zbatimin e sistemit të MFK si dhe në rritjen e cilësisë së proceseve të këtij Sistemi.</p> <p>1.5 Njësia e Auditimit të Brendshëm Bashkia Tiranë, të rivlerësojë Tirana Parking me koeficient risku “të lartë”, për të ndryshuar frekuencën e auditimit mbi këtë njësi, me qëllim përmirësimin e performancës institucionale në dobi të komunitetit.</p>
2	<p>Nga auditimi i pasqyrave financiare, rezultoi se shënimet shpjeguese nuk janë të plotësuara me detaje dhe informacione sqaruese të nevojshme për t’u pasqyruar, përveç atyre informacioneve që paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të aktiveve neto/fondeve neto. Plotësimi i tyre është realizuar pjesërisht dhe nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, në të cilin jepen informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë dhe të</p>	2.2	E Mesme	<p>Tirana Parking, të marrë masat që shënimet shpjeguese të plotësohen në mënyrë të saktë dhe të detajuar, në përputhje me SKK, duke dhënë informacionin e nevojshëm dhe të domosdoshëm për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore</p>

	<p>qartë të pasqyrave financiare në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 3.7 “Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale”, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.</p>			
3	<p>Për vitet objekt auditimi 2019 – 2022, në Drejtorinë e Tirana Parking nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit, duke sjellë si rrjedhojë mungesën e vlerësimit të gjendjes reale të aktiveve, amortizimit të tyre dhe përcaktimin për nxjerrje jashtë përdorimit, sipas gjendjes së vlerësuar dhe nevojës në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pika 95 - 99. Në raportin e inventarizimit fizik për vitin 2019, komisioni i inventarizimit ka konstatuar se në magazinën e Tirana Parking ka pajisje elektronike të cilat kanë rezultuar të amortizuara, si kompjuterë, ngrohës elektrikë, tableta dhe pajisje për sheshet. Gjithashtu ka edhe materiale që duhet të asgjësoheshin, si bluza dhe uniforma, që kanë qenë të dëmtuara dhe të mykura. Për të shtuar më tej edhe një sasi biletash parkimi në rrugë, të cilave u kishte kaluar afati i përdorimit sipas vitit të përcaktuar në to, për të cilat komisioni është shprehur se duhet të asgjësoheshin. Nga ana tjetër, nuk është hartuar asnjë urdhër për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së këtyre aktiveve dhe gjithashtu nxjerrjen jashtë përdorimi të atyre aktiveve, të cilat janë konstatuar në kushte të papërshtatshme për t’u ripërdorur, si pasojë e dëmtimit të tyre përgjatë kohës së qëndrimit në magazinë në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pika 102 – 106 dhe 107 – 120.</p> <p>Në raportin e inventarizimit fizik për vitin 2022, komisioni i inventarizimit ka konstatuar se disa prej tabelave sinjalizuese për institucionin, sheshet e parkimit mbi dhe nëntokë dhe terminalet, që janë të vendosura për sinjalizimin e vendndodhjes së tyre, kanë qenë të dëmtuara. Fenomen ky, i cili ka qenë prezent edhe gjatë procesit të inventarizimit të vitit 2021, por në raport nuk specifikohet nëse bëhet fjalë për të njëjtat destinacione të tabelave si të vitit të kaluar, apo për tabela që janë evidentuar vetëm për vitin 2022. Konstatime të mëtejshme janë bërë edhe për tabelat e parkimit publik me pagesë, që në disa raste kanë pasur ndryshime dhe disa prej tyre kanë qenë të dëmtuara, madje edhe disa kabina të shesheve të parkimit kanë qenë gjithashtu të dëmtuara. Konstatimi tjetër ka qenë për njësitë qendrore dhe monitorët, të cilat janë paraqitur si të papërshtatshëm për t’u përdorur për të kryer punët e nevojshme dhe detyrat funksionale të punonjësve në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të</p>	2.2	E lartë	<p>Nga Drejtoria e Financës në Tirana Parking të merren masat që në vijimësi, procesi i inventarizimit të kryhet i plotë duke kaluar nëpër të gjitha etapat si inventarizimi fizik, vlerësimi i gjendjes së aktiveve dhe nxjerrja jashtë përdorimit për aktivet sipas nevojës, duke u bazuar në gjendjen e tyre reale të amortizimit, të evidentuar gjatë procesit të inventarizimit.</p>

	aktiveve”, pika 73 – 74 dhe pika 102.			
4	Në Drejtorinë e Tirana Parking, si kryetar i Komisionit të Vlerësimit, bazuar në Urdhër i brendshëm Nr. 263, datë 31.12.2020, nr. 1961/1 prot., “Për ngritjen e grupit të komisionit për vlerësimin e asetëve të propozuara për daljen nga përdorimi”, është vendosur Drejtori i Burimeve Njerëzore, që nuk ka qenë nëpunës zbatues i institucionit, siç parashikohet në kuadrin ligjor në fuqi në mospërputhje me Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 99.	2.2	E Mesme	Drejtoria e Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, në komisionet e vlerësimit të asetëve për procesin e inventarizimit, të vendosë si kryetar të këtij komisioni nëpunësin zbatues të institucionit.
5	Duke marrë parasysh faktin që procesi i inventarizimit kryhet çdo vit, konstatimi se ka pasur në magazinë ende bileta të cilave u kishte kaluar afati i përdorimit, është bërë shume vite më vonë nga skadencia e tyre. Ndërkohë që duhet të ishin konstatuar shumë më herët në kohë dhe të ishin nxjerrë jashtë përdorimit vite më parë. Në Tirana Parking, komisioni i vlerësimit ka gjykuar se këto asete (bileta) kanë qenë të papërshtatshme për përdorim të mëtejshëm pasi u kishte kaluar afati i vlefshmërisë, që kishte qenë periudha e viteve 2016 – 2017 në mospërputhje me Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 74 – 80 dhe pika 102.	2.2	E Mesme	Drejtoria e Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, pas përfundimit të procesit të inventarizimit të çdo viti, asetet të cilave u ka kaluar afati i vlefshmërisë së përdorimit, të nxirren jashtë përdorimit.
6	Në Drejtorinë e Tirana Parking, vlera e inventarit për llogaritë 214 dhe 218 të klasës 2 të aktiveve afatgjata materiale dhe llogarisë 327, e paraqitur në raportin e inventarizimit nuk është pasqyruar saktë, pasi ka diferenca krahasuar me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe pasqyrës së pozicionit financiar në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Urdhër nr. 64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit.	2.2	E Mesme	Drejtoria e Financës në Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, të paraqesë saktë dhe të bëjë sistemimet përkatëse, në mënyrë që vlera e llogarive të klasës 2 dhe 3, të paraqitura në raportin e inventarizimit, të përkojë me vlerën e secilës prej llogarive të klasës 2 dhe 3, në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe pasqyrën e pozicionit financiar.
7	Për vitet objekt auditimi, janë konstatuar diferenca për llogaritë e investimeve 230 dhe 231, duke krahasuar të dhënat e paraqitura për secilën prej llogarive në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të financimit dhe faktit të paraqitur në dokumentacionin shkresor në mospërputhje me Ligji nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Urdhër nr. 64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit.	2.2	E lartë	Drejtoria e Financës në Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, të paraqesë saktë dhe të bëjë sistemimet përkatëse, në mënyrë që vlera e llogarive të investimeve, të përkojë me vlerën e secilës prej llogarive, në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të financimit dhe pasqyrën e pozicionit financiar.
8	Llogaria 475 për vitet objekt auditimi, është paraqitur në vlerë të tjetër në pasqyrën e pozicionit financiar dhe ndërkohë këto vlera	2.2	E lartë	Drejtoria e Financës në Tirana Parking të marrë masat që në

	nuk janë të njejta me rakordimet me thesarin në mospërputhje me Ligji nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Urdhër nr. 64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit.			vijimësi, të kontabilizojë saktë dhe në vlerë të plotë, vlerën e llogarisë 475 “Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse”, duke bërë regjistrimet përkatëse për këtë llogari.
9	Për vitet objekt auditimi, janë konstatuar diferenca për llogaritë 600, 601 dhe 602 duke krahasuar të dhënat e paraqitura për secilën prej llogarive në pasqyrën e performancës financiare dhe vlerës faktike të paraqitur në dokumentacionin shkresor vënë në dispozicion në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 5, 6, 7, 9 dhe 10; Urdhër nr. 64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit.	2.3	E lartë	Drejtoria e Financës në Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, të paraqesë saktë dhe të bëjë sistemimet përkatëse, në mënyrë që vlera e llogarive të shpenzimeve, të përkojë me vlerën e secilës prej llogarive, në pasqyrën e performancës financiare.
10	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Zhvillimi i Platformës për Metodën Alternative të Pagesave të Parkimit”, nuk është zbatuar afati i zbatimit të kontratës nga ku data e lidhjes së kontratës është data 02.08.2022 dhe sipas kushteve të kontratës, duhej që shërbimi të ishte implementuar që me datë 02.02.2023 dhe të ishte në përdorim nga qytetarët. Gjatë analizimit të situatës dhe nga sqarimi i marrë nga grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, nga verifikimi i kryer rezultoi që aplikacioni mobile ishte i krijuar por që pengesat ishin krijuar gjatë krijimit të modaliteteve për pagesat nga palët e treta (marrëveshjet me bankat dhe subjektet e tjera). Nga verifikimi i kryer nga ana e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës mbajtur Memo bashkëngjitur me Nr. Prot 330/2, datë 03.02.2023, me lëndë “Propozim për shtyrjen e kalimit online të metodës alternative të pagesës” me anë të cilit janë paraqitur arsyet teknike dhe ligjore dhe kushtet që duhen plotësuar nga Tirana Parking në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë për të kryer lançimin online të platformës në kundërshtim me Nenin 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.	2.4	E lartë	Tirana Parking, grupi i ndjekjes dhe i zbatimit të kontratës, të marrë masat e menjëhershme që në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë të implementojë dhe të zhvillojë online platformën për Metodën Alternative të Pagesave të Parkimit dhe moduleve përbërëse të saj dhe aplikacioneve Android dhe iOS.
11	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike elektrike, telefonike, ngrohje”, objekti i kontratës, nuk përkon me përmbajtjen e procedurës, me preventivin dhe specifikimet teknike. Shkresa e ofertës së marrë nga O.E. fitues është me objekt “Riparim-mirëmbajtje e sistemit të ngrohje-ftohjes me chiller”, objekt i cili përkon me përmbajtjen e procedurës por që është ndryshe nga objekti i procedurës së prokurimit të kërkuar nga A.K. Për sa më sipër, në kundërshtim me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.	2.4	E lartë	Tirana Parking, gjatë hartimit dhe zhvillimit të procedurave të prokurimit, objekti i kontratës të jetë në përputhje me përmbajtjen e procedurës së prokurimit, në mënyrë që O.E. e interesuar të aksesohen lehtë dhe që pjesëmarrja të jetë e lartë.
12	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike elektrike, telefonike, ngrohje” 2022, gjatë verifikimit të testimit.	2.4	E lartë	Tirana Parking, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe

	Gjithashtu një pjesë e specifikimeve teknike janë të ekzagjeruara dhe nuk mund të verifikohen nga anëtarët e KVO-së dhe të atyre të marrjes në dorëzim si dhe kanë një vlerë fikse duke mos përdorur termat ekuivalente, në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.			udhëzimet përkatëse duke hartuar specifikime teknike të cilët janë gjithëpërfshirëse duke krijuar pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përlllogaritet drejtë fondi limit.
13	<p>Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje Makineri dhe Pajisje për Parkimet”, nuk është kërkuar katalog për produktet e kërkuara me certifikatë për cilësinë e tyre, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe. Ky kriter është mjaft i rëndësishëm në një kontratë që lidhet me pajisjet dhe makineritë e nevojshme për parkimin si dhe në pikën 2.3.1 është kërkuar që OE duhet të vërtetojë se ka të punësuar në stafin profesional, minimalisht 2(dy)punonjës të trajnuar për mirëmbajtjen e sistemeve të parkimit të listuara në specifikimet teknike. Pra, janë kërkuar dy punonjës, pa përcaktuar kualifikimin apo arsimimin tyre për pjesën e zbatimit të kontratës (montimin e pajisjeve dhe makinerive) por është kërkuar që të jenë të trajnuar në këtë fushë. Për një kontratë të tillë të rëndësishme, ky kriter është i pa plotë dhe nuk ka argumentimin e duhur për të siguruar zbatimin e kontratës si dhe gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shërbim të Pastrimit dhe Gjelbërimit”, për vitin 2022 u konstatua:</p> <p>Në pikën 2.2.1 nga AK për kapacitetin ekonomik dhe financiar është kërkuar:</p> <p>“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës”, në mospërputhje me shkronjën c¹, pika 2, Neni 43 dhe pikën 4², Neni 55, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilës vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës.</p> <p>Në pikën 2.3.1 nga AK për përvojën e suksesshme është kërkuar:</p> <p>“Shërbime të një natyre të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”, në mospërputhje me shkronjën ”b”³, pika 4, Neni 55, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilës për</p>	2.4	E lartë	Tirana Parking, gjatë hartimit të kërkesave dhe kriterëve kualifikues të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke qenë gjithëpërfshirëse si dhe të krijojnë pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës.

¹ vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës.

² Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

³ vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

	kontratat e mallrave dhe të shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës në mospërputhje me Nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 2 e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.			
14	<p>Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i sheshit te parkimit te Selman Stermasi”, për vitin 2021 u konstatua: Në pikën 3.3.1 të DST, nga AK për përvojën e suksesshme është kërkuar:</p> <p>“Shërbime të një natyre të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit,” në mospërputhje me pikën 2⁴, të Nenit 25, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilës për për të provuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.</p> <p>Në pikën a) 3.3.11 të DST, nga AK është kërkuar licenca mjedisore e lëshuar nga QKL,për pastrimin, larje rrugësh, fshirje rrugësh(KODI iii 1 A), përveçse e pa argumentuar si kërkesë, ndër të tjera kjo leje mjedisore e tipit C, nuk ka në fokus të veprimtarisë së saj pastrimin, larjen e fshirjen e rrugëve por magazinimin dhe trajtimin e mbetjeve të ujërave të zeza, që nuk ka lidhje me objektin e prokurimit si dhe gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shërbim të Pastrimit dhe Gjelbërimit”, për vitin 2021 u konstatuan kërkesa dhe kritere të vecanta të kualifikimit jo në proporcion me objektin dhe vlerën e kontratës, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> staf inxhinierik, ndër të tjera dhe “.....1 (një)inxhinier gjeolog” <input type="checkbox"/> “një punësim mesatar i të paktën 50 punonjësve me kohë të plotë pune, për periudhën prill 2018 – prill 2019. <p>Neni 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 2 e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar” në mospërputhje me Nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 2 e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.</p>	2.4	E lartë	Tirana Parking, gjatë hartimit të kërkesave dhe kritereve kualifikuese të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke qenë gjithëpërfshirëse si dhe të krijojnë pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës.
15	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Master Plan dhe Plan Bisnesi për parkimet”, për vitin 2021, është kërkuar shtyrje e afatit të zbatimit të kontratës nga ana e O.E., e cila është miratuar por nga dokumentacioni rezulton se nga AK nuk ka një vlerësim mbi arsyet e kërkesës për shtyrje nga ana e kontraktorit BOE fitues “A” sh.p.k & “S” sh.p.k. Nuk janë dokumentuar kërkesat e bëra nga Kontraktori drejtuar institucioneve të sipërcituara për të dhënat e kërkuara si edhe vonesat e përgjigjeve nga ana e tyre në	2.4	E lartë	Tirana Parking, Komisioni i ndjekjes dhe i zbatimit të kontratës, të marrë në konsideratë të gjitha kushtet e kontratës dhe të garantojë zbatimin e tyre me përpikmëri nga të dyja palët.

⁴ vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit..

	kundërshtim me Nenin 19.5 të Kontratës nr. 1193/12, datë 22.11.2021 “Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit”.			
16	Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Tirana Parking, Bashkia Tiranë administruar në KLSH me nr. 1682/23 prot., datë 31.07.2019, janë rekomanduar gjithsej: 4 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 3 masa, , në proces zbatimi 1 masë në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “j”.	2.5	E lartë	Drejtori i Drejtorisë Tirana pargim, Bashkia Tiranë të marrë masa për përsheptimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve të pazbatuara akoma, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1682/23prot datë 31.7.2019 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Drejtorisë Tirana pargim, Bashkia Tiranë”.
17	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje Makineri dhe Pajisje për Parkimet”, nga e KVO, në momentin e hapjes së ofertave, është kërkuar me anë të emailit që tju vihet në dispozicion katalogu, dokumentacioni i cili duhej të ishte kërkuar që në hartimin e kërkesave dhe kritereve të vecanta të kualifikimit, pasi rëndësia e dokumentacionit katalog është i rëndësisë së lartë në kundërshtim me Pikën c, të nenit 98 të V.K.M- së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” pasi ka pas mangësi të rëndësishme në DST.			Tirana Parking, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në momentin e hapjes së ofertave, të kryejë vlerësimin e tyre sipas dispozitave ligjore dhe në përputhje me to, si dhe të marrë në konsideratë të gjitha kriteret, kërkesat e kualifikimit si dhe specifikimet teknike duke krijuar kushtet e zhvillimit të një gare në kushtet e plota të konkurrencës.
18	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shërbim të Pastrimit dhe Gjelbërimit”, për vitin 2022, nga dokumentacioni rezulton se Shoqëria “C” sh.p.k, fitues i procedurës së prokurimit të mësipërm, ka lidhur kontratë qiraje nr. Nr. 4530 Rep. Nr. 1194 Kol datë 16.05.2022 me Shoqërinë “F.” shpk. Për mjetet e marra me qera sipas kontratës së mësipërme, në dokumentacionin përkatës të mjeteve ka paraqitur edhe certifikatë për transport mallrash për llogari të vet (në emër të “F” sh.p.k), pra certifikata e lëshuar nga njësi vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, qiradhënësi e ka për përdorim vetjak”. <i>Dokumentacioni i paraqitur vërteton vetëm faktin se mjetet janë në pronësi të qiradhënësit, por përdorimi i tyre do të ishte i pamundur nga qiramarrësi si në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor” në mospërputhje me Pikën 3, e nenit 92 të V.K.M- së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” pasi ka pas mangësi të rëndësishme në DST, duke e konsideruar vlerën e kontratës prej 8,298,666 si vlerë e përdorur pa ekonomikitet, eficiencë dhe ekonomikitet.</i>	2.4	E lartë	Tirana Parking, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në momentin e hapjes së ofertave, të kryejë vlerësimin e tyre sipas dispozitave ligjore dhe në përputhje me to, si dhe të marrë në konsideratë të gjitha kriteret, kërkesat e kualifikimit si dhe specifikimet teknike duke krijuar kushtet e zhvillimit të një gare në kushtet e plota të konkurrencës.
19	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i sheshit të parkimit të Selman Stermasi”, për vitin 2021, nga dokumentacioni rezulton se BOE “V. K. sh.p.k & “R. G. sh.p.k, fitues i procedurës së prokurimit të mësipërm, nuk ka përmbushur	2.4	E lartë	Tirana Parking, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në momentin e hapjes së ofertave, të kryejë vlerësimin

<p>kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, që bie në kundërshtim me pikën 11gërma (a) të dst-së në të cilën sanksionohet “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (aktin e pronësisë) b)leje qarkullimi; c)certifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (aktin e pronësisë); b) leje qarkullimi; c)certifikatën e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).në mospërputhje me Pikën 3, e nenit 92 të V.K.M- së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” pasi ka pas mangësi të rëndësishme në DST, duke e konsideruar vlerën e kontratës prej 8,298,666 si vlerë e përdorur pa ekonomikitet, eficiencë dhe ekonomikitet. Nga KVO është skualifikuar O.E “K.C.” sh.p.k, me ofertë ekonomike 10,489,512 lekë, në diferencë prej 4,516,316 lekë nga BOE fitues, e cila përbën vlerë të përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.</p>		<p>e tyre sipas dispozitave ligjore dhe në përputhje me to, si dhe të marrë në konsideratë të gjitha kriteret, kërkesat e kualifikimit si dhe specifikimet teknike duke krijuar kushtet e zhvillimit të një gare në kushtet e plota të konkurrencës.</p>
--	--	--

Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Tirana Parking, Bashkia Tiranë, në përgjithësi ka zbatuar kuadrin rregullator, por janë konstatuar edhe shmangie të cilat kanë ndikuar në performancën financiare të shoqërisë. Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit nuk përcaktohen qartë specifikimet teknike dhe kriteret e vecanta si dhe zbatimit dhe ndjekja e kontratës nuk kryhet si duhet nga grupet e marrjes në dorëzim dhe ndjekjes së kontratave.

Opinioni i Auditimit

Opinion për auditimin e përputhshmërisë:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Tirana Parking, Bashkia Tiranë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Tirana Parking, Bashkia Tiranë, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

*“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Tirana Parking, Bashkia Tiranë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionin të **kualifikuar** të përputhshmërisë.”*

Baza për opinionin e përputhshmërinë.

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit “Tirana Parking, Bashkia Tiranë.” në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-

s); me parimet ISSAI-P1, “Deklarata e Limës”; ISSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI P-12, ISSAI P-20, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Në i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së.

Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Tirana Parking. dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Në besojmë së dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur gjithashtu mbi gjykimin profesional të audituesit. Gjithashtu, në besojmë së dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Opinion për auditimin financiar:

Objektivi i audituesve në auditimin financiar është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nëse këto pasqyra janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Ne mundëm të auditonim pasqyrat financiare vjetore të Tirana Parking ku përfshihen pasqyra e pozicionit financiar, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare.

"Në opinionin tonë, evidenca dhe dëshmi e marra nga grupi i auditimit janë të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare të subjektit Tirana Parking. Nisur nga kjo, grupi i auditimit paraqet rezerva mbi dhënien e opinionit (refuzim Opinion) për auditimin financiar".

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. (ISSAI 1700. 9;10, Manuali auditimit financiar faqja 141, 142, 154). Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Ne theksojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Kjo çështje lidhet me shënimet shpjeguese të cilat nuk iu vunë në dispozicion grupit të auditimit si dhe në arritjen e aksesimit të tyre pasi kishte anomali të mbartura në sistemin financiar nga vitet e paraardhëse.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Menaxhimi i Tirana Parking. është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi. Drejtimi është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e buxhetit dhe të pasqyrave të llogaridhënies vjetore në përputhje me kuadrin e

zbatueshëm të raportimit financiar dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm efektiv, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë *siguri të arsyeshme*, që veprimtaria e Tirana Parking, në të gjitha aspektet, është pa gabime dhe anomali materiale. Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në këtë institucion krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), Objektivi ynë lidhet me *dhënien e sigurisë së arsyeshme* mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Tirana Parking, me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare e administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Për këtë audituesit e KLSH, aplikojnë gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese nëpërmjet të cilës, audituesit identifikojnë çështjet më të rëndësishme që trajtohen në Projekt Raportin e auditimit.

II. HYRJJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e KLSH*”, në zbatim të projektit dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së nr.317/1 Prot., datë 18.04.2023, për periudhën nga data 01.01.2019 deri më datë 31.12.2022 si dhe zhvillimin e auditimit “Financiar dhe të Përputhshmërisë” nga data 19.04.2023 deri më datë 12.06.2023 në subjektin Tirana Parking, Bashkia Tiranë, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- E.K. (*përgjegjës grupi*)
- A.F. (*anëtarë*)
- S.J. (*anëtarë*)
- K.P. (*anëtarë*)

Titulli: Raport Përfundimtar auditimi “Financiar dhe Përputhshmërie” në Tirana Parking, Bashkia Tiranë për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2022.

Projekt Raporti i auditimit është i strukturuar në gjashtë kapituj. Në kapitullin e parë të hyrjes janë trajtuar çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve, etj. Në vijim është përshkrimi i auditimit, në të cilin trajtohet një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit. Në kreun e tretë jepet konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionin i auditimit, bazuar në rezultatet e auditimit. Gjetjet dhe rekomandimet të strukturuar sipas llojit të tyre janë vendosur në kreun e katërt. Projekt Raporti ka në kreun e pestë anekse dhe mbyllet me kreun VI-Lista e dokumenteve të auditimit.

Marrësi: Tirana Parking, Bashkia Tiranë, znj. E.Z. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm.

Objektivat dhe qëllimi: Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse Tirana Parking në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

Qëllimi i këtij auditimi financiar dhe përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen

e masave dhe veprimeve korigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e proceseve dhe aktiviteteve të institucionit.

Identifikimi i çështjes: Projekt Raporti mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të Tirana Parking për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2022, ka identifikuar sipas kritereve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Strukturat drejtuese, duhet të orientojnë strukturat e institucionit, për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.

Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit e KLSH janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Kriteret e vlerësimit: Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Manualet e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH.

Ligji Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”.

Ligji Nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” me ndryshime.

Ligji Nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet Rrugore” me ndryshime.

Ligji Nr.10279, datë 20.5.2010 “Për kundravajtjet administrative”.

Ligji Nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Ligji Nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” me ndryshime.

Ligji Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi I Punës I Republikës së Shqipërisë” me ndryshime.

Ligji Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;

Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”;

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar” me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020.

Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar;

Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”

Ligji Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar;

VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar;

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.153 datë 07.04.2000 “Per miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, me ndryshimet.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.229, datë 23.04.2004 “Për Miratimin e Ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me vendimin Nr.832, datë 15.09.2013.

Vendim Nr. 816, Datë 16.11.2016 “Për Strukturën, Kriteret E Përzgjedhjes Dhe Marrëdhëniet E Punës Së Punonjësve Të Njësisë Përgjegjëse Në Autoritetet Publike, Në Zbatim Të Ligjit Nr. 60/2016, “Për Sinjalizimin Dhe Mbrojtjen E Sinjalizuesve”.

Standardet e auditimit: Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme.
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400-Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;

- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; si dhe në praktikat më të mira të fushës.

Metodat e auditimit: Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e QKUM-së., kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar me akt konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt Raporti.

Dokumentimi i auditimit: Është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Bashkia e Tiranës me Vendim të Këshillit Bashkiak ,Nr 48,datë 11.11.2015 krijon “Tirana Parking”, i cili është institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës për Administrimin e Shërbimit Publik me Pagesë.

Parkimi i kontrolluar, si një instrument rregullator, krijon rregulla përdorimi që synon të balancoj kërkesat me mundësitë, por edhe të inkurajojë/dekurajojë sjellje të caktuara të drejtuesve të mjeteve, në përputhje me politikat e lëvizjes në zona të caktuara në qytet. Tirana ndahet në 4 zona Administrimi për Parkim (1,2,3,4) (ZAP) , dhe 3 zona Tarifore(A,B,C) ku janë të përfshira rrugët, të cilat janë Hapësirat Publike për Parkim.

III.2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit.

III.2.1. “Auditimin mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

Bazuar në *Misionin* e Vetëqeverisjes Vendore “për të siguruar qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve” nëpërmjet: zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;

nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative; për të rritur cilësinë e jetës si dhe shtuar aktivitetet për t'i shërbyer popullsisë së bashkisë Tiranë”⁵, Bashkia Tiranë duke vlerësuar disa shërbime si kyçe për bashkëjetesën e të gjitha kategorive sociale dhe për një efektivitet të paktën të qëndrueshëm të këtyre shërbimeve ndaj tyre, ka krijuar disa ndërmarrje në varësi të saj si edhe “Tirana Parking” me VKB nr. 49 datë 11.11.2015 “Për krijimin e Tirana Parking si Institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, për administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me pagesë” i ndryshuar.

➤ Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në “Tirana Parking” Tiranë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri- tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

1. Mjedisi i kontrollit



Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxherial dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Referuar nenit 20 të Ligjit nr. 10296 “Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli”, titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Nga auditimi u

konstatua se, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, Kreu II, neni 8, pika 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit”; neni 9 pika 4/a “Përgjegjshmëria menaxheriale e Nëpunësit Autorizues”, në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4,2,10/a “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, rezulton se për periudhën në auditim 2020, 2021 e 2022 nuk është hartuar/miraturar një Plan Strategjik dhe Plan

⁵ Misioni dhe Vizioni përbëjnë dhe hapin 2 të ciklit të MFK sipas Manualit të MFK miraturar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atë të ri nr. 108/2016.

Vjetor të Aktivitetit të Njesisë të cilën drejton, si derivat i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, ku të paraqiten qartë misioni, vizioni dhe objektivat e institucionit për një afat 5 vjeçar.

1.1. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

a. “Tirana Parking” është institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, veprimtaria dhe funksionimi i së cilës janë të përcaktuara në VKB nr.49 datë 11.11.2015 “Për krijimin e Tirana Parking si Institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, për administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me pagesë”; me VKB nr. 36 datë 29.03.2018 “Për disa ndryshime në VKB nr. 48 datë 11.11.2015 të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e Tirana Parking si Institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, për administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me pagesë” dhe në VKB nr. 49 datë 11.11.2015 ”Për miratimin e kritereve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga BaShkia Tiranë”.

Gjatë periudhës nën auditim 2019, 2020, 2021 dhe 2022 ka ushtruar funksionet e veta *me Rregulloren e Brendshme* “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së “TIRANA PARKING” institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 22678/1 datë 30.05.2019 me nr. 789 prot., datë 31.05.2019. Kjo rregullore është hartuar dhe miratuar mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8 pika 2, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 9131/2003 “Për rregullat e etikës në Administratën publike”, Ligjit nr. 120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale, VKM nr. 511/2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” i ndryshuar, VKM nr. 390/1995 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, Urdhrat e Kryetarit të Bashkisë të çdo viti respektiv “Për miratimin e strukturës dhe organikës së “Tirana Parking”.

b. *Mbi respektimin e etikës* nga punonjësit e institucionit, “Tirana Parking” për periudhën nën auditim ka funksionuar me Kod Etike të miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 9496/1 datë 06.04.2016 me nr. 414/1 datë 08.04.2016 “Miratimin e Kodit të Etikës”; “Kodi i Etikës së Tirana Parking” është miratuar së bashku me “Rregulloren e brendshme të Sekretari Arkivës së institucionit Tirana Parking”, në zbatim të Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” neni 1, neni 2 pika 1,4; Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

c. “Tirana Parking” për periudhën nën auditim (01.01.2019 deri më 31.12.2022) nuk disponon një “Rregullore të posaçme për parandalimin e konfliktit të Interesit”; në “Kodin e Etikës” së Tirana Parking është trajtuar në rubrikën 1 “Konflikti i interesit” me pesë pika. Kjo Rregullore përcakton rastet e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike dhe ka si qëllim parandalimin e tyre. Mungesa e “Rregullores së posaçme për parandalimin e konfliktit të Interesit” të miratuar është në kundërshtim me Ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar neni 4.

“Kodi i Etikës” dhe “Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit” përcaktojnë rregullat e sjelljes së nëpunësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, i ndihmon ata për arrijtjen e këtyre standardeve si dhe vë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë nëpunësi i administratës publike. Kjo ndikon në mbarëvajtjen e funksionimit të institucionit, duke mos lejuar cenimin e aktivitetit të tij në çdo aspekt.

Konstatim: “Tirana Parking” për periudhën nën auditim, nuk ka hartuar “Rregulloren e Posaçme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit”, në moszbatim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, neni 4;


1.2 Politikat menaxheriale dhe stili i Punës

Punësimi në “Tirana Parking” bëhet në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative”, VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr. 746/2018. Kjo procedurë rregullohet nga vet Strukturat e “TIRANA PARKING” Tiranë:

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme [DBNJSHB] është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas Kodit të Punës i ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015 i ndryshuar Kreu II;

Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] ose Komisioni në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015 i ndryshuar ;

Titullari i Njësisë në rastin konkret Drejtori i Përgjithshëm.



Struktura përgjegjëse e “Tirana Parking” paraqet te titullari (Drejtori i Përgjithshëm) në çdo rast në mënyrë shkresore, pozicionet e lira në strukturën organizative institucionale, konform Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë” i ndryshuar, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Tiranë dhe Njësisve në varësi të saj”.

Plani vjetor i punësimit: Nga Auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion DBNJSHB rezultoi se, janë dërguar zyrtarisht shkresa në Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore Bashkia Tiranë për riorganizim të strukturës organizative të “Tirana Parking”, mbi shtesat apo ndryshime emërtesash pozicionesh: *për vitin 2019* me shkresën nr. 567 datë 11.04.2019; *për vitin 2022* janë dërguar me shkresën nr.104/2 prot., datë 27.01.2022 dhe me shkresën nr. 1163/2 datë 05.08.2022. Referuar kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, “Plani vjetor i punësimit” hartohet mbi nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor, duke detajuar emërtimin e pozicionit dhe të

njesisë përbërëse në strukturë, si dhe miratohet nga titullari i njesisë publike. Për planifikimin vjetor të punësimit, duhet patur parasysh: *mbushja e moshës së pensionit të punonjësit; parashikimin e vendeve të reja dhe ecurinë e krijimit të vendeve vakante.*

Konstatim: Në “Tirana Parking” për periudhën në auditim nuk është hartuar dhe miratuar “Plani vjetor i punësimeve”, në moszbatim të VKM nr. 108/2014 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” neni 3, 11, 13.

Nga verifikimi i dokumentacionit që grupi i auditimit i kërkoi [DBNJSHB], rezultoi se për vitin 2019, 2020, 2021 dhe 2022 janë të plota praktikat e ndjekura për çdo rast të të punësuarve me kontratë pune, të bazuara mbi nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor, të cilat në çdo rast i paraqiten drejtorit të përgjithshëm. Publikimi i vendeve vakante nga ana e “Tirana Parking” *bëhet* në faqen zyrtare të saj si dhe në stendat e institucionit, por **u konstatua** se “shpalljet për vend të lirë pune” nuk dërgohen zyrtarisht për tu publikuar në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në kundërshtim me VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar Kreu II pika 6 dhe Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 19 pika 1, 2.

Komisioni i Përhershëm i Pranimit [KKP] për çdo vit ushtrimor ngrihet me Urdhër të titullarit të institucionit “Tirana Parking”, të cilat pasqyrohen si më poshtë:

Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Urdhri nr.240 datë 31.12.2018/ nr. 1926 prot., datë 31.12.2018	Urdhri nr.215 datë 20.10.2020/ nr. 1575 prot., datë 20.10.2020	Urdhri nr.215 datë 20.10.2020/ nr. 1575 prot., datë 20.10.2020	Urdhri nr.237 datë 31.12.2021/ nr. 1890 prot., datë 31.12.2021
Komisioni	Komisioni	Komisioni	Komisioni
E. Q. / Kryetar	E. Q. ≠ J. A. / kryetar	J. A. / kryetar	J. A. / kryetar
F. M./ anëtar	F. M. ≠ E. M. Drejtor / DLP	E. M. Drejtor DLP	E. M. Drejtor / DLP
Drejtori /Përgjegjësi ku aplikohet nga punëkërkuessi	Drejtori /Përgjegjësi ku aplikohet nga punëkërkuessi	Drejtori /Përgjegjësi ku aplikohet nga punëkërkuessi	Drejtori /Përgjegjësi ku aplikohet nga punëkërkuessi
Numri i anëtarëve 3	Numri i anëtarëve 3	Numri i anëtarëve 3	Numri i anëtarëve 3

Punoi:Grupi i auditimit

Urdhrat për ngritjen e komisioneve të verifikimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të aplikantëve (nëpërmjet intervistave), janë të shoqëruar me pesë “formularët tip” të praktikës përkatëse. Praktika është bërë pjesë e dosjes së personelit.

b. Përshkrimin e punës të çdo pozicioni si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët, duhet të jenë të përshkruara në Formularin e Përshkrimit të Pozicionit të Punës. Ato janë pjesë e rëndësishme e politikave dhe praktikave që lidhen me burimet njerëzore. Si të tilla *Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë kriteret dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit.* Për këto arsye, kriteret duhet të jenë pjesë në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, neni “përshkrimet e punës” si dhe e dosjes së personelit.

[DBNJSHB] nga ana e saj pasi harton planin vjetor të punësimit, ndjek procedurën nga shpallja e njoftimit deri në përfundimin e saj, praktikë e cila në përfundim bëhet pjesë e dosjes së personelit; Kjo procedurë realizohet në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi: Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele,

periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar. Gjithashtu [DBNJSHB] harton Formularët e Përshkrimit të Pozicionit të Punës të çdo pozicioni në strukturë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar⁶, Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe “Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, duke e bërë pjesë të dosjes në zbatim të VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Ky formular është pjesë përbërëse e manualit të procedurave të njësisë publike.

Duke qenë se “Tirana Parking” është njësi varësie e Bashkisë Tiranë, funksionon me një Rregullore të Brendshme e cila hartohet me konsulencën e strukturës përgjegjëse të organit epror dhe miratohet nga titullari i tij. Rregullorja e Brendshme përmban përshkrimet e punës: kompetencat, funksionet dhe të drejtat e çdo njësie e pozicioni të strukturës organizative, kriteret e veçanta për çdo pozicion, përvojat etj.

Konstatim: Nga auditimi rezultoi se Formularët e përshkrimit të pozicioneve të punës nuk ishin pjesë e dosjes së personelit, bashkëngjitur Kontratës së punës (marrëdhëniet e punës rregullohen me Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar), në kundërshtim kjo me VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Referuar hartimit në përmbajtje të Rregullores së Brendshme **u konstatua** se janë përshkruar pozicionet e çdo njësie të strukturës organizative, por nuk janë përcaktuar në mënyrë të qartë e të plotë kriteret për emërtimin profesional të diplomës dhe përvoja profesionale që i nevojitet çdo pozicioni, por janë mjaftuar vetëm me nivelin arsimor (i lartë, i mesëm) dhe nivelin e diplomës (bachelor, master shkencor/profesional); Ky konstatim rezultoi për të gjitha nivelet: menaxheriale (i lartë, i mesëm, i ulët), ekzekutive dhe me klasa, kjo në kundërshtim me VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, kapitulli 5 pika 37, lidhja 2 dhe 3.

Në “Tirana Parking” Struktura organizative ka pësuar ndryshime, të cilat janë miratuar me Vendim të Kryetarit së Bashkisë si më poshtë vijon:

Viti 2018/Prill 2019	Prill Viti 2019 / 2020 / 2021	Shkurt - Tetor Viti 2022	Tetor Viti 2022 e vazhdim
Urdhri nr.4560/2 datë 06.02.2018/	Urdhri nr.4560/2 datë 06.02.2018 Shkresa nr. 567 prot., datë 11.04.2019 (propozim për riemërtim të pozicioneve & miratuar)	Urdhri nr.4143/1 datë 31.01.2022 Shkresa nr. 1163/2 prot., datë 05.08.2022 (propozim për shtim të pozicioneve përgjegjës sektori+specialistë & miratuar)	Urdhri nr.28272/1 datë 05.10.2022 Shkresa nr. 1163/2 prot., datë 05.08.2022 (propozim për shtim të pozicioneve & miratuar)
Struktura	Struktura		Struktura
Drejtori - 4	Drejtori - 4	Drejtori - 4	Drejtori - 4
Sektorë - 6	Sektorë - 6	Sektorë - 9	Sektorë - 9
Numri i punonjësve - 115	Numri i punonjësve - 115	Numri i punonjësve - 122	Numri i punonjësve - 138

Punoi:Grupi i auditimit

Me miratimin nga ana e Kryetarit të Bashkisë të Strukturës Organizative të “Tirana Parking” Tiranë nr.4560/2 datë 06.02.2018, është hartuar dhe miratuar edhe “Rregullorja për organizimin,

⁶ Përshkrimet e Punës janë të hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore Bashkia Tiranë si organi epror i “Tirana Parking”, dhe të miratuara nga DAP (Departamenti i Administratës Publike)

funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së institucionit “Tirana Parking” me Vendimin e Kryetarit nr. 22698/1 datë 30.05.2019 dhe me nr. 789 prot., datë 31.05.2019.

Nga auditimi **u konstatua** se ndryshimet e bëra këtë periudhë (2019-2022) në strukturën organizative të institucionit, nuk janë reflektuar në “Rregulloren e Brendshme të organizimit, të funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së institucionit “Tirana Parking”, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 dhe Manualit e ri me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016 Kapitulli III, Pika 3.1 paragrafi 6; Rregullorja e Brendshme e Institucionit “Tirana Parking” miratuar me Vendimin nr. 22678/1 datë 30.05.2019 dhe nr. 789 prot., datë 31.05.2019, neni 1 “Objekti i rregullores” dhe neni 3 “Qëllimi”.

Struktura organizative e “Tirana Parking” për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 ka këtë kompozim:

Viti	Buxheti Faktik në 000/lekë	Nr. i Drejtorive	Nr. i Sektorëve	Nr. i punonjësve Plan / Fakt	
2019		4	6	115	115
2020	189.029.286	4	6	115	115
2021	178.980.087	4	6	115	115
2022	219.066.087	4	7	138	133

Burimi: “Tirana Parking”

Shpërndarja e pozicioneve në strukturën organizative pasqyrohet si më poshtë:

Niveli pozicionit	Viti 2019 / 2020 / 2021	2022 / 2022
Kategori e lartë	1	1 1
E mesme drejtuese	4	4 4
E ulët drejtuese	4	10 11
Ekzekutive	77	77 79
Me klasa	23	30 38
Totali	115	122 133

Punoi: Grupi i auditimit

Nga informacioni shkresor i vënë në dispozicion, rezultoi se numri i largimeve të punonjësve për arsye të ndryshme në “Tirana Parking” ka qenë i konsiderueshëm.

Një pasqyrim më i detajuar i numrit me arsyen e largimeve, jepet në tabelën e mëposhtme:

PERIUDHA	Largimet	Arsyeja	Emërimet	Proçedura e ndjekur
VITI 2020	16	2 punonjës - Përfundim i kontratës së punës; 2 punonjës - Mbushje moshe për pension pleqërie; 2 punonjës - Largim nga puna; 10 - Me kërkesë dorëheqje	13	Proçedura e rekrutimit
VITI 2021	11	2 punonjës - Largim nga puna; 8 nëntë) punonjës - Me kërkesë dorëheqje; 1 punonjës - Mbushje moshe për pension pleqërie;	12	Proçedura e rekrutimit
VITI 2022	7	1 punonjës - Mbushje moshe për pension pleqërie; 6 punonjës - Me kërkesë dorëheqje;	24	Shpallje e vendeve vakante dhe Proçedura rekrutimit

Burimi: Tirana Parking

Nga auditimi i personelit në strukturën organizative të “Tirana Parking”, rezultoi se nuk ka të punësuar me statusin “ekselent” dhe nga “grupi i veçantë, si dhe nuk ka të përcaktuar pozicione në strukturë me prioritet këto kategori. Në “Tirana Parking” është vetëm një punonjës Admirim Poçari, i cili trajtohet si “i aftë për punë të lehta”. Gjithashtu ka pasur takime dhe një komunikim elektronik me strukturën përgjegjëse të AKPA për kategori të caktuara sociale, por që për vet natyrën e fushës së veprimtarisë së institucionit, nuk është vlerësuar si i mundshëm për tu zbatuar

VKM nr. 535 datë 03.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”.

Konstatim: Nga auditimi mbi hartimin dhe miratimin e strukturës organizative dhe organigramës të “Tirana Parking”, rezultoi se njësitë përgjegjëse nuk kanë planifikuar pozicione me status “ekselent”, në mos zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.586 datë 30.08.2019; si dhe pozicione me statusin “Grup i veçantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) kategori të ndryshme: persona me aftësi të kufizuara, jetimë, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj) si personel administrativ dhe jo vetëm, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”.

Nga auditimi i personelit në strukturën organizative të “Tirana Parking”, rezultoi si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Drejtoria	Pozicioni	Emërimi	Statusi
1	A.P.	DASHPP	Inspektor	2016	I verbër
2	E.V.	DASHPP	Inspektor	2021	ekselent

Burimi: Tirana Parking

ka një të punësuar me statusin “ekselent” dhe një invalid (i verbër), një punonjës A.P., i cili trajtohet si “i aftë për punë të lehta”; për të punësuar nga “grupi i veçantë” të kategorisë “komunitete të ndryshme” na u komunikua se ka të punësuar nga kjo kategori, por në zbatim të ligjit nr.10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, bëhet me vetdeklarim;⁷ Nga verifikimet rezultoi se nuk në strukturën organizative të Tirana Parking, nuk ka të përcaktuar pozicione me prioritet këto kategori. Gjithashtu ka pasur takime dhe një komunikim elektronik me strukturën përgjegjëse të AKPA për kategori të caktuara sociale, por që për vet natyrën e fushës së veprimtarisë së institucionit, nuk është vlerësuar si i mundshëm për tu zbatuar VKM nr. 535 datë 03.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”.


Konstatim: Nga auditimi mbi hartimin dhe miratimin e strukturës organizative dhe organigramës të “Tirana Parking”, rezultoi se njësitë përgjegjëse nuk kanë planifikuar pozicione me status “ekselent”, në mos zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 586 datë 30.08.2019; si dhe pozicione me statusin “Grup i veçantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) kategori të ndryshme: persona me aftësi të kufizuara, jetimë, kryefamiljare, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj) si personel administrativ dhe jo vetëm, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”.

1.3 Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Nga auditimi konstatohet se “Tirana Parking” Tiranë funksionon me një Strukturë lineare, që pasqyron qartë shkallën hierarkike duke siguruar një transmetim dhe reagim të shpejtë të zbatimit të Urdhrave dhe Udhëzimeve të eprorëve.

Drejtor i Përgjithshëm

⁷ Ky informacion u vu në dispozicion në Observacionin e dërguar nga Tirana Parking nr. 732/24,15,21 datë 19.06.2023, me nr. 317/2,3,4 prot.yni datë 21.06.2023



Skemë e thjeshtuar e strukturës së “Tirana Parking”

Çdo strukture organizative i është bashkëngjitur organigrama përkatëse, e cila jep një pasqyrim të qartë të shkallës hierarkike si dhe pozicionit të çdo njësie përbërëse të saj.

- Referuar tabelës së Vendimeve për miratimin e strukturave organizative të “Tirana Parking”, rezulton se kjo njësi publike gjatë periudhës nën auditim ka funksionuar si më poshtë:

Njësitë Kryesore të Strukturës	Viti 2019-2021	Viti 2022 e në vijim
Drejtori i Përgjithshëm	x	x
Drejtorja e Administrimit të Shërbimit të Parkimit me Pagesë (≠ Publik)	*Sektori i Kontratave *Sektoid Inspektimit të Parkimit në Rrugë e Sheshe *Sektoid Inspektimit me Institucionet	*Sektoid i Kontratave *Sektoid Inspektimit të Parkimit në Rrugë e Sheshe *Sektoid Inspektimit parkimit Taksi *Sektoid Rezidentit
Drejtorja Juridike dhe Prokurimeve	*Nuk ka sektor	*Sektoid Juridik dhe prokurimet
Drejtorja Ekonomike	*Nuk ka sektor	*Sektoid Financës
Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme	*Sektoid i Burimeve njerëzore *Sektoid i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit *Sektoid i Shërbimeve të Brendshme	*Sektoid i Burimeve njerëzore *Sektoid i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit *Sektoid i Shërbimeve të Brendshme
1 / 4	6	9

Punoi:Grupi i Auditimit

1.5. Aftësitë profesionale të punonjësve.

“Tirana Parking” aktivitetin e saj funksional e mbështet në “Rregulloren e Brendshme” e cila përmban: bazën ligjore dhe fushën e zbatimit, strukturën organizative, funksionet menaxheriale, rregulla të përgjithshme, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e çdo njësie dhe pozicioni, të drejtat dhe detyrat e personelit, trajnimet, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, etj.

Duke iu referuar natyrës së veprimtarisë së Tirana Parking (drejtim teknik), listës së proceseve të punës dhe informacionit të detajuar që kërkuam mbi formimin arsimor e profesional të personelit administrativ për të gjitha nivelet menaxheriale (i lartë, i mesëm, i ulët) dhe ekzekutivë, **u konstatua** se është i ulët numri i punonjësve me formim profesional të profilit teknik. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e parkimeve e ka domosdoshmëri që personeli të ketë të përfshirë edhe punonjës me profil dhe kualifikimin teknik përkatës (nivel i lartë apo i mesëm). Kështu nga 115 deri në 133 punonjës që ka aktualisht “Tirana Parking”, vetëm 19 punonjës kanë profilin teknik të formimit arsimor⁸ ose 14.3% e tyre;

Gjithashtu **u konstatua** se në DBNJSHB, sektori i shërbimeve të brendshme, pozicioni i punonjësit të shërbimit, nuk ka të përcaktuar qartë profilin hidraulik apo elektrik, kjo pasi këto janë profesione krejtësisht të ndryshme dhe shërbimi që ofron secili është i domosdoshëm për aktivitetin e përditshëm në institucion. Ndërkohë që punonjësi aktual është me profesionin hidraulik, mbeten të pambuluara nevojat e institucionit për shërbimet elektrike.

⁸ Këtu përfshihen të gjitha klasifikimet e Inxhinierive: industrial, bujqësore, ekonomike, ushtarake.

Për të audituar dosjet e personelit, përzgjedhëm dosjet e të punësuarve për vitet 2020, 2021 dhe 2022 në “Tirana Parking” si dhe dosjet e punonjësve të larguar nga ky Institucion. Emërimet/largimet i janë nënshtruar procedurave të Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

a. *Mbi rregullsinë dhe plotësinë e dosjeve të personelit* kërkuam dosjet e punonjësve të emëruar në “Tirana Parking” për disa kategori punonjësish: për ata të emëruar dhe ata të larguar gjatë të periudhës nën auditim. Nga testimi me zgjedhje të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjedhëm), emëruar/larguar në këtë periudhë, rezultoi se dosjet e personelit e përmbanin dokumentacionin përkatës të dosjeve konform: Ligjit nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; VKM nr. 117, datë 5.3.2014 Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar;

b. *Mbi trajnimin e punonjësve në “Tirana Parking”.*

Stafi administrativ ka zhvilluar numër të kufizuar trajnimesh vjetore për programet e detyrueshme ofruar nga ASPA për njësi të veçanta të strukturës së “Tirana Parking”. Nga komunikimi me [DPBNJP] rezultoi se kjo drejtori përcjell çdo vit brenda muajit nëntor nevojat për trajnim të punonjësve të institucionit, sipas formatit të dërguar nga ASPA, kategoria “për punonjësit jashtë shërbimit civil”. Komunikimi realizohet në rrugë zyrtare elektronike.

Nga auditimi rezultoi se nga “Tirana Parking”, struktura përgjegjëse e saj [DBNJSJH] ka hartuar Plane vjetore trajnimesh për punonjësit e saj të të gjitha kategorive (e mesme, e ulët drejtuese dhe ekzekutive) për ato trajnime të ofruara nga ASPA; Gjithashtu rezultoi se kanë patur pjesëmarrje edhe në seanca trajnimesh të paplanifikuara, por të vlerësuara të nevojshme për rritjen profesionale të punonjësve. Për vitin 2020 nga trajnimet e planifikuara në Planin vjetor, nuk janë realizuar asnjë për shkak të situatës pandemike “Covid 19”.

Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësisë kuptohen dhe arrihen nga punonjësit.

Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për:

- Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune;
- Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës;
- Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta;
- Futjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre.
- Kryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkuara për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve;
- Zhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit.

Konstatim: Nga struktura përgjegjëse e “Tirana Parking” [DPBNJP], për periudhën në auditim, në planet vjetore të trajnimeve nuk është përfshirë njohja e stafit (punonjësit e të gjitha niveleve: menaxherialë dhe ekzekutivë) me Ligjin nr. 10296/2011 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” si domosdoshmëri, pasi ndihmon në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për t’i kryer me efikasitet ato, në moszbatim kjo të Ligjit nr. 10296 /2010

“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 2, 3 dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

2. Menaxhimi i Riskut

2.1 Regjistri i Riskut Grupi i auditimit lidhur me menaxhimin e riskut, kërkoi t’i vihet në dispozicion Regjistri i riskut, ku jepet një pasqyrim i identifikimit të risqeve të çdo njësie të strukturës dhe masat që duhen marrë parandalimin apo minimizimin e pasojave. “Tirana Parking” ka hartuar dhe miratuar Regjistrin e Riskut për 3 vite radhazi 2020, 2021 dhe 2022, në zbatim të Ligjit 10296 dt. 08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 dt. 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

- Urdhër nr. 42, nr. 383/1 prot, datë 19.02.2020 “Për Miratimin e regjistrit të riskut për vitin 2020”
- Urdhër nr. 28, nr. 312/1 prot, datë 19.02.2021 “Për Miratimin e Regjistrit të riskut për vitin 2021”
- Urdhër nr. 154/1 prot, datë 18.01.2022 “Për Miratimin e Regjistrit të Riskut për vitin 2022”

Regjistri i Riskut (i konsoliduari), hartohet mbi analizën e riskut të çdo drejtorie dhe ka si *Synim* “Planifikimin dhe Përdorimin me efencë, efikasitet dhe transparencë të fondeve buxhetore në përputhje me misionin e Bashkisë, për arritjen e objektivave”. Ky regjistër përmban përshtatimin e risqeve për çdo drejtori/sector, nivelin e risqeve, kontrollet ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet, zotëruesi i riskut si dhe situatën e riskut pas detyrës së fundit, si dhe mënyrën apo rrugëzgjdhjen e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë.

2.2 Grupi i Menaxhimit Strategjik [GMS] dhe Ekipi i Menaxhimit të Programeve [EMP].

Tirana Parking nuk ka ngritur *Grupin e Menaxhimit Strategjik* [GMS], dhe si rrjedhojë nuk ka takime të dokumentuara të aktivitetit të tij; - “Tirana Parking”/Bashkia Tiranë për periudhën në auditim është e përfshirë në Ekipet e Menaxhimit të Programeve [EMP] në Programin “Shërbime Publike Vendore dhe Infrastrukturë Rrugore”: *për vitin 2018-2019*⁹ me Urdhrin e Kryetarit nr. 27200 datë 12.07.2018 ; *për vitin 2019-2020* me Urdhrin e Kryetarit nr. 23227 datë 05.06.2019; *për vitin 2020-2021* me Urdhrin e Kryetarit nr. 25657 datë 09.10.2020; *për vitin 2021-2022* me Urdhrin e Kryetarit nr. 16565 datë 21.04.2021; *për vitin 2022-2023* me Urdhrin e Kryetarit nr. 14962 datë 20.04.2022; *për vitin 2023-2024* me Urdhrin e Kryetarit nr. 13989 datë 05.04.2023. Referuar Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit “Mbi MFK”, lidhur me aktivitetin e GMS citohet si më poshtë:

Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të zhvillojë aktivitetet e mëposhtme:

- Të nxisë realizimin e objektivave dhe qëllimeve strategjike të njësisë;
- Të garantojë se brenda njësisë ekziston një kuadër i përshtatshëm i MFK efektiv, që siguron vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve;
- Të kuptojë se si njësia realizon objektivat e MFK;
- Të rishikojë procesin e menaxhimit të riskut;

⁹ Per hartimin e PBA dhe Projektplanit Buxhetor vjetor

- Të garantojë se drejtuesit dhe punonjësit e njësisë janë të pajisur me aftësitë dhe udhëzimet e nevojshme për të vënë në zbatim kontrolle të brendshme efektive dhe për të menaxhuar risqet;
- Të shqyrtojë nëse mjedisi i kontrollit dhe procedurat mund t'i përmbushin objektivat e tyre;
- Të vendosë standardet dhe vlerat e njësisë;
- Të verifikojë raportet e audituesve mbi MFK dhe përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore;
- Të përcaktojë nëse janë raportuar dobësi materiale, kushte të tjera të raportueshme, apo gjetje të tjera;
- Të rishikojë përmirësimet e sugjeruara për MFK si dhe të ndjekë në vazhdimësi korrigjimin e dobësive në kontrollin e brendshëm;
- Të verifikojë deklaratën e titullarit të njësisë mbi sistemin e kontrollit të brendshëm;
- Të udhëheqë dhe të mbikqyrë procesin e ndryshimit, që shton kapacitetin e njësisë për të punuar me rezultate të larta.

Konstatim: “Tirana Parking” deri më 31.12.2022 nuk ka ngritur GMS, ku dhe caktohet koordinatori i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatori i riskut, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kreu II neni 8, pika 8/b; neni 10 neni 27 pika 1,2; dhe “Manualin e Menaxhimit financiar dhe kontrollin” miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i ri me nr. 108/2016¹⁰.

2.2 Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

Duhet theksuar se në procesin e miratimit të planeve vjetore të punës, duhet të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu e rëndësishme është që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike. Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut.

Nga auditimi rezulton se në lidhje me *identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut*:

Konstatim: Nga “Tirana Parking” nuk është hartuar asnjë “strategji për menaxhimin e riskut”, në moszbatim të nenit 8 pika 8/a, neni 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”.

2.3 Gjurmët e Auditimit janë një instrument mbështetës për menaxhimin e njësisë. Gjurmët e Auditimit përfshijnë operacione të cilat nisin dhe përfundojnë brenda një strukture organizative, por që mund të përshkojnë gjatë rrugës së tyre, disa struktura organizative, dhe madje disa njësi. Gjurma e Auditimit informon mbi: Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit; Gjurmimin e

¹⁰ Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke pasur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t’i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë”.

operacionit prej fillimit në fund; Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit; Aktivitetet e rëndësishme të kontrollit, që garantojnë ecurinë e duhur të operacionit; Kush e merr një vendim të caktuar gjatë ecurisë së operacionit; Sistemet e IT-së që mbështesin operacionin; Kush mban përgjegjësinë finale për procesin – veçanërisht në rastet kur në kryerjen e një operacioni marrin pjesë disa njësi organizative. Gjurmët e auditimit si edhe regjistri i riskut rezultojnë të hartuara nga njësi të veçanta në strukturë: DPBNJP, DE, DDD.

Nga sa më sipër nga ana e “Tirana Parking”, grupit të auditimit iu vu në dispozicion “Gjurmët Standarde të Auditimit”, miratuar nga Titullari i Njesisë në cilësinë e NA me Vendimin nr. 19 datë 19.07.2018 me nr. 1051 prot., datë 19.07.2018 për procedurat e mëposhtme:

- Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA);
- Për zbatimin e buxhetit;
- Për menaxhimin e aktiveve të njësisë;
- Për prokurime te me vlerë të vogël nën 800,000 lekë;
- Për prokurimet me vlerë të vogël mbi 800,000 lekë

Dokumenti “Gjurmët e auditimit” të Tirana janë hartuar mbi këto akte ligjore/nënligjore:

- VKB nr. 48 datë 11.11.2015 “Për krijimin e Tirana Parking si institucion varësie të Bashkisë Tiranë, për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë”
- Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar
- Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar
- VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga auditimi rezulton në vitin 2020 është përditësuar dokumenti “Gjurmët e auditimit” vetëm për procedurën e përgatitjes së PBA-së, miratuar nga NA me Urdhrin nr. 210 datë 15.10.2020 me nr. 1559/1 prot., datë 15.10.2020 “Për një ndryshim të Vendimit nr. 129 datë 19.07.2018 “Për miratimin e Gjurmëve të Auditimit”; ndërkohë që referuar kohës kur është hartuar e miratuar ky dokument dhe akteve ligjore /nënligjore mbi të cilat është mbështetur, si dhe faktit se aktet ligjore/nënligjore mbi Prokurimin Publik kanë pësuar ndryshime, konkretisht: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 i ndryshuar me Ligjin nr. 162/2020; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar me VKM nr. 823 datë 21.10.2020 i ndryshuar me VKM nr. 285 datë 9.05.2021 i ndryshuar me VKM nr. 710 datë 24.11.2021, rezulton se këto ndryshime ligjore nuk kanë gjetur reflektim të strukturave përgjegjëse për të përditësuar dokumentin “Gjurmët e Auditimit” të Tirana Parking.

Konstatim 2.3: Nga auditimi rezulton se, dokumenti “Gjurmët e Auditimit” nuk janë përditësuar nga strukturat e “Tirana Parking”, në kundërshtim kjo me ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16 pika 2; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” Kapitulli III, pika 3.3 paragrafi “Gjurmët e auditimit”; Udhëzimin nr. 30 dt. 27.12.2011 i ndryshuar, neni 121 e122.

b. Lidhur me *Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemeve IT*, nga informacioni dokumentar dhe verbal i vënë në dispozicion rezultoi: “Tirana Parking” nuk disponon dhomë të mirëfilltë serverash, aktualisht *rack-u* me rrjetin e fibrës optike, rrjetin e brendshëm ethernet, sëitchet, UPS, servera është i vendosur në magazinën e jashtme të institucionit.

Na u komunikua se këtë vit buxhetor është parashikuar të zhvillohet procedura e prokurimit “Rikonstruksioni i dhomës teknike të serverave”, me anë të të cilit do të realizohet një dhomë serveri që përmbush standartet e konstruksionit, ventilimit, teknike dhe të sigurisë fizike dhe të rrjetit.

Tirana Parking disponon server, i cili ka dhe konfigurimin si **Domain Controller**, i konfiguruar me RAID 1, ku ruhen të dhënat e kompjuterëve të punonjësve të institucionit;

Në këtë server është hostuar **platforma e Kartës së Rezidentit**, e cili aksesohet në linkun <https://rezidenti.tirana.al>.

Platforma e Sms Payment – Parkimit me Sms, është pjesë e një kontrate tre palëshe midis Bashkisë Tiranë, Operatorëve telefonikë Vodafone dhe One dhe “Tirana Parking”;

Sistemet e Kamerave, janë sisteme survejimi me kamera në të gjitha sheshparkimet, parkimet nëntokësore dhe терминаlet e autobusave nën administrimin e saj si dhe në zyrat qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tirana Parking. Pajisjet e survejimit janë të tipit NVR dhe janë të vendosura lokalisht në dhomat teknike ose kabinat e parkimit;

Sistemet e Parkimeve, janë sisteme parkimi në të gjitha sheshparkimet, parkimet nëntokësore dhe терминаlet e autobusave nën administrimin e saj. Pajisjet e parkimit janë të vendosura lokalisht në kabinat e parkimit. Sistemet lokale lidhen me serverin multiparking me anë të të cilit menaxhohen parkimet njëkohësisht dhe aksesohen të dhënat e çdo sistemi.

Website dhe Social Media, faqe web zyrtare e cila mund të aksesohet në linkun: <https://tiranaparking.al> e cila është e hostuar në Bashkinë Tiranë;

Një shpërndarje e Sistemeve IT sipas përdoruesve (njësive të strukturës organizative) të “Tirana Parking” pasqyrohen në tabelën më poshtë:

Nr.	Emërtimi i Sistemit IT	Përdoruesit Drejtori / Sektor
1	Domain Controller	Të gjitha punonjësit
2	Platforma e Kartës së Rezidentit	DASHPP / Rezidenti DBNJSHB / STI
3	Platforma e Sms Payment	DASHPP DF DBNJSHB / STI
4	Sistemet e Kamerave	DASHPP / AP DBNJSHB / STI / BNJ
5	Sistemet e Parkimeve	DASHPP DBNJSHB / STI
6	Ëëbsite dhe Social Media	DBNJSHB / STI
7	Paketa Microsoft Office Platforma web AFMIS Platforma web IMPRO Platforma self-care e Tatimeve	DF

Burimi: Tirana Parking

Konstatim: Në “Tirana Parking”, Sistemet janë implementuar në një ambient i cili nuk plotëson kushtet e nevojshme të përcaktuara në “Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverave” hartuar dhe miratuar nga Agjencia Kombëtare e Teknologjisë së Informacionit [AKSHI] në vitin 2008, VKM nr. 710/2013 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” i ndryshuar; Udhëzimit nr.115 dt.17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit”;

Sistemet (7) mbështeten nga 3 (tre) specialistë IT, duke mos siguruar ndarjen e nevojshme të detyrave për sigurinë e informacionit dhe zhvillimin e tyre;

Lista (Harta) e Proceseve/Manuali i Procedurave të punës. Pamja e përgjithshme e procesit përmban një vështrim të përgjithshëm të aktiviteteve dhe procedurave që parashikojnë mënyrën e realizimit të proceseve të veçanta, sikurse dhe dokumentacionin që përdoret gjatë ecures së tyre.

Ajo garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit, që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit; shkresat/ formularët tip si dhe disa seksione të tjera plotësuese të tyre (procedurave).”Tirana Parking” ka miratuar nga Nëpunësi Autorizues [NA] “Sistemin e Kontrollit të brendshëm” dhe “Proceset e Punës” me nr. 162 prot., 20.01.2022, në zbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 dhe Manualit e ri me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016 Kapitulli III, Pika 3.3.

3. Veprimtaritë/Aktivitete e Kontrollit

Aktivitete e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.

Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë: Të përshtatshme; Efektive nga pikëpamja e kostos; Të gjithanshme; Të dokumentuara qartë etj.

- Në “Tirana Parking” për realizimin e objektivave me efikasitet, ekzistojnë dhe përdoren manuale për proceset kryesore operacionale dhe financiare, të cilët specifikojnë qarkullimin e dokumentacionit:

Nr.	Sektorët	Manualet që përdoren
1	Sektori i Financës	» Manuali i Klasifikimit të llogarive » Manuali i pasqyrave financiare
2	Njësia e Prokurimit	» Manuali mbi prokurimin elektronik në SPE të blerjeve me vlerë të vogël » Manuali mbi përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE)

Për këtë çdo Njësi Publike edhe ato në varësi të NJVQV duhet të hartojë dhe miratojë Planin e Kontrollit të Brendshëm (periodik apo vjetor), si një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen; gjithashtu ndihmon në monitorimin e detyrave që menaxherët e njësive të ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre. Nga auditimi rezultoi se: Drejtoria e Administrimit të Shërbimit të parkimit me pagesë [DASHPP] dhe Drejtoria e Burimeve njerëzore dhe Shërbimeve, kanë hartuar dhe miratuar nga titullari Planin e kontrollit vjetor¹¹; ndërsa Drejtoria Ekonomike [DE] dhe Drejtoria Juridike dhe Prokurimet [DJP] kanë hartuar vetëm manualin e proceseve të punës.

Konstatim Nga “Tirana Parking” nuk është hartuar/miratuar Plan i Kontrollit të Brendshëm periodik apo vjetor, nga të gjitha njësitet kryesore të strukturës organizative, kjo në moszbatim të nenit 22, pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, “Manualit për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Llojet e Kontrollit që duhet të zbatohet në një njësi publike janë: parandalues dhe pas faktit. Në “Tirana Parking” kontrollet pas faktit realizohen nga NJAB të Bashkisë Tiranë, si organ epror i saj etj., pra jo nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit; ndërsa ato parandaluese janë dhe paraqiten si më poshtë vijon:

¹¹ Plani i kontrollit vjetor është hartuar dhe miratuar si një dokument i vetëm me Manualin e proceseve të punës.

- a. Kontrollë në shqyrtimin e dokumentacionit që nënshkruhet, praktika e saj dhe verifikohet saktësia e materialit;
 - b. Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person (NA-NZ);
 - c. Të gjitha angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA&NZ (sistemi i 2 firmave);
 - d. Çdo dalje e Aktiveve afatgjata autorizohet dhe monitorohet nga NA; kontroll i dokumenteve të inventarëve, regjistrave financiarë, librat e kontabilitetit etj.; “Tirana Parking” *disponon* rregullore për menaxhimin e aktiveve të saj;
 - e. Rregulloret për Sistemet IT i vihen në dispozicion çdo përdoruesi, por *nuk janë hartuar plane* vjetore për trajnimin e specialistit IT dhe të përdoruesve të sistemeve IT; si dhe plane kontrolli periodike apo vjetore;
 - f. Parashikuar procedura të qarta mbi komunikimin e shkresave brenda dhe jashtë Bashkisë: hyrja, trajtimi, mbajtja e dokumentacionit lidhur me depozitimin e protokollimin, komunikimin shkresor e elektronik;
 - g. Komunikimi dhe trajtimi i urdhrave të brendshëm dhe udhëzimeve përshtatur sipas përgjegjësive individuale të çdo pozicioni;
 - h. Ndarja e detyrave i referohet strukturës organizative institucionale, ku secili punonjës kryen detyrën sipas akt emërimit dhe Formularit të përshkrimit të punës;
 - i. Institucioni përgjithësisht zbaton rregullat e përcaktuara në “Normat tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të shërbimit arkivor” për ruajtjen e dokumenteve, për trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin gjatë punës, ka një rregullore të *veçantë* dhe një plan veprimesh për mirëfunksionimin e arkivit dhe të shërbimeve që ajo ofron, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm;
 - j. “Tirana Parking” ka ngritur Njësinë e Sinjalizuesit, ka miratuar Rregullore “Për hetimin administrativ të sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga njësia e sinjalizimit” nr. 494 prot., datë 19.03.2021, Rregullore “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja nga njësia e sinjalizimit” shoqëruar me regjistrin, formulari tip I dhe tip II, me nr. 504 prot., datë 24.03.2021, në zbatim këto të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”; Për periudhën nën auditimi grupit të auditimit iu vu në dispozicion raporti vjetor me nr. 3592 prot., datë 28.12.2022 si dhe rezultoi pa raste sinjalizimi të brendshëm, për pasojë dhe asnjë rast për mbrojtje të sinjalizuesit; Ky informacion shkresor është dërguar edhe në ILDKPKI. Deri më 31.12.2022 në “Tirana Parking” nuk ka pasur raste informacioni nga njësia e sinjalizimit.
 - k. “Tirana Parking” ka faqen e saj zyrtare në web me adresë <https://tiranaparking.al/> dhe pasaportën e Bashkisë Tiranë në Portalin Porta Vendore me adresë <https://portavendore.al/bashkia-Tiranë/pasaporta-e-bashkise-Tiranë/>, të cilat përdorin një lidhje të sigurt (connection security) *HTTPS* (Hyper Text Transfer Protocol Secure), që do të thotë se serveri i faqes së internetit përdor një certifikatë sigurie, për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletuesit e ndryshëm;
- Plani i Kontrollit të Brendshëm është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen. Mungesa e planeve të kontrollit kanë ndikuar dhe në mos monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përbushjes së tyre;

Veprimtaritë e kontrollit, përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

2. Auditimi i Brendshëm: Misioni i “Tirana Parking” synon ushtrimin efektiv të funksioneve dhe kompetencave, ofrimin dhe realizimin e shërbimeve të parkimit publik me ose pa pagesë, mbi dhe nën tokë, në përputhje me kuadrin nënligjor të miratuar nga Këshilli Bashkiak i organit epror Bashkia Tiranë. Fusha e aktivitetit të saj përfshin vjeljen dhe sigurimin e të ardhurave nga shërbimi i parkimit publik me pagesë. Të gjitha të ardhurat që vilen nga ky shërbim, “Tirana Parking” i derdh 100% në llogari të organit epror Bashkia Tiranë. Auditimi i Brendshëm është një veprimtari e pavarur që i jep siguri objektive dhe i ofron këshillim për menaxhimin, e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të menaxhimit. Aktiviteti, misioni, objektivat e NJAB realizohen sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi: Ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, Urdhri i Ministrit të Financave nr. 100/2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, VKM nr.83 /2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar me VKM nr. 353/2016.

Në “Tirana Parking” nuk ka Njësi të Auditimit të Brendshëm, por aktivitetin e saj e realizon Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Tiranë. Nga auditimi rezultoi se NJAB Bashkia Tiranë gjatë periudhës nën auditim 2019-2022, ka ushtruar vetëm një mision auditues në “Tirana Parking” për aktivitetin e saj në periudhën 01.01.2019 – 31.12.2019. Referuar Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100/2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar dhe frekuencës audituese, rezulton se “Tirana Parking” është vlerësuar nga NJAB Bashkia Tiranë me koeficient risku të mesëm.

Raporti Përfundimtar i Auditimit që NJAB ka dërguar me nr. 17469 datë 04.09.2020 dhe regjistruar në “Tirana Parking” me nr. prot., 837/5 datë 09.09.2020, ka si objekt “Auditimin mbi funksionimin e të gjitha sistemeve të institucionit Tirana Parking” për periudhën 01.01.2019-31.12.2019.

Në RPA janë lënë 12 Rekomandime, sipas nivelit të rëndësisë të klasifikuara si më poshtë:

Rekomandime	I lartë	I mesëm	I ulët
Të mëparshme	1	0	0
Të fundit	5	6	0
Totali	6	6	0

Punoi: Grupi i auditimit

Nga ana e DLP/Tirana Parking janë marrë masat si më poshtë vijon:

1. Drejtori i Përgjithshëm ka miratuar Urdhrin nr.1358 prot., datë 14.08.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit të brendshëm, bazuar në programin e auditimit nr. 17469/1 datë 11.06.2020”. Ky grup përbëhet si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni
1	E. M.	Drejtor DJP
2	J A	Drejtor DBNJSHB
3	R K	Drejtor DE

2. Është hartuar dhe miratuar “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm Bashkia Tiranë” me nr. 1360/1 datë 14.09.2020 brenda afatit ligjor;

Rekomandime	Për përmirësim ligjor	Kuadri ligjor	Me karakter organizativ	Shperbilm dëmi (arkëtim)	Për përmirësim siteme të tjera
12	2	2	8		

Burimi: Tirana Parking

3. Është dërguar “Raporti mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në RPA me nr. prot., 837/5 datë 09.09.2020” me shkresën nr. 16042 prot., datë 16.04.2021.

Rekomandime	Pranuar	Zbatuar	Proces zbatimi
12	12	8	4

Burimi: Tirana Parking

Konstatim 3.1 Nga auditimi rezultoi se NJAB Bashkia Tiranë institucionin në varësi të saj “Tirana Parking”, e ka vlerësuar me koeficient risku të mesëm, me frekuencë auditimi në çdo 3 vjet, pra me një klasifikim jo real të riskut që mbart veprimtaria e saj, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 100/2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.

Informacioni dhe Komunikimi

Drejtuësit e institucionit: NA & NZ dhe menaxherët e të gjitha niveleve, kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit; si dhe nuk kanë kryer trajnime mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të organizuar nga ASPA. Mungesa e GMS dhe e trajnimeve të stafit për njohjen dhe zbatimin e ligjit “Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe jo vetëm, ka riskuar harmonizimin në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e detyrave gjatë procedurave apo proceseve brenda sektorëve/drejtorive si dhe ndërmjet sektorëve, me qëllim ruajtjen e komunikimit ndërmjet njësive brenda strukturës së “Tirana Parking” si dhe “Tirana Parking” me Bashkinë e Tiranës. Informacioni shkëmbehet në nivel Horizontal dhe Vertikal. “Tirana Parking” disponon një Rregullore të Brendshme të pa përditësuar, hartuar dhe miratuar mbështetur në strukturën organizative me të cilën funksionon njësia sipas VKB-ve përkatëse. “Tirana Parking” ka një faqe zyrtare, ku pasqyron gjithë aktivitetin e saj, me qëllim garantimin e njohjes maksimale me informacion komunitetin, si dhe vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion; nga ana tjetër kjo ndikon edhe në nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoritetit publik. Referuar Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, çdo Njësi publike duhet të publikojë në faqen e vet në internet Programin e miratuar të transparencës, ku publikohen informacionet e kategorizuara në ligj, të specifikuara në nenin 7 të tij. Specialisti që menaxhon “Website dhe Social Media” luan rolin e Koordinatorit për Informim dhe i Transparencës.

a. Buxheti hartohet mbi bazën e kërkesave të çdo drejtorie por nuk diskutohet rreth tyre, kjo në mungesë të GMS;

b. Zhvillohen analiza vjetore të arritjeve të objektivave të “Tirana Parking”, *por nuk janë të dokumentuara*;

c. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, është përgjegjëse për komunikimin me Subjektet kryesore të jashtme (ka korrespondencë shkresore zyrtare dhe elektronike sipas rastit) si dhe e çdo dokumenti administrativ (operacional e financiar) në institucion; ajo përzgjedh formën e komunikimit (shkresor të protokolluar apo elektronik) sipas rastit. Duhet të aplikohet rregullisht komunikimi elektronik ose shkresor (komunikim i brendshëm), duke evituar komunikimin verbal me qëllim forcimin e gjurmës së auditimit;

d. Çdo muaj bëhet akt rakordimi me Degën e Thesarit dhe raportimi i bëhet Titullarit të njësisë (NA);

e. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për çdo problem apo paqartësi, në rrugë elektronike.

Monitorimi dhe Raportimi

Mungesa GMS dhe i caktimit të një menaxheri në cilësinë e Koordinatorit Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinatorit të Riskut, mos hartimi i strategjisë së riskut, mospërditësimi i Rregullores së Brendshme etj, ka sjellë mos efektivitet në procesin e monitorimit, pasqyruar kjo në mungesën e GMS dhe si rrjedhojë mos hartimin e raporteve vjetore prej tij, të raporteve periodike të menaxherëve të nivelit të ulët, të mesëm mbi ecurinë dhe realizimin e produkteve të njësisë publike, masën e realizimit të shpenzimeve, si dhe identifikimin e fushave të cilat nuk janë realizuar në masën e pritshme, duke analizuar dhe shkaqet përkatëse. Ky raportim bëhet nga personeli përgjegjës i çdo drejtorie tek eprori dhe eprorët ia përcjellin titullarit, në cilësinë e NA dhe Kryetar i GMS. Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti 4 mujor dhe vjetor i monitorimit, i cili i dërgohet në Bashkinë Tiranë. Raportimi i konsoliduar (aparati i bashkisë me njësitë e varësisë) bëhet në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 68 /2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, nenit 65 të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” e të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22/2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore” hartohet nga njësi përgjegjëse e Bashkisë Tiranë dhe dërgohet në Këshillin Bashkiak dhe MFE. Këto Raporte janë ato të monitorimit të buxhetit dhe ato mbi MFK që përmbajnë: Pyetësonin e Vetëvlerësimit, Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Regjistrin e Menaxhimit të Riskut, Raporti për Funksonimin e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm, Plani i Veprimit për MFK. Nga auditimi rezultoi se Raportet e monitorimit të buxhetit janë hartuar nga Drejtoria Ekonomike dhe dërguar në bashkinë Tiranë; ndërsa lidhur me raportimin mbi MFK ku përfshihen 4 seksionet e sipërcituara nga “Tirana Parking” nuk janë hartuar dhe si rrjedhojë nuk është raportuar në organin epror. Duke analizuar me kujdes të gjitha procedurat që ndiqen në funksion të arritjes së objektivave të “Tirana Parking”, konstatojmë se baza rregullatore mbi të cilën mbështetet aktiviteti funksional i saj, është e paplotë për rrugët që duhen ndjekur në konturimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit, duke e parë si sistem dinamik (të jetë koherent me çdo akt ligjor apo nënligjor që del). Kjo arrihet duke krijuar GMS dhe forcuar aktivitetin e tij si rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie, caktimin e koordinatorit të MFK e koordinatorit të riskut, që të mund të kontrollojnë, të konstatojnë dhe të sistemojnë në kohë reale edhe parregullsinë më të vogël të procedurave të përditshme, duke minimizuar riskun e kthimit të tyre në fenomen.

Konstatim: “Tirana Parking” nuk ka krijuar një praktikë të konsoliduar Raportimi kryesisht mbi ato të implementimit dhe zbatimit të komponentëve të MFK që përmban Pyetësorin e Vetëvlerësimit, Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Regjistrin e Menaxhimit të Riskut, Raporti për Funksonimin e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm, Plani i Veprimit për MFK, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualin MFK, Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për Koordinatorin MFK dhe koordinatorin e riskut” si dhe Udhëzimin nr. 21 datë 25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të gjitha niveleve”.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Në “Tirana Parking” për implementimin e Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin rezultoi se:

“Tirana Parking” Tiranë deri më 31.10.2022 nuk ka ngritur *Grupin e Menaxhimit Strategjik dhe caktuar koordinatorin e MFK e Koordinatorin e Riskut*, duke mos hartuar planin/grafikun dhe realizuar takimet e detyrueshme vjetore, për trajtimin e çështjeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Njësisë;

“Tirana Parking” deri më 31.10.2022 e në vazhdim nuk ka hartuar *Strategjinë e Riskut*;

Në “Tirana Parking” jo të gjitha njësitë e strukturës organizative kanë hartuar një *Plan të Kontrollit të Brendshëm* (sipas Aneksit nr. 11 të Manualit), i cili është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen. Mungesa e planeve të kontrollit kanë ndikuar dhe në mos monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre;

NJAB Bashkia Tiranë nuk ka bërë vlerësim real me koeficient risku të lartë institucionin e varësisë “Tirana Parking” duke mos ushtruar me efektivitet aktivitetin e vet për përmirëm të dukshëm të shërbimeve që ofron në dobi të komunitetit, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100/2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.

T’i kushtohet vëmendje njohjes së gjithë stafit me funksionimin e MFK në institucionin publik nëpërmjet planifikimit në planin vjetor të trajnimeve;

-istemet janë implementuar në një ambient i cili nuk plotëson kushtet e nevojshme të përcaktuara në “Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverave” hartuar dhe miratuar nga Agjencia Kombëtare e Teknologjisë së Informacionit [AKSHI], VKM nr. 710/2013 “Për Krijimin dhe Funksonimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” i ndryshuar, sistemet nuk mbështeten nga një numër i mjaftueshëm specialistë IT, duke mos siguruar ndarjen e nevojshme të detyrave për sigurinë e informacionit dhe zhvillimin e tyre;

Në lidhje me pikën e mësipërme të programit u krye dhe një verifikim mbi menaxhimin e shesheve të parkimeve dhe terminaleve të administruara nga ana e Drejtorisë Tirana Parking, Bashkia Tiranë.

Verifikimi u krye nga tre audituesit z. E. K., znj. A. F. dhe znj. K. P., në prani të Përgjegjës të IT z. B. K..

Nga ana e audituesve u konsiderua verifikimi i shesheve të parkimit si më poshtë:

Sheshi i parkimit “Stacioni i Trenit”.

- Sheshi i parkimit “Asllan Rusi”
- Terminali i autobusëve ndërkombëtar
- Sheshi i parkimit “Garda e Republikës së Shqipërisë”
- Sheshi i parkimit “Pranë Qendrës Tregtare Toptani”
- Sheshi i parkimit “Arena Air Albania”

Auditimi konsistoi në mënyrën e menaxhimit të parkimeve, sistemit të tyre, menaxhimin e të ardhurave dhe problematikave të lindura.

Nga verifikimi rezultoi:

- Në sheshet e parkimeve, në të cilat ekzistojnë abonimet mujore për qytetarët, këto të fundit nuk ishin të pajisura me karta aksesi, por dalja e tyre dhe hapja e traut kryhej nga inspektori i shesheve me anë të komandës “manual opening”, duke bërë të mëndur vështirës në menaxhimin dhe kontrollin e inspektorëve mbi realizimin e detyrave përkatëse.
- Dy sheshet e parkimit, sheshi i parkimit “Garda e Republikës së Shqipërisë” dhe sheshi i parkimit “Pranë Qendrës Tregtare Toptani”, nga verifikimi i grupit të auditimit, rezultuan se nuk ishin të pajisura me sistemin e menaxhimit të parkimeve, por vetëm me anë të kasës fiskale, duke krijuar vështirësi në menaxhimin dhe kontrollin e inspektorëve mbi realizimit e detyrave përkatëse, si dhe gjithashtu në këto sheshe parkimi mungon vijëzimi dhe sinjalistika përkatëse duke krijuar fluks dhe radhë të makinave ku për të cilët është e vështirë të kuptohet nëse vendet e parkimit janë të zëna.
- Në disa raste në sheshet e parkimeve ishte e vështirë njohja e targave të automjeteve nga ana e sistemit si dhe aksesi për hyrje dalje të makinave ishte i vështirë, ku kuptohej nga incidentet e ndodhura të cilët kishin lënë gjurme si dhe nga intervistimi i inspektorëve në lidhje me problematikat e hasura.

I. Titulli i Gjetjes:	Mbi implementimin dhe zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit të Brendshëm
Situata:	<p>Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm mbi gjendjen aktuale të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur edhe nga mungesa e Raportit të Vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera në Tirana Parking, u konstatuan mangësitë si vijon:</p> <p><u><i>I. Mjedisi i Kontrollit</i></u></p> <p>1. “Tirana Parking” për periudhën nën auditim 2020, 2021 e 2022 nuk ka hartuar/miratur një Plan Strategjik dhe Plan Vjetor të Aktivitetit të Njesisë, si derivat i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, ku të paraqiten qartë misioni, vizioni dhe objektivat e institucionit për një afat 5 vjeçar.</p> <p>2. “Tirana Parking”për periudhën nën auditim, nuk ka hartuar “Rregulloren e Posaçme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit”, në moszbatim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, neni 4;</p> <p>3. Nga auditimi rezultoi në “Tirana Parking” për periudhën në auditim, nuk është hartuar dhe miratur “Plani vjetor i punësimeve”, në moszbatim të</p>

VKM nr. 108/2014 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” neni 3, 11, 134;

4. Publikimi i vendeve vakante nga ana e “Tirana Parking” bëhet në faqen zyrtare të saj si dhe në standat e institucionit, por rezultoi se “shpalljet për vend të lirë pune” nuk dërgohen zyrtarisht për tu publikuar në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në kundërshtim me VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar Kreu II pika 6 dhe Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 19 pika 1, 2;

5. Nga auditimi rezultoi se Formularët e përshkrimit të pozicioneve të punës nuk ishin pjesë e dosjes së personelit, bashkëngjitur Kontratës së punës (marrëdhëniet e punës rregullohen me Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar), në kundërshtim kjo me VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar;

6. Referuar hartimit në përmbajtje të Rregullores së Brendshme rezultoi se janë përshkruar pozicionet e çdo njësie të strukturës organizative, por nuk janë përcaktuar në mënyrë të qartë e të plotë kriteret për emërtimin profesional të diplomës dhe përvoja profesionale që i nevojitet cdo pozicioni, por janë mjaftuar vetëm me nivelin arsimor (i lartë, i mesëm) dhe nivelin e diplomës (bachelor, master shkencor/profesional); Ky konstatim rezultoi për të gjitha nivelet: menaxheriale (i lartë, i mesëm, i ulët), ekzekutive dhe me klasa, kjo në kundërshtim me VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, kapitulli 5 pika 37, lidhja 2 dhe 3;

7. Nga auditimi rezultoi se ndryshimet e bëra në periudhën 2019-2022 në strukturën organizative të institucionit, nuk janë reflektuar në “Rregulloren e Brendshme të organizimit, të funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së institucionit “Tirana Parking”, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 dhe Manualit e ri me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016 Kapitulli III, Pika 3.1 paragrafi 6; Rregullorja e Brendshme e Institucionit “Tirana Parking” miratuar me Vendimin nr. 22678/1 datë 30.05.2019 dhe nr. 789 prot., datë 31.05.2019, neni 1 “Objekti i rregullores” dhe neni 3 “Qëllimi”;

8. Nga auditimi mbi hartimin dhe miratimin e strukturës organizative dhe organigramës të “Tirana Parking”, rezultoi se njësitë përgjegjëse nuk kanë planifikuar pozicione me status “ekselent”, në mos zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 586 datë 30.08.2019; si dhe pozicione me statusin “Grup i veçantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) kategori të ndryshme: persona me aftësi të kufizuara, jetimë, kryefamiljare, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj) si personel administrativ dhe jo vetëm, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019 “ Për Nxitjen e Punësimit”;

9. Duke iu referuar natyrës së veprimtarisë së Tirana Parking (drejtim teknik) listës së proceseve të punës dhe informacionit të detajuar që kërkuam mb formimin arsimor e profesional të personelit administrativ për të gjitha nivele

menaxheriale (i lartë, i mesëm , i ulët) dhe ekzekutivë, rezultoi se është i ulët numri i punonjësve me formim profesional të profilit teknik. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e parkimeve e ka domosdoshmëri që personeli të ketë të përfshirë edhe punonjës me profil dhe kualifikimin teknik përkatës (nivel i lartë apo mesëm). Kështu nga 115 deri në 133 punonjës që ka aktualisht “Tirana Parking“, vetëm 19 punonjës kanë formim arsimor me profil teknik¹² ose 14.3% e tyre;

10. Rezultoi gjithashtu se në DBNJSHB, sektori i shërbimeve të brendshme, pozicioni i punonjësit të shërbimit, nuk ka të përcaktuar qartë profilin hidraulik apo elektrik, kjo pasi këto janë profesione krejtësisht të ndryshme dhe shërbimi që ofron secili është i domosdoshëm për aktivitetin e përditshëm në Tirana Parking. Ndërkohë që punonjësi aktual është me profesionin hidraulik, mbeten të pambuluara nevojat e institucionit për shërbimet elektrike;

11. Nga struktura përgjegjëse e “Tirana Parking” [DPBNJP], për periudhën në auditim, në planet vjetore të trajnimeve nuk është përfshirë njohja e stafit (punonjësit e të gjitha niveleve: menaxheriale dhe ekzekutivë) me Ligjin nr. 10296/2011 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” si domosdoshmëri, pasi ndihmon në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për t’i kryer me efikasitet ato, në moszbatim kjo të Ligjit nr. 10296 /2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 2, 3 dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;

II. Menaxhimi i Riskut

12. “Tirana Parking” deri më 31.12.2022 nuk ka ngritur GMS, ku dhe caktohet koordinatori i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatori i riskut, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kreu II neni 8, pika 8/b; neni 10 neni 27 pika 1,2; dhe “Manualin e Menaxhimit financiar dhe kontrollin” miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i ri me nr. 108/2016;

13. Nga auditimi rezulton se në lidhje me identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut: Nga “Tirana Parking” nuk është hartuar asnjë “strategji për menaxhimin e riskut”, në moszbatim të neni 8 pika 8/a, neni 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”;

14. Nga auditimi rezulton se, dokumenti “Gjurmët e Auditimit” nuk janë përditësuar nga strukturat e “Tirana Parking”, në kundërshtim kjo me ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16 pika 2; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” Kapitulli III, pika 3.3 paragrafi “Gjurmët e auditimit”; Udhëzimin nr. 30 dt. 27.12.2011 i ndryshuar, neni 121 e122;

15. Lidhur me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e Sistemeve IT rezultoi se:

a. Në “Tirana Parking”, Sistemet IT janë implementuar në një ambient, i cili nuk plotëson kushtet e nevojshme të përcaktuara në “Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverave” hartuar dhe miratuar nga Agjencia Kombëtare e Teknologjisë së Informacionit [AKSHI] në vitin 2008, VKM nr. 710/2013 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” i ndryshuar; Udhëzimit nr.115 dt.17.03.2014 “Për Hartimin e

¹² Këtu përfshihen të gjitha klasifikimet e Inxhinierive: industrial, bujqësor, ekonomik, ushtarak.

	<p>Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit”;</p> <p>b. Sistemet (7) mbështeten nga 3 (tre) specialistë IT, duke mos siguruar ndarjen e nevojshme të detyrave për sigurinë e informacionit dhe zhvillimin e tyre;</p> <p><i>III Veprimtaritë e Kontrollit</i></p> <p>16. Nga auditimi rezultoi se: Drejtoria e Administrimit të Shërbimit të parkimit me pagesë [DASHPP] dhe Drejtoria e Burimeve njerëzore dhe Shërbimeve, kanë hartuar dhe miratuar nga titullari Planin e kontrollit vjetor¹³; Pra nga “Tirana Parking” nuk është hartuar/miratuar Plan i Kontrollit të Brendshëm periodik apo vjetor i unifikuar, nga të gjitha njësitë kryesore të strukturës organizative, kjo në moszbatim të nenit 22, pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, “Manualit për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”;</p> <p>17. Nga auditimi rezultoi se NJAB BashkiaTiranë institucionin në varësi të saj “Tirana Parking”, e ka vlerësuar me koeficient risku të mesëm, me frekuencë auditimi në çdo 3 vjet, pra e ka klasifikuar me vlerë jo reale të riskut që mbart veprimtaria e saj, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100/2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar;</p> <p><i>IV. Monitorimi/Raportimi</i></p> <p>18. Nga auditimit rezultoi se “Tirana Parking” nuk ka krijuar një praktikë të konsoliduar Raportimi, kryesisht mbi ato të implementimit dhe zbatimit të komponentëve të MFK që përmban: Pyetësin e Vetëvlerësimit, Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Regjistrin e Menaxhimit të Riskut, Raporti për Funkcionimin e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm, Plani i Veprimit për MFK, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualin MFK, Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për Koordinatorin MFK dhe koordinatorin e riskut” si dhe Udhëzimin nr. 21 datë 25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të gjitha niveleve”.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualin “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i përditësuar me nr. 108/2016; Udhëzimin nr. 16, dt. 20.07,2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Udhëzimi nr. 21, date 25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të gjitha niveleve”; Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Kreu VI, neni 32 pika 2/a,b,c; Ligji nr. 7961 dt. 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 9 / 3,4,5; neni 11 pika 1/c, e, f; neni 12; neni 19/1,2,3; neni 20; Ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”; Manuali për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100/2016; VKM nr. 83 /2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar me VKM nr. 353/2016; Ligji nr. 10325/2010 “Për bazën e të dhënave shtetërore”;VKM nr. 117 dt. 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të</p>

¹³ Plani i kontrollit vjetor është hartuar dhe miratuar si një dokument i vetëm me Manualin e proceseve të punës.

	<p>personelit e të regjistrit qendror të personelit” Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2014 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; VKM nr. 142 /2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”; me VKM nr. 746/2018 VKM nr. 639 dt. 07.09.2016 ndryshuar me VKM nr. 596 dt. 04.09.2019 “Për përcaktimin e rregullave të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”; Ligji nr. 9887 dt. 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” ose ligji nr. 138 dt. 17.12.2015; ligji nr. 9049/2003 i ndryshuar, Ligji nr. 9367/2005 dhe Udhëzimi nr. 1 dt. 7.06.2014 të Inspektorit të Përgjithshëm të “Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”; VKM nr. 710/2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” i ndryshuar; “Rregullore për Ndërtimin e Dhomës së Serverave” /2008.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Nga Tirana Parking nuk janë zbatuar rigorozisht elementët nga të cilët përbëhen 5 (pesë) Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, duke rrishtuar kështu sigurinë e arritjes së objektivave institucionale nëpërmjet përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore.</p>
Shkaku:	<p>Gjatë periudhës nën auditim DPOP Tiranë nuk ka treguar vëmendjen dhe përgjegjshmërinë e duhur për plotësimin e aktiviteteve të kontrollit edhe me dokumentacionin përkatës (krijimin e GMS dhe caktimin e Koordinatorit të Riskut, rregullore parandalimi e konfliktit të interesit, përditësimin e gjurmëve të auditimit, strategji risku, plan vjetor kontrolli të brendshëm, etj) dhe miratimin e tyre nga NA – Drejtori i Përgjithshëm, të cilat orientojnë në zbatueshmërinë e gjithë procedurave të njësisë, konform dispozitave ligjore në fuqi.</p>
Rëndësia:	<p>E mesme</p>
Rekomandim:	<p>1.1. Drejtori i Përgjithshëm, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin e Planit Strategjik dhe Vjetor institucional dhe Rregullores së konfliktit të interesit, për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për krijimin e GMS dhe caktimin e koordinatorit të riskut, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, të përditësojë Rregulloren e brendshme, gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit të njësisë, ku ti kushtohet rëndësi e veçantë menaxhimit dhe sigurisë së sistemeve të informacionit të implementuara, hartimin e planit të kontrollit të brendshëm të unifikuar të njësisë.</p> <p>1.2. Nëpunësi Autorizues dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, të marrin masa për krijimin e një strukture efektive, ku të përcaktohen kriteret e veçanta për punësim të çdo pozicioni, njoftimin e vendeve të lira në AKPA.</p> <p>1.3. Nëpunësi Autorizues dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme të marrin masa për hartimin e Planit vjetor të punësimit, vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë, për</p>

të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që i atribuon ligji në dobi të komunitetit.

1.4 Nëpunësi Zbatues të ofrojë te Nëpunësi Autorizues mbështetje me përgjegjësinë që i ngarkojnë aktet ligjore, në lidhje me ngritjen dhe zbatimin e sistemit të MFK si dhe në rritjen e cilësisë së proceseve të këtij Sistemi.

1.5 Njësia e Auditimit të Brendshëm Bashkia Tiranë, të rivlerësojë Tirana Parking me koeficient rrisht “të lartë”, për të ndryshuar frekuencën e auditimit mbi këtë njësi, me qëllim përmirësimin e performancës institucionale në dobi të komunitetit.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 732/28 prot, datë 13.07.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Tirana Parking për periudhën e marrë në auditim është pjesë e Strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022 <https://tirana.al/artikull/strategjia-e-zhvillimit-te-qendrueshem-te-bashkise-tirane-2018-2022>, sipas Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr.5647/1 date 20.02.2017 protokolluar pranë Tirana Parking me nr.267 prot datë 22.02.2017 dhe miratimit të tij me Vendimin nr.160 date 21.12.2018 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022”. Planet vjetore të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Tirana Parking janë në zbatim të objektivave dhe Strategjisë së miratuar nga Këshilli Bashkiak, Bashkia Tiranë. Gjithashtu në vazhdim, Tirana Parking është pjesë aktive e hartimit të Strategjive të Qëndrueshme të Bashkisë Tiranë sipas urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr.19387 datë 23.05.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për harimin e strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm të bashkisë Tiranë 2023-2027” në të cilën janë përfshirë edhe Plan Biznesi dhe Master Plani i Institucionit tonë si pjesë integrale e Strategjisë së Qëndrueshme të Bashkisë Tiranë. Misioni, vizioni dhe objektivat e Institucionit tonë janë gjithmonë në koherencë dhe në përputhje të Planit Strategjik të miratuar nga Bashkia Tiranë. **Duke qënë se Tirana Parking është Institucion Varësie i Bashkisë Tiranë dhe punën e ka ngushtësisht të lidhur me Drejtoritë dhe Institucionet e tjera të Bashkisë nuk mund të hartojë një plan të veçantë strategjik. Tirana Parking ashtu si edhe të gjitha Institucionet e tjera të bashkisë janë pjesë e hartimit të Strategjisë së Qëndrueshme të Bashkisë Tiranë.** Në zbatim të strategjisë së qëndrueshme të Bashkisë Tiranë për pjesën e parkimit janë hartuar dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm planet vjetore të punës së Institucionit tonë me qëllim arritjen sipas afateve të objektivave të përcaktuara. Më konkretisht citojmë: Urdhëri nr.233 nr. prot 1894 datë 24.12.2018 “Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin Planit Vjetor 2019”. Miratuar me Nr.89 prot datë 18.01.2019.Urdhëri nr.275 nr. prot 1762 datë 30.12.2019 “Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin Planit Vjetor 2020”. Miratuar me Nr.102/4 prot datë 17.01.2020.Urdhëri nr.261 nr.,prot 1957 datë 30.12.2020 “Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin Planit Vjetor 2021”. Miratuar me Nr.21/4 prot datë 13.01.2021.Urdhëri nr.233 nr.,prot 1883 datë 31.12.2021 “Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin Planit Vjetor 2022”. Miratuar me Nr.70/4 prot datë 25.01.2022.Tirana Parking si Institucion në varësi të Bashkisë Tiranë nuk disponon një rregullore të vetën për Konfliktin e Interesit por zbaton vendimet dhe urdhëresat e miratuara nga Kryetari i Bashkisë Tiranë. Konkretisht Vendimi nr. 47487 datë 16.12.2019 “Miratimin e Rregullores për parandalimin e konfliktit të Interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Bashkinë e Tiranës” si dhe Urdhërin nr. 23218/1 datë 11.08.2022 “Për Miratimin e procedurës standarte të veprimit për deklarimin dhe trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit në Bashkinë Tiranë”. Tirana Parking, nuk disponon infrastrukturë administrative dhe organike që të ofrojë programe trajnime për ngritjen profesionale të stafit në mënyre direkte. Në drejtim të kësaj Tirana Parking, zhvillon programet e trajnimit që ofrojnë strukturat e posaçme jashtë institucionit dhe në këtë kuptim nga ana e Tirana Parking është kërkuar mbështetja me trajnim profesional të fushave të caktuara sipas planit vjetor të trajnimeve në Drejtorinë e Trajnimit dhe Zhvillimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Tiranë.,Përsa më sipër struktura përgjegjëse në institucionin tonë në kuadrin e pranimit pjesërisht të rekomandimit, vlerëson se lidhur me këtë pikë, ka kryer dhe përmbushur shqetësimet e ngritura në projekt raportin e auditit të KLSH-së dhe merr për sipër që programe të tilla me tema specifike për MFK dhe manualin përkatës së tij si dhe trajnime të tjera ti intensifikojë dhe zgjerojë nëpërmjet komunikimit dhe informimit për të gjithë punonjësit, stafin e administratës dhe titullarin, gjithmonë duke kërkuar suportin e instancave përkatëse dhe kompetente të cilat ofrojnë trajnime për fushat e ndryshme. Në zbatim të MFK nga ana e Tirana Parking janë ngritur grupet e punës çdo vit dhe kanë hartuar regjistrat e risqeve me qëllim minimizimin e riskut për arritjen e objektivave të përcaktuara në

planet vjetore të punës dhe Strategjisë së Qëndrueshme të Bashkisë së Tiranës. Konkretisht: Urdhër nr.234 nr.prot.1895 datë 24.12.2018 “Urdhër për Hartimin e Regjistrit të Riskut për vitin 2019”. Miratimi i Regjistrit të Riskut për vitin 2019 nr.41 nr.278/1 prot datë 27.02.2019. Urdhër nr.274 nr.prot.1761 datë 30.12.2019 “Urdhër për ngritjen e grupit të punës për Hartimin e Regjistrit të Riskut për vitin 2020”. Miratimi i Regjistrit të Riskut për vitin 2020 Urdhër nr.42 nr.383/1 prot datë 19.02.2020.Urdhër nr.259 nr.prot.1955 datë 30.12.2020 “Urdhër për ngritjen e grupit të punës për Hartimin e Regjistrit të Riskut për vitin 2021”. Miratimi i Regjistrit të Riskut për vitin 2021 Urdhër nr.28 nr.312/1 prot datë 19.02.2021.Urdhër nr.235 nr.prot.1885 datë 31.12.2021 “Urdhër për ngritjen e grupit të punës për Hartimin e Regjistrit të Riskut për vitin 2022”. Miratimi i Regjistrit të Riskut për vitin 2022 Urdhër nr.154/1 prot datë 18.01.2022;Tirana Parking menjëherë pas miratimit të ndryshimeve në strukturën organizative të institucionit miratuar me urdhër të kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.4143/1 datë 31.01.2022 protokolluar pranë TP me nr.104/3 datë 01.02.2022 ka marrë masat me qëllim hartimin e rregullores së re të institucionit në të cilën do të pasqyrohen edhe ndryshimet në pozicione në funksion të organizimit të punës së Institucionit. Nga ana e titullarit të institucionit është hartuar udhëri Nr.18 nr.prot.258 datë 01.02.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për rishikim e rregullores së brendshme të Tirana Parking” ndryshuar me Urdhërat Nr.104/4 prot datë 13.04.2023 “Për ndryshimin e anëtarit të grupit të punës për rishikimin e rregullores se brendshme të Tirana Parking”, Nr.13 nr.prot.125 datë 13.01.2023 “Për ndryshimin e anëtarit të grupit të punës për rishikimin e rregullores se brendshme të Tirana Parking”, Nr.86 nr.prot.125/1 datë 25.04.2023 “Për ndryshimin e anëtarit të grupit të punës për rishikimin e rregullores se brendshme të Tirana Parking”. Gjatë hartimit të rregullores së re është pasur parasysh edhe ndryshimi në vijim i strukturës i miratuar me urdhër nr.28272/1 prot datë 05.10.2022 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë protokolluar pranë TP me nr.1163/4 datë 07.10.2022. Drafti i përfunduar i Rregullores së re të institucionit është dërguar për miratimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë me Nr.125/2 prot datë 23.06.2023.

Gjurma e Auditit Nga ana e Institucionit Tirana Parking është hartuar urdhëri nr.109 nr.prot.1153/1 datë 07.07.2023 ‘Për një ndryshim në vendimin nr.129 datë 19.07.2018 për miratimin e gjurmëve të auditimit’ në të cilin janë pasqyruara ndryshimet në formatin e gjurmëve të auditimit referuar legjilacionit të ri për Prokurimin Publik. Në zbatim të MFK nga ana e Tirana Parking janë ngritur grupet e punës si dhe është hartuar kalendari i përgatitjes së PBA, janë organizuar mbledhjet çdo vit dhe kanë hartuar kërkesat buxhetore me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara në planet vjetore të punës dhe strategjisë së qëndrueshme të Bashkisë së Tiranës. Konkretisht: Urdhëri nr.222 nr.prot 1604/1 datë 26.10.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e PBA 2021-2023”. Kalendari i përgatitjes së PBA nr.1604/2 prot datë 26.10.2020. Mbledhja e mbajtur nr.prot 1604/4 datë 30.10.2020 ora 10.00. Urdhëri nr.58 nr. prot.600/1 datë 20.04.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e PBA 2022-2024” ndryshuar me urdherin nr.prot 600/4 datë 10.05.2021 per ndryshimin e nje anëtarit në urdhërin nr.58 për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e PBA 2022-2024”. Kalendari i përgatitjes së PBA nr.600/2 prot datë 21.04.2021. Mbledhja e mbajtur nr. prot 600/5 datë 14.05.2021 ora 10.00. Urdhëri nr.73 nr.815/1 prot datë 26.04.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e PBA 2023-2025”. Kalendari i përgatitjes së PBA nr.815/2 prot datë 26.04.2022. Mbledhje nr.prot.815/4 datë 28.04.2022 ora 10.00, mbledhje nr.prot 815/5 datë 29.04.2022 ora 12.30. Urdhëri nr.80 nr.prot.755/1 datë 11.04.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e PBA 2024-2026”. Kalendari i përgatitjes së PBA nr.755/2 prot datë 11.04.2023. Mbledhje nr.prot.755/5 datë 26.04.2023 ora 10.00”, mbledhje nr.prot.755/6 datë 27.04.2023 ora 10.30, mbledhje nr.prot 755/9 datë 28.04.2023 ora 12.30. (Bashkëlidhur dokumentacioni përkatës).

Oëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Lidhur me observacionin tuaj mbi pikën nr. 1 të Programit të Auditimit, ju sjellim në vëmendjen tuaj si më poshtë vijon: “Tirana Parking” është institucion varësie e Bashkisë Tiranë, por veprimtaria e saj mbështetet në VKB e miratuara nga Këshillat Bashkiakë respektivë (të cituar në material) dhe si e tillë i nështrohet edhe ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” si çdo njësi publike, duke filluar nga miratimi i një baze të plotë rregullatore, njohja nga stafi (të gjitha niveleve) i saj, përditësimi referuar çdo ndryshimi apo përmirësimi ligjor/nënligjor apo administrativ e rregullator. Të gjitha pretendimet tuaja kanë një burim: Mungesa e njohjes nga ana juaj dhe e stafit të njësisë me Ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin nga njëra anë, si dhe të kuptuarit qartë të funksioneve dhe fushës së veprimtarisë së njësisë tuaj publike dhe rolit që ka Bashkia Tiranë si organi epror. Rrjedhimisht Observacionet tuaja nuk kanë mbështetje ligjore së cilës t’i referohen .

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

II.2.2. “Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit”

Në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit nr. 317/1 Prot., datë 18.04.2023, “*Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit*” u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë Tirana Parking, Bashkia Tiranë

Në lidhje me planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit, si më poshtë:

Paga, shpërblime e të tjera personeli (llog. 600) dhe sigurimet shoqërore (llog. 601)

Niveli i realizimit të **llogarisë 600 “Pagat dhe përfitime të punonjësve”**, për vitin 2019, ka qenë 83%. Në pasqyrën e performancës, gjithashtu edhe në formatin nr. 8 të pasqyrës së numrit të punonjësve dhe fondit të pagave, kjo llogari është paraqitur në vlerën 79,476,572 lekë, ndërsa fakti i realizimit të kësaj llogarie deri në 31.12.2019, ka qenë në vlerën 79,225,573 lekë. Diferenca prej **250,999** lekë ka ardhur si pasojë e pagesave në muajin janar të vitit pasardhës.

Niveli i realizimit të **llogarisë 601 “Kontribute të sigurimeve”**, ka qenë 87%. Në pasqyrën e performancës, gjithashtu edhe në formatin nr. 8 të pasqyrës së numrit të punonjësve dhe fondit të pagave, kjo llogari është paraqitur në vlerën 13,240,954 lekë, ndërsa fakti i realizimit të kësaj llogarie deri në 31.12.2019, ka qenë në vlerën 13,196,615 lekë. Diferenca prej **44,339** lekë ka ardhur si pasojë e pagesave në muajin janar të vitit pasardhës.

Tabela Pagat, viti 2019

Nr.	Emërtimi viti	Viti 2019		
		P	R	%
1	Pagat (llog. 600)	95,515,860	79,225,573	83%
2	Sig.Shoq (llog. 601)	15,123,887	13,196,615	87%

Burimi: Drejtoria e Financës

Niveli i realizimit të **llogarisë 600 “Pagat dhe përfitime të punonjësve”**, për vitin 2020, ka qenë 83%. Në pasqyrën e performancës është paraqitur në vlerën 78,788,816 lekë, ndërsa në formatin nr. 8 të pasqyrës së numrit të punonjësve dhe fondit të pagave, kjo llogari është paraqitur në vlerën 24,610,471 lekë. Diferenca është në vlerën 54,178,345 lekë. Ndërkohë që fakti i realizimit është paraqitur në vlerën **78,949,423** lekë. Diferenca me vlerën e kësaj llogarie, të paraqitur te pasqyra e performancës, është në vlerën **(160,607)** lekë.

Niveli i realizimit të **llogarisë 601 “Kontribute të sigurimeve”**, ka qenë 87%. Në pasqyrën e performancës është paraqitur në vlerën 13,131,943 lekë, ndërsa në formatin nr. 8 të pasqyrës së numrit të punonjësve dhe fondit të pagave, kjo llogari është paraqitur në vlerën 3,172,440 lekë. Diferenca është në vlerën (9,959,503) lekë. Ndërkohë që fakti i realizimit është paraqitur në vlerën **13,158,410** lekë. Diferenca me vlerën e kësaj llogarie, të paraqitur te pasqyra e performancës, është në vlerën **(26,467)** lekë.

Tabela Pagat, viti 2020

Nr.	Emërtimi viti	Viti 2020		
		P	R	%
1	Pagat (llog. 600)	95,459,000	78,949,423	83%
2	Sig.Shoq (llog. 601)	15,160,000	13,158,410	87%

Burimi: Drejtoria e Financës

Niveli i realizimit të **llogarisë 600 “Pagat dhe përfitime të punonjësve”**, për vitin 2021, ka qenë 88%. Në pasqyrën e performancës është paraqitur në vlerën 84,357,674 lekë, ndërsa në formatin nr. 8 të pasqyrës së numrit të punonjësve dhe fondit të pagave, kjo llogari është

paraqitur në vlerën 81,072,604 lekë. Diferenca është në vlerën 3,285,070 lekë. Ndërkohë që fakti i realizimit është paraqitur në vlerën **84,050,767** lekë. Diferenca me vlerën e kësaj llogarie, të paraqitur te pasqyra e performancës, është në vlerën **306,907** lekë.

Niveli i realizimit të **llogarisë 601 “Kontribute të sigurimeve”**, ka qenë 89%. Në pasqyrën e performancës është paraqitur në vlerën 13,537,818 lekë, gjithashtu edhe në në formatin nr. 8 të pasqyrës së numrit të punonjësve dhe fondit të pagave, është në të njejtën vlerë. Ndërkohë që fakti i realizimit është paraqitur në vlerën **13,484,353** lekë. Diferenca me vlerën e kësaj llogarie, të paraqitur te pasqyra e performancës, është në vlerën **53,465** lekë.

Tabela Pagat, viti 2021

Nr.	Emërtimi viti	Viti 2021		
		P	R	%
1	Pagat (llog. 600)	95,389,800	84,050,767	88%
2	Sig.Shoq (llog. 601)	15,160,400	13,484,353	89%

Burimi: Drejtoria e Financës

Niveli i realizimit të **llogarisë 600 “Pagat dhe përfitime të punonjësve”**, për vitin 2022, ka qenë 85%. Në pasqyrën e performancës është paraqitur në vlerën 87,076,160 lekë, gjithashtu edhe në formatin nr. 8 të pasqyrës së numrit të punonjësve dhe fondit të pagave, është në të njejtën vlerë. Ndërkohë që fakti i realizimit është paraqitur në vlerën 85,677,373 lekë. Diferenca me vlerën e kësaj llogarie, të paraqitur te pasqyra e performancës, është në vlerën **1,398,787** lekë.

Niveli i realizimit të **llogarisë 601 “Kontribute të sigurimeve”**, ka qenë 89%. Në pasqyrën e performancës është paraqitur në vlerën 14,542,121 lekë, gjithashtu edhe në në formatin nr. 8 të pasqyrës së numrit të punonjësve dhe fondit të pagave, është në të njejtën vlerë. Ndërkohë që fakti i realizimit është paraqitur në vlerën **14,308,391** lekë. Diferenca me vlerën e kësaj llogarie, të paraqitur te pasqyra e performancës, është në vlerën **233,730** lekë.

Tabela Pagat, viti 2022

Nr.	Emërtimi viti	Viti 2022		
		P	R	%
1	Pagat (llog. 600)	101,144,840	85,677,373	85%
2	Sig.Shoq (llog. 601)	16,098,934	14,308,391	89%

Burimi: Drejtoria e Financës

- Nga verifikimi i pasqyrave konstatohet se pagat dhe sigurimet shoqërore rezultojnë me mos realizim për vitet 2019 - 2022, i cili është efekt kryesisht i vendeve vakante dhe punonjësve që kanë qenë me leje lindje.
- Nga auditimi i listë-pagesave u konstatua se listë-pagesat hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari.

Llogaria 12 “Rezultatet e mbartura”, në bilancin e vitit 2019 është paraqitur në vlerën **22,008,847** lekë. E njejtja llogari në bilancin e vitit 2020 është paraqitur në vlerën **57,282,158** lekë, ndërkohë që në akt rakordimin me thesarin për këtë vit është në vlerën **57,282,155** lekë. Përsa i takon bilancit të vitit 2021 në këtë llogari nuk është pasqyruar rezultat i mbartur nga viti i kaluar. E njejtja gjë vlen për po të njejtën llogari edhe në bilancin e vitit 2022, në të cilën nuk është pasqyruar rezultat i mbartur.

Duke qenë se nuk është pasqyruar rezultat i mbartur për bilancet e viteve 2021 dhe 2022, kjo pengon për të bërë krahasimin ndërmjet gjendjes në çelje të tij, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo ato kapitale.

Gjatë analizimit të urdhër-shpenzimeve për vitet 2019-2022, u konstatua se likuidimi i furnitorëve është bërë jashtë afatit më një diferencë ditore, por në disa raste edhe mujore, një, dy ose tre muaj pas afatit të përcaktuar në faturat përkatëse apo në kontratat e nënshkuara.

Në analizë Kontratat për investime

Për periudhën 2019 - 2022 janë kryer investime me burim financimi nga fondet e siguruara nga transferata e pakushtëzuar, nga të ardhurat e veta. Në analizë këto investime paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela Kontratat për investime, periudha 2019 – 2022

EMERTIMI I KONTRATES	Vlera me TVSH e kontrates	Likuiduar gjate vitit 2019	Likuiduar gjate vitit 2020	Likuiduar gjate vitit 2021	Likuiduar gjate vitit 2022	Likuiduar gjithsej per periudhen 2019 - 2022	Pa u likuiduar deri ne 31.12.2022
2019	26,879,826	459,788	25,159,657	-	900,347	26,519,792	360,034
2020	18,620,979	-	3,796,251	13,919,152	-	17,715,403	905,576
2021	34,237,513	-	-	17,193,845	16,005,600	33,199,445	1,038,068
2022	66,649,164	-	-	-	23,186,864	23,186,864	43,462,300
SHUMA PER PERIUDHEN 2019 - 2022	146,387,481	459,788	28,955,908	31,112,997	40,092,811	100,621,504	45,765,977

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion: Për vitet 2019 – 2022 janë lidhur dhe zbatuar 36 kontrata në vlerën **146,387,481** lekë për blerje aktive materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, rikonstruksione etj., të financuara nga buxheti i shtetit. Në **31.12.2022** kanë mbetur pa u likuiduar 18 kontrata, të cilat janë në vlerën **45,765,977** lekë.

2. Titulli i Gjetjes:	(Paga, shpërblime e të tjera personeli (Ilog. 600) dhe sigurimet shoqërore (Ilog. 601), mbi të cilat planifikimi i tyre nuk ka qenë i saktë
Situata:	Bazuar në tabelën e mësipërme, në seksionin shënime, janë vënë në dukje (Ilog. 600) paga, shpërblime e të tjera personeli dhe (Ilog. 601) sigurimet shoqërore mbi të cilat planifikimi i tyre nuk ka qenë i saktë, dhe devijanca e tyre në lidhje me realizimin është e lartë. Tirana Parking, në programimin e zërave të shpenzimeve të cilët nuk ka kryer një analizë e detajuar prioritarizmi duke qenë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara, duke cënuar kështu përdorimin me efikasitet, efektivitet dhe produktivitet të fondeve në dispozicion të institucionit, si më poshtë: Për vitet 2019 – 2022 janë lidhur dhe zbatuar 36 kontrata në vlerën 146,387,481 lekë për blerje aktive materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, rikonstruksione etj., të financuara nga buxheti i shtetit. Në 31.12.2022 kanë mbetur pa u likuiduar 18 kontrata, të cilat janë në vlerën 45,765,977 lekë.
Kriteri:	Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Mospërbushje e objektivave të shoqërisë.
Shkaku:	Planifikim dhe menaxhim jo i saktë i buxhetit të shoqërisë
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandim:	Tirana Parking, në të ardhmen, gjatë hartimit të buxheteve, të analizojë me kujdes situatën e institucionit, të hartojnë plane financiare për përmirësimin e

tyre, negocimin e kushteve më të mira si dhe mundësitë e shtimit të kapitalit të shoqërive. Të marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi si dhe të kryejë një planifikim të saktë të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke u bazuar dhe në vitet e mëparshme.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr. 2*, datë 12.06.2023

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 732/28 prot, datë 13.07.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Më lejoni tju sqaroj se diferencat e konstatuara në llogaritë 600 “Pagat dhe përfitime të punonjësve” dhe llogarinë 601 “Kontribute të Sigurimeve” ndërmjet situacionit vjetor të thesarit dhe formatit nr. 8 të pasqyrës së numrit të punonjësve në pasqyrat financiare të vitit vijnë pasi në pasqyrat financiare pasqyrohen shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore që përfshijnë periudhën kontabël 1 janar deri në 31 dhjetor të vitit, ndërsa në situacionet e thesarit përfshihen shpenzimet faktike për paga dhe sigurime gjatë periudhës të vitit buxhetor 01 janar deri në 31 dhjetor. Duke e shpjeguar më qartë në fillim të janarit të vitit pasardhës kalojnë pagat e muajit Dhjetor të vitit paraardhës, ky shpenzim është llogaritur si detyrim për tu paguar në pasqyrat financiarepor që si shpenzim faktik për efekt të vitit buxhetor kalon me faktin e Buxhetit të vitit pasardhës.

Në zbatim të VKB nr.158 datë 26.12.2019 “Për Miratimin e Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës” që nga hyrja në fuqi e të cilit në 01.01.2020, sipas përcaktimeve të Kreu II Tarifa e Parkimit të Automjeteve, Neni 44 Fusha e zbatimit dhe mënyra e pagesës, pika 2 ku shprehimisht thuhet: “Të ardhurat e gjeneruara nga Tirana Parking kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës. Të ardhurat xhirohen në llogarinë e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës, dhe Tirana Parking kryen çdo muaj akt-rakordimet me Degën e Thesarit dhe raporton në Bashkinë e Tiranës”.

Përsa i përket mos paraqitjes së shumës 57.282.158 lekë në bilancin e vitit 2021 dhe 2022 ju sqaroj se vlera prej 57.282.158 lekë ka kaluar në fondet e Bashkisë Tiranë siç mund ta vini re në Akt Rakordimin mbi realizimin, përdorimin e të ardhurave për vitin 2020 dhe mbartjen për vitin 2021 të Bashkisë Tiranë me Degën e Thesarit Tiranë në datën 18.03.2021, K1 “TË ARDHURA PËR TU TRASHËGUAR” rrjeshti 1, Të ardhura të trashëguara nga Tirana Parking në vlerën 57.282.158 lekë. Pra që nga data 18.03.2021 këto të ardhura kanë kaluar në përdorim të Bashkisë Tiranë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Për sa më sipër, në lidhje me observacionin e dërguar nga përfaqësuesit e subjektit, gjetjet e mesipërme konsistojnë në lidhje me realizimin e zërave të parashikuar në buxhet, pra raporti plan/fakt i tyre dhe jo në lidhje me regjistrimin apo pasqyrimin e tyre. Gjithashtu dhe përsa i përket vlerës prej 57,282,158 lekë konsiston në faktin që është paraqitur në vitet e kaluara si rezultat i mbartur.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

II.2.3. “Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi”.

Pasqyrat financiare për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 janë përgatitur dhe dërguar brenda afateve ligjore në Degën e Thesarit Tiranë. Për vitin 2019 janë dorëzuar me shkresë përcjellëse Nr. 664 prot., datë 25.03.2020; për vitin 2020 janë dorëzuar me shkresën Nr. 523 prot., datë 30.03.2021; për vitin 2021 janë dorëzuar me shkresën Nr. 645 prot. datë 28.03.2022; dhe për vitin 2022 janë dorëzuar me shkresën Nr. 651 prot., datë 24.03.2023.

Drejtoria e Financës në Tirana Parking, për regjistrimin dhe kontabilizimin e veprimeve financiare përdor programin financiar “IMPRO”, program që përdoret dhe nga njëjës kryesore “Bashkia Tiranë” për konsolidimin e tyre, nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit regjistrimet kontabël në këtë program nuk janë bërë në mënyrë të rregullt dhe të vijueshme duke mbartur gabime të mëparshme dhe duke mos qenë eficient në përdorim.

Nga auditimi i pasqyrave financiare vihet re se, pjesa e shënimeve shpjeguese është plotësuar pjesërisht dhe nuk janë përfshirë në mënyrë të detajuar të gjitha informacionet dhe përshkrimet e nevojshme. *Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 3.7 “Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale”, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.*

3. Titulli i gjetjes:	Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të përgatitura për vitet 2019 – 2022, nga Drejtoria e Financës në Tirana Parking, janë plotësuar pjesërisht.
Situata:	Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se shënimet shpjeguese nuk janë të plotësuara me detaje dhe informacione sqaruese të nevojshme për t'u pasqyruar, përveç atyre informacioneve që paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të aktiveve neto/fondeve neto. Plotësimi i tyre është realizuar pjesërisht dhe nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, në të cilin jepen informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë dhe të qartë të pasqyrave financiare.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 3.7 “Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale”, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e informacionit analitik dhe të detajuar të llogarive përkatëse.
Shkaku:	Mos vlerësim nga Drejtoria e Financës.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga Drejtoria e Financës të merren masat që në vijimësi, shënimet shpjeguese të plotësohen në mënyrë të saktë dhe të detajuar, në përputhje me SKK, duke dhënë informacionin e nevojshëm dhe të domosdoshëm për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

▪ Pasqyra e pozicionit financiar – **Viti 2019**

- Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet – Pasivet = **391,360,428** lekë.
- Aktivet **422,801,418** lekë
- Pasivet **31,440,990** lekë
- Aktivet neto **391,360,428** lekë.

Aktivët në akt rakordimin me thesarin, për vitin 2019, rezultojnë në vlerën **252,990,822** lekë, vlerë e cila nuk është e njëjtë me vlerën **422,801,418** lekë, të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar. Diferenca rezulton të jetë në vlerën **169,810,596** lekë. Ndërsa aktivët neto në akt

rakordimin me thesarin kanë qenë në vlerën **225,093,592** lekë, ndërkohë që në pasqyrën e pozicionit financiar, janë paraqitur në vlerën **391,360,428** lekë.

▪ Pasqyra e pozicionit financiar – *Viti 2020*

- Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet – Pasivet = **390,740,618** lekë.
- Aktivet **411,734,771** lekë
- Pasivet **20,994,153** lekë
- Aktivet neto **390,740,618** lekë.

Aktivitet në akt rakordimin me thesarin, për vitin 2020, rezultojnë në vlerën **243,584,624** lekë, vlerë e cila nuk është e njëjtë me vlerën **411,734,771** lekë të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar. Diferenca rezulton të jetë në vlerën **168,150,147** lekë. Ndërsa aktivet neto në akt rakordimin me thesarin kanë qenë në vlerën **228,846,711** lekë, ndërkohë që në pasqyrën e pozicionit financiar, janë paraqitur në vlerën **390,740,618** lekë.

▪ Pasqyra e pozicionit financiar – *Viti 2021*

- Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet – Pasivet = **231,942,451** lekë.
- Aktivet **263,957,119** lekë
- Pasivet **32,014,668** lekë
- Aktivet neto **231,942,451** lekë.

Aktivitet në akt rakordimin me thesarin, për vitin 2021, rezultojnë në vlerën **255,221,590** lekë, vlerë e cila nuk është e njëjtë me vlerën **263,957,119** lekë të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar. Diferenca rezulton të jetë në vlerën **8,735,529** lekë. Ndërsa aktivet neto në akt rakordimin me thesarin kanë qenë në vlerën **229,463,162** lekë, ndërkohë që në pasqyrën e pozicionit financiar, janë paraqitur në vlerën **231,942,451** lekë.

▪ Pasqyra e pozicionit financiar – *Viti 2022*

- Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet – Pasivet = **256,964,901** lekë.
- Aktivet **299,591,064** lekë
- Pasivet **42,626,163** lekë
- Aktivet neto **256,964,901** lekë.

Aktivitet në akt rakordimin me thesarin, për vitin 2022, rezultojnë në vlerën **289,438,865** lekë, vlerë e cila nuk është e njëjtë me vlerën **299,591,064** lekë të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar. Diferenca rezulton të jetë në vlerën **10,152,199** lekë. Ndërsa aktivet neto në akt rakordimin me thesarin kanë qenë në vlerën **255,970,617** lekë, ndërkohë që në pasqyrën e pozicionit financiar, janë paraqitur në vlerën **256,964,901** lekë.

Në akt rakordimet me thesarin, për të gjitha vitet, vihet re mungesa e vlerës për disa llogari. Kjo ka sjellë fenomenin që vlera e totalit të aktiveve dhe pasiveve në rakordimet me thesarin, të mos jetë e njëjtë me atë të pasqyrave financiare.

Aktivitet Afatshkurtra

Aktivitet afatshkurta më datë **31.12.2019** janë paraqitur në vlerën **219,619,704** lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën **169,810,596** lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën **20,004,339** lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën **11,736,180** lekë.

- Llogaria e Klasës 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën **18,068,589** lekë.

Aktivët afatshkurta më datë **31.12.2020** janë paraqitur në vlerën **212,231,583** lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën **168,150,147** lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën **26,067,152** lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën **18,014,284** lekë.
- Llogaria e Klasës 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën **0** lekë.

Aktivët afatshkurta më datë **31.12.2021** janë paraqitur në vlerën **60,236,618** lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën **8,735,529** lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën **23,520,230** lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën **15,668,038** lekë.
- Llogaria e Klasës 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën **12,312,821** lekë.

Aktivët afatshkurta më datë **31.12.2022** janë paraqitur në vlerën **67,252,294** lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën **10,152,199** lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën **19,924,411** lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën **37,175,684** lekë.
- Llogaria e Klasës 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën **0** lekë.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, përbëhet nga:

-Gjendja e llogarisë nr. 520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së bilancit të vitit 2019 është në vlerën **58,918,376** lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” në vlerën **168,021,499** lekë dhe rubrikën VI “Teprica e Likuidimeve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën **169,810,596** lekë, ku kjo e fundit përbëhet nga vlera e llogarisë 520 dhe vlera **110,892,220** lekë e llogarisë 532 “Vlera të tjera”. (sipas formatit “Pasqyra e flukseve monetare”).

$$Llog. 520 + Llog.532 = 58,918,376 + 110,892,220 = 169,810,596$$

-Gjendja e llogarisë nr. 520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së bilancit të vitit 2020 është në vlerën **60,262,027** lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” në vlerën **169,810,596** lekë dhe rubrikën VI “Teprica e Likuidimeve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën **168,150,147** lekë, ku kjo e fundit përbëhet nga vlera e llogarisë 520 dhe vlera **107,888,120** lekë e llogarisë 532 “Vlera të tjera”. (sipas formatit “Pasqyra e flukseve monetare”).

$$Llog. 520 + Llog.532 = 60,262,027 + 107,888,120 = 168,150,147$$

-Gjendja e llogarisë nr. 520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së bilancit të vitit 2021 është në vlerën **4,033,809** lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” në vlerën **168,150,147** lekë dhe rubrikën VI “Teprica e Likuidimeve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën **8,735,529** lekë, ku kjo e fundit përbëhet nga vlera e llogarisë 520 dhe vlera **4,701,720** lekë e llogarisë 532 “Vlera të tjera”. (sipas formatit “Pasqyra e flukseve monetare”).

$$Llog. 520 + Llog.532 = 4,033,809 + 4,701,720 = 8,735,529.$$

-Gjendja e llogarisë nr. 520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së bilancit të vitit 2022 është në vlerën **5,450,479** lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit

ushtrimor” në vlerën **8,735,529** lekë dhe rubrikën VI “Teprica e Likuidimeve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën **10,152,199** lekë, ku kjo e fundit përbëhet nga vlera e llogarisë 520 dhe vlera **4,701,720** lekë e llogarisë 532 “Vlera të tjera” (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”).

$$Llog. 520 + Llog.532 = 5,450,479 + 4,701,720 = 10,152,199$$

- Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Tirana Parking, në 31.12.2019 janë paraqitur në vlerën **20,004,339** lekë dhe përbëhen nga llogaria 31 “Materiale” në vlerën 19,203,465 lekë dhe nga llogaria 32 “Inventar i imët” në vlerën **800,874** lekë.

- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në vlerën **494,175** lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit”, e cila është paraqitur në vlerën **1,058,125** lekë.

Tabela nr.1 Llogaritë e klasës 3 “Gjendje e inventarit qarkullues”, viti 2019

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2019	Viti 2018	Diferenca 2019 – 2018
31	Materiale	19,203,465	18,759,234	444,231
32	Inventar I imet	800,874	750,930	49,944
33	Prodhim ne proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Kafshe ne rritje e majmeri			
37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve			
38	Diferenca nga cmimet e magazinimit			
39	Provigjone per zhvlersimin e inventarit (-)			
TOTALI		20,004,339	19,510,164	494,175

Burimi: Drejtoria e Financës

- Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Tirana Parking në 31.12.2020 janë paraqitur në vlerën **26,067,152** lekë dhe përbëhen nga llogaria 31 “Materiale” në vlerën 23,921,558 lekë dhe nga llogaria 32 “Inventar i imët” në vlerën 2,145,594 lekë.

- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në vlerën **6,062,813** lekë, e cila nuk kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit”, e cila është paraqitur në vlerën **(3,058,713)** lekë.

Tabela nr.2 Llogaritë e klasës 3 “Gjendje e inventarit qarkullues”, viti 2020

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca 2020 – 2019
31	Materiale	23,921,558	19,203,465	4,718,093
32	Inventar I imet	2,145,594	800,874	1,344,720
33	Prodhim nre proces	-	-	-
34	Produkte	-	-	-
35	Mallra	-	-	-
36	Kafshe ne rritje e majmeri	-	-	-
37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve	-	-	-
38	Diferenca nga cmimet e magazinimit	-	-	-
39	Provigjone per zhvlersimin e inventarit (-)	-	-	-
TOTALI		26,067,152	20,004,339	6,062,813

Burimi: Drejtoria e Financës

- Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Tirana Parking në 31.12.2021 janë paraqitur në vlerën **23,520,230** lekë dhe përbëhen nga llogaria 31 “Materiale” në vlerën 21,203,113 lekë dhe nga llogaria 32 “Inventar i imët” në vlerën 2,317,117 lekë.

- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në vlerën **(2,546,922)** lekë, e cila nuk kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit”, e cila është paraqitur në vlerën **105,733,322** lekë.

Tabela nr.3 Llogaritë e klasës 3 “Gjendje e inventarit qarkullues”, viti 2021

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021 – 2020
31	Materiale	21,203,113	23,921,558	-2,718,445
32	Inventar I imet	2,317,117	2,145,594	171,523
33	Prodhim nre proces	-	-	-
34	Produkte	-	-	-
35	Mallra	-	-	-
36	Kafshe ne rritje e majmeri	-	-	-
37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve	-	-	-
38	Diferenca nga cmimet e magazinimit	-	-	-
39	Provigjone per zhvlersimin e inventarit (-)	-	-	-
TOTALI		23,520,230	26,067,152	-2,546,922

Burimi: Drejtoria e Financës

- Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Tirana Parking në 31.12.2022 janë paraqitur në vlerën **19,924,411** lekë dhe përbehen nga llogaria 31 “Materiale” në vlerën **16,561,403** lekë dhe nga llogaria 32 “Inventar i imët” në vlerën **3,363,008** lekë.
- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën (3,595,819) lekë, e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në vlerën (3,595,819) lekë.

Tabela nr.4 Llogaritë e klasës 3 “Gjendje e inventarit qarkullues”, viti 2022

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022 – 2021
31	Materiale	16,561,403	21,203,113	-4,641,710
32	Inventar I imet	3,363,008	2,317,117	1,045,891
33	Prodhim nre proces	-	-	-
34	Produkte	-	-	-
35	Mallra	-	-	-
36	Kafshe ne rritje e majmeri	-	-	-
37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve	-	-	-
38	Diferenca nga cmimet e magazinimit	-	-	-
39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)	-	-	-
TOTALI		19,924,411	23,520,230	-3,595,819

Burimi: Drejtoria e Financës

Llogaria 32 “Inventar i imët”, për vitin 2019, ka vlerën 800,874 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor.

Llogaria 32 “Inventar i imët”, për vitin 2020, kjo llogari në pasqyrën e pozicionit financiar ka vlerën 2,145,594 lekë dhe nuk përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor, që është paraqitur në vlerën 2,455,075 lekë. Diferenca rezulton në vlerën **309,481 lekë**.

Llogaria 32 “Inventar i imët” për vitin 2021, ka vlerën 2,317,117 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor.

Llogaria 32 “Inventar i imët”, për vitin 2022, ka vlerën 3,363,008 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor.

Për vitin 2022, llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat, në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit, në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”. Ndërsa për vitet e kaluara 2019, 2020 dhe 2021, duke marrë në konsideratë diferencat që kanë rezultuar, nuk ka pasur një funksionim të mirë për shtesat dhe pakësimet e kësaj llogarie.

Llogaritë e Arkëtueshme

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fillim të vitit 2019 është në vlerën historike 0 lekë dhe në fund të vitit 2018 në vlerën historike 0 lekë. Llogaria 468, nuk rezulton me vlerë për fundin e vitit 2018 dhe as për gjithë vitin 2019. Nga auditimi ka rezultuar se ky është një

fenomen që vihat re edhe për vitet 2020, 2021 dhe 2022 në Tirana Parking, ku kjo llogari është paraqitur në vlerën 0 lekë.

Nga grupi i auditimit u konstatua se, **llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, për vitin 2019, ka rezultuar në vlerën 18,068,589 lekë, vlerë e cila përputhet edhe me rakordimet me thesarin.

Nga grupi i auditimit u konstatua se **llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, për vitin 2020, ka rezultuar në vlerën 0 lekë, vlerë e cila përputhet edhe me rakordimet me thesarin.

Nga grupi i auditimit u konstatua se **llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, për vitin 2021, ka rezultuar në vlerën 12,312,821 lekë, vlerë e cila përputhet edhe me rakordimet me thesarin.

Nga grupi i auditimit u konstatua se **llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, për vitin 2022, ka rezultuar në vlerën 0 lekë, vlerë e cila përputhet edhe me rakordimet me thesarin.

Llogaria 411 “Klientë e llogari te ngjashme”, në pasqyrën e pozicionit financiar, të vitit 2019 është paraqitur në vlerën 3,543,760 lekë, për vitin 2020 është paraqitur në vlerën 6,256,240 lekë, për vitin 2021 është paraqitur në vlerën 7,529,115 lekë dhe për vitin 2022 është paraqitur në vlerën 10,430,790 lekë.

Aktivet afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, **për vitin 2019**, përbëhen nga llog. 202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 2,979,994 lekë në fund të vitit 2019 dhe në vitin 2018 në vlerën 2,680,120 lekë. Gjithashtu sipas formatit 7/b “Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (vlera neto)”, në fund të vitit ushtrimor 2019 llogaria nr.202 “Studime dhe kërkime”, është paraqitur në vlerën 2,979,994 lekë.

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, **për vitin 2020**, përbëhen nga llog. 202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 2,532,995 lekë në fund të vitit. Gjithashtu sipas formatit 7/b “Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (vlera neto)”, në fund të vitit ushtrimor 2020 llogaria nr.202 “Studime dhe kërkime”, është paraqitur në vlerën 2,532,995 lekë.

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, **për vitin 2021**, përbëhen nga llog. 202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 2,153,046 lekë në fund të vitit. Gjithashtu sipas formatit 7/b “Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (vlera neto)”, në fund të vitit ushtrimor 2021 llogaria nr.202 “Studime dhe kërkime”, është paraqitur në vlerën 2,153,046 lekë.

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, **për vitin 2022**, përbëhen nga llog. 202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 14,844,811 lekë në fund të vitit. Gjithashtu sipas formatit 7/b “Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (vlera neto)”, në fund të vitit ushtrimor 2022 llogaria nr.202 “Studime dhe kërkime”, është paraqitur në vlerën 14,844,811 lekë.

Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2019 është paraqitur në vlerën **2,979,994** lekë. E njejta llogari në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2020 është paraqitur në vlerën **2,532,995** lekë. Në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2021 është paraqitur në vlerën **2,153,046** lekë dhe në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2022 është paraqitur në vlerën **14,844,811** lekë.

**Nga ana e përfaqësuesve të institucionit, nuk i janë vënë në dispozicion llogaritë analitike grupit të auditimit.*

Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)

Llogaritë e klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale” AAM, **për vitin 2019**, sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrën e gjendjeve dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (vlera neto), vlera kontabël neto paraqitet në shumën **190,904,894** lekë, pas amortizimit që ka qenë në vlerën **50,920,027** lekë. Ndërsa sipas pasqyrës së gjendjeve dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), gjendja në fund pas shtesave dhe pakësimeve, në mbylljen e vitit ushtrimor 2019, paraqitet në vlerën **241,824,921** lekë.

- Llogaritë e klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale” AAM, **për vitin 2020**, sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrën e gjendjeve dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (vlera neto), vlera kontabël neto paraqitet në shumën **196,970,193** lekë, pas amortizimit që ka qenë në vlerën **72,293,742** lekë. Ndërsa sipas pasqyrës së gjendjeve dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), gjendja në fund pas shtesave dhe pakësimeve, në mbylljen e vitit ushtrimor 2020, paraqitet në vlerën **269,263,935** lekë.
- Llogaritë e klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale” AAM, **për vitin 2021**, sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrën e gjendjeve dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (vlera neto), vlera kontabël neto paraqitet në shumën **201,567,455** lekë, pas amortizimit që ka qenë në vlerën **95,704,293** lekë. Ndërsa sipas pasqyrës së gjendjeve dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), gjendja në fund pas shtesave dhe pakësimeve, në mbylljen e vitit ushtrimor 2021, paraqitet në vlerën **297,271,748** lekë.
- Llogaritë e klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale” AAM, **për vitin 2022**, sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrën e gjendjeve dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (vlera neto), vlera kontabël neto paraqitet në shumën **204,848,691** lekë, pas amortizimit që ka qenë në vlerën **123,184,003** lekë. Ndërsa sipas pasqyrës së gjendjeve dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), gjendja në fund pas shtesave dhe pakësimeve, në mbylljen e vitit ushtrimor 2022, paraqitet në vlerën **328,032,694** lekë.

Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2019 është paraqitur në vlerën **8,161,678** lekë. E njejta llogari në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2020 është paraqitur në vlerën **7,753,594** lekë. Në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2021 është paraqitur në vlerën **6,202,875** lekë dhe në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2022 është paraqitur në vlerën **4,962,300** lekë.

**Nga ana e përfaqësuesve të institucionit, nuk i janë vënë në dispozicion llogaritë analitike grupit të auditimit.*

Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2019 është paraqitur në vlerën **108,345,358** lekë. E njejta llogari në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2020 është paraqitur në vlerën **125,610,609** lekë. Në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2021 është paraqitur në vlerën **133,445,154** lekë dhe në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2022 është paraqitur në vlerën **126,772,896** lekë.

**Nga ana e përfaqësuesve të institucionit, nuk i janë vënë në dispozicion llogaritë analitike grupit të auditimit*

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri dhe pajisje”, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2019 është paraqitur në vlerën **54,447,120** lekë. E njejta llogari në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2020 është paraqitur në vlerën **44,641,115** lekë. Në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2021 është paraqitur në vlerën **46,452,686** lekë dhe në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2022 është paraqitur në vlerën **56,014,203** lekë.

**Nga ana e përfaqësuesve të institucionit, nuk i janë vënë në dispozicion llogaritë analitike grupit të auditimit.*

Llogaria 215 “Mjete Transporti”, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2019 është paraqitur në vlerën **3,586,484** lekë. E njejta llogari në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2020 është paraqitur në vlerën **3,091,549** lekë. Në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2021 është paraqitur në vlerën **2,473,239** lekë dhe në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2022 është paraqitur në vlerën **1,978,591** lekë.

**Nga ana e përfaqësuesve të institucionit, nuk i janë vënë në dispozicion llogaritë analitike grupit të auditimit.*

Llogaria 218 “Inventari ekonomik”, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2019 është paraqitur në vlerën **16,364,254** lekë. E njejta llogari në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2020 është paraqitur në vlerën **15,873,326** lekë. Në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2021 është paraqitur në vlerën **12,993,501** lekë dhe në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2022 është paraqitur në vlerën **15,120,701** lekë.

Llogaria 219 “Amortizimi i akumuluar”, për vitin 2019, sipas të dhënave të Tirana Parking, për AAGJM është paraqitur në vlerën **50,920,027** lekë dhe AAGJIM është paraqitur në vlerën **1,047,691** lekë. Vlera totale për amortizimin e akumuluar për vitin 2019 është **51,967,718** lekë.

Referuar tabelës formati 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”, totali i amortizimit për vitin 2019 për klasat e aktiveve, është përlllogaritur në vlerën prej (**51,967,718**) lekë, duke debituar llogarinë nr. 1013 “Nga konsumi i AAGJ” (formati 4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”), në kredi të llogarive llogarisë nr. 2192 “Amortizimi ndërtesa dhe konstruksione” në vlerën 747,047 lekë, llogarisë nr. 2193 “Rruge , rrjete , vepra ujore” ne vlerën 16,687,496 leke ,llogarisë nr. 2194 “Amortizim makineri dhe pajisje” në vlerën 30,034,982 lekë, llogarisë nr. 2195 “Amortizim mjete transporti” në vlerën 2,340,525 lekë, llogarisë nr. 2198 “Amortizim inventar ekonomik” në vlerën 1,109,977 lekë.

Llogaria 219 “Amortizimi i akumuluar”, për vitin 2020, sipas të dhënave të Tirana Parking, për AAGJM është paraqitur në vlerën **72,293,742** lekë dhe AAGJIM është paraqitur në vlerën **1,494,690** lekë. Vlera totale për amortizimin e akumuluar për vitin 2020 është **73,788,432** lekë.

Referuar tabelës formati 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”, totali i amortizimit për vitin 2020 për klasat e aktiveve, është përlllogaritur në vlerën prej (**73,788,432**) lekë, duke debituar llogarinë nr. 1013 “Nga konsumi i AAGJ” (formati 4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”), në kredi të llogarive llogarisë nr. 2192 “Amortizimi ndërtesa dhe konstruksione” në vlerën 1,155,131 lekë, llogarisë nr. 2193 “Rruge , rrjete , vepra ujore” ne vlerën 22,888,059 leke ,llogarisë nr. 2194 “Amortizim makineri dhe pajisje” në vlerën 43,814,187 lekë, llogarisë nr. 2195 “Amortizim mjete transporti” në vlerën 2,835,460 lekë, llogarisë nr. 2198 “Amortizim inventar ekonomik” në vlerën 1,600,905 lekë.

Llogaria 219 “Amortizimi i akumuluar”, për vitin 2021, sipas të dhënave të Tirana Parking, për AAGJM është paraqitur në vlerën **95,704,293** lekë dhe AAGJIM është paraqitur në vlerën **1,874,639** lekë. Vlera totale për amortizimin e akumuluar për vitin 2021 është **97,578,932** lekë.

Referuar tabelës formati 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”, totali i amortizimit për vitin 2021 për klasat e aktiveve, është përlllogaritur në vlerën prej (**97,578,932**) lekë, duke debituar llogarinë nr. 1013 “Nga konsumi i AAGJ” (formati 4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”), në kredi të llogarive llogarisë nr. 2192 “Amortizimi ndërtesa dhe konstruksione” në vlerën 2,705,850 lekë, llogarisë nr. 2193 “Rruge , rrjete , vepra ujore” ne vlerën 29,718,527 leke ,llogarisë nr. 2194 “Amortizim makineri dhe pajisje” në vlerën

55,017,816 lekë, llogarisë nr. 2195 “Amortizim mjete transporti” në vlerën 3,453,770 lekë, llogarisë nr. 2198 “Amortizim inventar ekonomik” në vlerën 4,808,330 lekë.

Llogaria 219 “Amortizimi i akumuluar”, për vitin 2022, sipas të dhënave të Tirana Parking, për AAGJM është paraqitur në vlerën **123,184,003** lekë dhe AAGJMM është paraqitur në vlerën **4,700,512** lekë. Vlera totale për amortizimin e akumuluar për vitin 2022 është **127,884,515** lekë. Referuar tabelës formati 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”, totali i amortizimit për vitin 2022 për klasat e aktiveve, është përlllogaritur në vlerën prej (**127,884,515**) lekë, duke debituar llogarinë nr. 1013 “Nga konsumi i AAGJ” (formati 4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”), në kredi të llogarive llogarisë nr. 2192 “Amortizimi ndërtesa dhe konstruksione” në vlerën 3,946,425 lekë, llogarisë nr. 2193 “Rruge , rrjete , vepra ujore” ne vlerën 36,390,785 leke ,llogarisë nr. 2194 “Amortizim makineri dhe pajisje” në vlerën 71,320,305 lekë, llogarisë nr. 2195 “Amortizim mjete transporti” në vlerën 3,948,418 lekë, llogarisë nr. 2198 “Amortizim inventar ekonomik” në vlerën 7,578,070 lekë.

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë sipas normave të amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36, *të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022*. Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh.

Në lidhje me Inventarizimin e asetëve:

Procesi i inventarizimit në Tirana Parking për vitin **2019** është kryer sipas Urdhrit Nr. 268, datë 16.12.2019, nr. 1677 prot., “Për ngritjen e grupit të punës për inventarizimin e magazinës”. Inventarizimi për vitin **2020** është kryer sipas Urdhrit Nr. 254, datë 15.12.2020, nr. 1883 prot., “Për ngritjen e grupit të punës për inventarizimin e magazinës”. Inventarizimi për vitin **2021** është kryer sipas Urdhrit Nr. 212, datë 15.12.2021, nr. 1798 prot., “Për ngritjen e grupit të punës për inventarizimin e magazinës”. Inventarizimi për vitin **2022** është kryer sipas Urdhrit Nr. 215, datë 15.12.2021, nr. 1959 prot., “Për ngritjen e grupit të punës për inventarizimin e magazinës”. Në Tirana Parking është miratuar dhe Rregullorja për Administrimin e Aktiveve, bazuar në Urdhër Nr. 100, datë 28.05.2020, nr. 763/2 prot., “Për miratimin e rregullores për administrimin e aktiveve në institucionin Tirana Parking”.

Në Tirana Parking për vitet objekt auditimi, bazuar në urdhrat e lartpërmendur, vihet re se është ngritur vetëm komisioni i cili ka kryer thjesht dhe vetëm inventarizimin fizik të magazinës, por nuk janë hartuar urdhra për ngritjen e një komisioni vlerësimi të aktiveve. Si rrjedhojë, rezulton se procesi i inventarizimit është i papërfunduar. *Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 95 - 99.*

4. Titulli i gjetjes:	Në Drejtorinë e Tirana Parking nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit, për vitet objekt auditimi.
Situata:	Për vitet objekt auditimi 2019 – 2022, në Drejtorinë e Tirana Parking nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit, duke sjellë si rrjedhojë mungesën e vlerësimit të gjendjes reale të aktiveve, amortizimit të tyre dhe përcaktimin për nxjerrje jashtë përdorimit, sipas gjendjes së vlerësuar dhe nevojës.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik te aktiveve”, pika 95 - 99.

Ndikimi/Efekti:	Nuk bëhet i mundur identifikimi dhe vlerësimi i gjendjes reale të aseteve dhe nga ana tjetër kemi rritje të vlerës së amortizimit, si pasojë e mos nxjerrjes jashtë përdorimit.
Shkaku:	Neglizhenca e krijuar nga ana personave përgjegjës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Drejtoria e Financës në Tirana Parking të merren masat që në vijimësi, procesi i inventarizimit të kryhet i plotë duke kaluar nëpër të gjitha etapat si inventarizimi fizik, vlerësimi i gjendjes së aktiveve dhe nxjerrja jashtë përdorimit për aktivet sipas nevojës, duke u bazuar në gjendjen e tyre reale të amortizimit, të evidentuar gjatë procesit të inventarizimit.

Nga auditimi i të dhënave vetëm në formë shkresore, pasi nuk disponoheshin në formë elektronike, të marra nga Tirana Parking, rezulton se është realizuar procesi i inventarizimit fizik për të gjitha vitet objekt auditimi.

Për vitin 2019, është kryer procesi i inventarizimit fizik bazuar në raportin e përgatitur me nr. 1677/2 prot., datë 31.12.2019. Në këtë raport komisioni ka vërejtur, se në magazinën e Tirana Parking ka pasur pajisje elektronike të cilat kanë rezultuar të amortizuara si kompjuterë, ngrohës elektrikë, tableta dhe pajisje për sheshet. Komisioni gjithashtu ka konstatuar se në magazinë ka pasur materiale që duhet të asgjësoheshin si bluza dhe uniforma, që kanë qenë të dëmtuara dhe të mykura. Për më tepër komisioni ka konstatuar edhe një sasi biletash parkimi në rrugë, të cilave u kishte kaluar afati i përdorimit sipas vitit të përcaktuar në to, për të cilat komisioni është shprehur se duhet të asgjësoheshin.

Gjatë analizimit të inventarëve të vitit 2019, vihet re se nuk është nxjerrë jashtë përdorimit asnjë aset (produkt), edhe pse duke u nisur nga vitet dhe nga norma e amortizimit, ekzistojnë asete si kompjuterë, tableta etj., të cilat janë plotësisht të amortizuara. Gjithashtu ka rezultuar se nuk është marrë në konsideratë evidentimi i komisionit për asgjësimin e bluzave dhe uniformave të dëmtuara.

Nga konstatimet e komisionit të inventarizimit fizik është marrë parasysh vetëm varianti për asgjësimin e biletave të parkimit në rrugë, që u kishte mbaruar afati i vlefshmërisë, për të cilat është hartuar një urdhër në periudhë më të vonë se 1 vit, që nga momenti i konstatimit. Bashkëlidhur me këtë raport nuk ekziston një procesverbal i hartuar, në të cilin të jenë specifikuar sasia e secilit prej artikujve të lart përmendur, që komisioni i inventarizimit fizik i ka gjykuar si të amortizuara dhe që i ka evidentuar për asgjësim. Nuk është hartuar asnjë urdhër tjetër pas përfundimit të procesit të inventarizimit fizik, për të bërë vlerësimin e gjendjes së aktiveve të tjera të amortizuara. *Këto veprime janë në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pikat 102-106 dhe 107 - 120.*

5. Titulli i gjetjes:	Në Drejtorinë e Tirana Parking, pas përfundimit të procesit të inventarizimit fizik të vitit 2019, nuk janë marrë në konsideratë konstatimet që ka bërë komisioni i inventarizimit fizik për gjendjen e aktiveve të amortizuara dhe materialeve të dëmtuara nga koha.
Situata:	Në raportin e inventarizimit fizik për vitin 2019, komisioni i inventarizimit ka konstatuar se në magazinën e Tirana Parking ka pajisje elektronike të cilat kanë rezultuar të amortizuara, si kompjuterë, ngrohës elektrikë, tableta dhe pajisje për sheshet. Gjithashtu ka edhe materiale që duhet të asgjësoheshin, si bluza

	dhe uniforma, që kanë qenë të dëmtuara dhe të mykura. Për të shtuar më tej edhe një sasi biletash parkimi në rrugë, të cilave u kishte kaluar afati i përdorimit sipas vitit të përcaktuar në to, për të cilat komisioni është shprehur se duhet të asgjësoheshin. Nga ana tjetër, nuk është hartuar asnjë urdhër për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së këtyre aktiveve dhe gjithashtu nxjerrjen jashtë përdorimit të atyre aktiveve, të cilat janë konstatuar në kushte të papërshtatshme për t'u ripërdorur, si pasojë e dëmtimit të tyre përgjatë kohës së qëndrimit në magazinë.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pika 102 – 106 dhe 107 – 120.
Ndikimi/Efekti:	Duke mos kryer të plotë procesin e inventarizimit të aseteve, nuk bëhet i mundur vlerësimi i gjendjes reale të tyre, duke sjellë kështu rritje të vlerës së amortizimit ndër vite, si pasojë e mos nxjerrjes jashtë përdorimit dhe gjithashtu mbajtjen e materialeve, që janë të papërshtatshme për t'u ripërdorur, si pasojë e dëmtimit përgjatë kohës, në ambientet e magazinës.
Shkaku:	Neglizhenca nga Drejtoria e Financës.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Drejtoria e Financës në Tirana Parking të merren masat që në vijimësi, procesi i inventarizimit të kryhet i plotë duke kaluar nëpër të gjitha etapat e procesit të inventarizimit që paraqiten në kuadrin ligjor, si dhe asetet e amortizuara dhe materialet e dëmtuara, në kushte të papërshtatshme për t'u ripërdorur, të vlerësohen dhe sipas nevojave përkatëse të nxirren jashtë përdorimit.

Inventari i llogarisë 212, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, ka rezultuar në vlerën 8,908,725 lekë, gjithashtu edhe në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike). Pas amortizimit është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 8,161,678 lekë.

Inventari i llogarisë 213, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, ka rezultuar në vlerën 125,032,854 lekë, gjithashtu edhe në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike). Pas amortizimit është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 108,345,358 lekë.

Inventari i llogarisë 214, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, ka rezultuar në vlerën 84,482,102 lekë, gjithashtu edhe në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike). Pas amortizimit është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 54,447,120 lekë.

Inventari i llogarisë 215, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, ka rezultuar në vlerën 5,927,009 lekë, gjithashtu edhe në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike). Pas amortizimit është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 3,586,484 lekë.

Inventari i llogarisë 218, bazuar në raportin e sipër përmendur, është në të njejtën vlerë si në raport, gjithashtu edhe në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), konkretisht në vlerën 17,474,271 lekë.

Inventari i llogarisë 312, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, është në të njejtën vlerë si në raport, gjithashtu edhe në pasqyrën e pozicionit financiar, konkretisht në vlerën 19,203,465 lekë.

Inventari i llogarisë 327, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, është në të njëjtën vlerë si në raport, ashtu edhe në pasqyrën e pozicionit financiar, konkretisht në vlerën 800,874 lekë.

Për vitin 2020, bazuar në raportin e procesit të inventarizimit fizik të përgatitur, i cili është pa numër protokoll dhe pa datë. Gjatë procesit të inventarizimit, komisioni ka vërejtur se në magazinë ndodheshin materiale si bluza, mushama, jelekë, kapele dhe xhuboksa të dëmtuara nga përdorimi dhe të mykura nga lagështia. Gjithashtu ka pasur ende bileta që kanë qenë me afat përdorimi për vitet 2016 – 2017, të pavlefshme dhe një pjesë e tyre ka qenë e dëmtuar nga lagështia. Në magazinë ka pasur shumë pajisje të dëmtuara si ventilatorë, tavolina pune, ngrohës Warmac 200W, Acer smart phone Jade Z, telefon/tablet Smart për sms payment, tablet Samsung Galaxy Tab A6, USB 32 GB 3.0, karrige dhe ngrohës elektrik.

Pas konstatimeve të realizuara komisioni ka sugjeruar ngritjen e një komisioni me ekspertë sipas nevojave, për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të artikujve, që të bëhej asgjësimi i tyre.

Bashkëlidhur me këtë raport është hartuar Procesverbal Nr. 1883/1 prot., datë 21.12.2020, që është mbajtur para fillimit të procesit të inventarizimit dhe Procesverbal Nr. 1883/2 prot., datë 31.12.2020, që është mbajtur pas procesit të inventarizimit. Megjithatë nuk ekziston një procesverbal i hartuar, në të cilin të jenë specifikuar sasia e secilit prej artikujve të lart përmendur, që komisioni i ka gjykuar si të amortizuara dhe që i ka cilësuar për asgjësim. *Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pikat 102-106.*

Një procesverbal i bashkëlidhur është përgatitur për biletat e parkimit, të cilave u kishte kaluar afati i përdorimit, por as ky nuk ka numër protokoll dhe datë. Në të citohen vetëm seritë e biletave dhe numri i tyre për seritë përkatëse, ku në total kemi 1,031,864 copë. Gjithashtu specifikohet se, referuar regjistrave kontabël, sasia totale e biletave paraqitet me një kosto kontabël 1,609,708 lekë dhe sasia e tyre është 1,031,864 copë, duke qenë se vlera e tyre për copë ka qenë 1.56 lekë/copa. Në të paraqitet se vlera e biletave të printuara e llogaritur për tu arkëtuar, sipas regjistrave kontabël është 100 lekë/biletë, me vlerë totale të biletave 103,186,400 lekë.

Bazuar në këtë memo është propozuar edhe ngritja e komisionit të vlerësimit, me qëllim propozimin për nxjerrjen nga përdorimi të biletave të parkimit për zonën A të tarifimit, referuar shkresës Urdhër i brendshëm Nr. 263, datë 31.12.2020, nr. 1961/1 prot., “Për ngritjen e grupit të komisionit për vlerësimin e aseteve të propozuara për daljen nga përdorimi”. Bashkëngjitur shkresa Relacion Nr. 219 prot., datë 29.01.2021, në të cilin përshkruhet se gjendja e biletave të parkimit për Zonën A paraqitet tepër e dëmtuar, duke qenë se në shumicën e tyre numri serial është i padallueshëm dhe në disa vende i fshirë, si rrjedhojë e qëndrimit të tyre për një kohë të gjatë në hapësirën e magazinimit.

Si kryetar i Komisionit të Vlerësimit, bazuar në Urdhër i brendshëm Nr. 263, datë 31.12.2020, nr. 1961/1 prot., “Për ngritjen e grupit të komisionit për vlerësimin e aseteve të propozuara për daljen nga përdorimi”, është vendosur Drejtori i Burimeve Njerëzore, znj. J. A., që nuk ka qenë nëpunës zbatues i institucionit, siç parashikohet në kuadrin ligjor në fuqi. *Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 99.*

6. Titulli i gjetjes:	Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të asetëve për vitin 2020, është vendosur Drejtori i Burimeve Njerëzore, që nuk ka qenë nëpunës zbatues i institucionit.
Situata:	Në Drejtorinë e Tirana Parking, si kryetar i Komisionit të Vlerësimit, bazuar në Urdhër i brendshëm Nr. 263, datë 31.12.2020, nr. 1961/1 prot., “Për ngritjen e grupit të komisionit për vlerësimin e asetëve të propozuara për daljen nga përdorimi”, është vendosur Drejtori i Burimeve Njerëzore, që nuk ka qenë nëpunës zbatues i institucionit, siç parashikohet në kuadrin ligjor në fuqi.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 99.
Ndikimi/Efekti:	Mosfunksionimi i duhur i komisionit të vlerësimit të asetëve, për të arritur në vlerësimin e duhur të gjendjes dhe vlerës reale të tyre gjatë procesit të inventarizimit.
Shkaku:	Mos zbatimi i dispozitave ligjore
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtorja e Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, në komisionet e vlerësimit të asetëve për procesin e inventarizimit, të vendosë si kryetar të këtij komisioni nëpunësin zbatues të institucionit.

Komisioni i vlerësimit ka gjykuar se këto asete kanë qenë të papërshtatshme për përdorim të mëtejshëm dhe përfundimisht të dala jashtë funksionit për gjendje pune në vijim, për arsye të tejkalimit të afatit për përdorim si dhe gjendjes jo të mirë fizike. Komisioni ka propozuar asgjësimin e të gjithë sasisë prej 1,031,864 fije të biletave, me shkatërrim (copëzim me prerje ose brima, ndarje). Bashkëngjitur, Procesverbal “Mbi vlerësimin për nxjerrje jashtë përdorimit të vlerave materiale”, në të cilin janë përcaktuar sasia, vlera dhe çmimi për njësi, të cilat janë përmendur edhe më lart.

Nga sa është përmendur më lart, Tirana Parking janë nxjerrë jashtë përdorimit për vitin 2020, pas mbarimit të procesit të inventarizimit, vetëm bileta parkimi Zona A, të cilave u kishte kaluar afati i vlefshmërisë së tyre. Në Tirana Parking është hartuar Urdhër i brendshëm Nr. 34, datë 09.03.2021, nr. 219/3 prot., “Për ngritjen e komisionit për asgjësimin e biletave të parkimit zona A”. Bashkëngjitur “Raport përmbledhës për asgjësimin e biletave të parkimit të Zonës A”, Nr. 219/5 prot., datë 19.05.2021, në të cilin përshkruhet kryerja e asgjësimit për të gjitha biletat me gur fresibël dhe grisjes me duar.

Bashkëngjitur Memo Nr.219/1 prot., datë 15.02.2021, “Propozim për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimit të biletave të parkimit Zona A, gjendje në magazinën e Tirana Parking”, në të cilën është kërkuar miratimi me qëllim nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimit të biletave të parkimit Zona A. Bashkëngjitur Memo Nr. 1961 prot., datë 31.12.2020 “Propozim për ngritjen e komisionit të vlerësimit të biletave të parkimit për Zonën A të tarifimit”. Në këtë memo përshkruhet se, nga vlerësimi që është bërë pas inventarizimit fizik për vitin 2020, ka rezultuar se biletat e kanë kaluar afatin e vlefshmërisë së tyre, duke qenë se përdorimi i pasqyruar në ato bileta ka qenë periudha 2016 - 2017 dhe ato kanë qëndruar në magazinë për një periudhë të gjatë kohore, prej pothuajse 5 (pesë) vitesh. Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 74-80 dhe pika 102.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar, vihet re se biletat e parkimit të Zonës A, të cilat kanë qenë me afat skadence, siç është cilësuar nga vetë komisioni (grupi i punës), si të pamundura për t’u përdorur si pasojë e kalimit të afatit të vlefshmërisë së tyre, pra në një periudhë pas pothuajse 5 viteve nga skadencia e tyre. Afat ky përtej specifikimeve të kuadrit ligjor dhe udhëzimeve të MFE-së.

Ndërkohë që procesi për t’u nxjerrë jashtë përdorimit mund të ishte bërë shumë më herët, si rrjedhojë që procesi i inventarizimit bëhet çdo vit. Bazuar në sa më sipër në Tirana Parking rezulton se procesi i inventarizimit nuk është realizuar në mënyrën e duhur duke iu përmbajtur udhëzimeve dhe kuadrit ligjor në fuqi, e si rrjedhojë e kësaj rezulton se inventarizimi në Tirana Parking ka qenë i pasaktë. Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV, pika 102.

7. Titulli i gjetjes:	Pas përfundimit të procesit të inventarizimit të vitit 2020, janë nxjerrë jashtë përdorimit dhe asgjësuar biletat e parkimit, të cilave u kishte kaluar afati i përdorimit dhe vlefshmërisë që para pothuajse pesë vitesh (2016 – 2017).
Situata:	Duke marrë parasysh faktin që procesi i inventarizimit kryhet çdo vit, konstatimi se ka pasur në magazinë ende bileta të cilave u kishte kaluar afati i përdorimit, është bërë shume vite më vonë nga skadencia e tyre. Ndërkohë që duhet të ishin konstatuar shumë më herët në kohë dhe të ishin nxjerrë jashtë përdorimit vite më parë. Në Tirana Parking, komisioni i vlerësimit ka gjykuar se këto asete (biletat) kanë qenë të papërshtatshme për përdorim të mëtejshëm pasi u kishte kaluar afati i vlefshmërisë, që kishte qenë periudha e viteve 2016 – 2017.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 74 – 80 dhe pika 102.
Ndikimi/Efekti:	Mosfunksionimi i duhur i komisionit të inventarizimit të asetëve të viteve të mëparshme, për të arritur në konstatimin e duhur të gjendjes dhe vlefshmërisë së asetit gjatë procesit të inventarizimit, ka sjellë vonesën në kohë të nxjerrjes së tyre jashtë përdorimit dhe asgjësimit.
Shkaku:	Neglijencë e strukturave përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, pas përfundimit të procesit të inventarizimit të çdo viti, asetet të cilave u ka kaluar afati i vlefshmërisë së përdorimit, të nxirren jashtë përdorimit.

Inventari i llogarisë 212, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, ka rezultuar në vlerën 8,908,725 lekë, gjithashtu edhe në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike). Pas amortizimit është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 7,753,594 lekë.

Inventari i llogarisë 213, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, ka rezultuar në vlerën 148,498,668 lekë. Pas amortizimit është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 125,610,609 lekë.

Inventari i llogarisë 214, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, ka rezultuar në vlerën 15,067,470 lekë, ndërkohë që në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve

afatgjata (kosto historike), është paraqitur në vlerën 88,455,302 lekë. Diferenca rezulton në vlerën 73,387,832 lekë.

Inventari i llogarisë 215, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, ka rezultuar në vlerën 5,927,009 lekë, gjithashtu edhe në pasqyrën gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike). Pas amortizimit është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 3,091,549 lekë.

Inventari i llogarisë 218, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, ka rezultuar në vlerën, 7,955,995 lekë ndërkohë që në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), është paraqitur në vlerën 17,474,231 lekë. Diferenca rezulton në vlerën 9,518,236 lekë.

Inventari i llogarisë 312, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, është në të njëjtën vlerë si në raport, ashtu edhe në pasqyrën e pozicionit financiar, konkretisht në vlerën 23,921,558 lekë.

Inventari i llogarisë 327, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, ka rezultuar në vlerën 2,455,075 lekë, ndërkohë që në pasqyrën e pozicionit financiar, është paraqitur në vlerën 2,145,594 lekë. Diferenca rezulton në vlerën 309,481 lekë.

Përsa i takon diferencave të konstatuara, ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Urdhër nr.64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit.

8. Titulli i gjetjes:	Në raportin e inventarizimit fizik për vitet 2020, 2021 dhe 2022, vlera e inventarit për llogaritë 214 dhe 218 të klasës 2 të aktiveve afatgjata materiale dhe vlera e llogarisë 327 vetëm për vitin 2020, ka diferenca krahasuar me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike) për llogarite 214 dhe 218 dhe pasqyrës së pozicionit financiar për llogarinë 327.
Situata:	Në Drejtorinë e Tirana Parking, vlera e inventarit për llogaritë 214 dhe 218 të klasës 2 të aktiveve afatgjata materiale dhe llogarisë 327, e paraqitur në raportin e inventarizimit nuk është pasqyruar saktë, pasi ka diferenca krahasuar me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe pasqyrës së pozicionit financiar.
Kriteri:	Ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. Urdhër nr. 64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit.
Ndikimi/Efekti:	Mosparaqitje e saktë e vlerës së llogarive të klasës 2 nga raporti i inventarizimit në pasqyrat financiare përkatëse.
Shkaku:	Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Financës në Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, të paraqesë saktë dhe të bëjë sistemimet përkatëse, në mënyrë që vlera e llogarive të klasës 2 dhe 3, të paraqitura në raportin e inventarizimit, të përkojë me vlerën e secilës prej llogarive të klasës 2 dhe 3, në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe pasqyrën e pozicionit financiar.

Për vitin 2021, bazuar në raportin e procesit të inventarizimit fizik të përgatitur me Nr. 1798/3 prot., datë 31.12.2021, është realizuar inventarizimi fizik për këtë vit. Në këtë raport nga ana e

komisionit është konstatuar se, ka pasur pajisje të cilat kërkonin rivlerësim si dhe pajisje për t'u nxjerrë jashtë përdorimit, gjithashtu është bërë edhe inventarizimi i ambienteve të shërbimit të Tirana Parking.

Në raport është përshkruar se, gjatë inventarizimit është konstatuar se tabelat sinjalizuese për institucionin, sheshet e parkimit mbi dhe nëntokë, dhe për terminale që janë të vendosura për sinjalizimin e vendndodhjes së tyre, disa prej këtyre tabelave kanë qenë të dëmtuara.

Konstatime të mëtejshme janë bërë edhe për tabelat e parkimit publik me pagesë, që në shumicën e rasteve, kanë qenë sipas planshetave dhe në disa raste kanë pasur ndryshime dhe disa prej tyre kanë qenë të dëmtuara. Gjithashtu është konstatuar edhe që disa kabina të shesheve të parkimit kanë qenë të dëmtuara, njësitë qendrore dhe monitorët, janë paraqitur si të papërshtatshëm për t'u përdorur për të kryer punët e nevojshme dhe detyrat funksionale të punonjësve.

Në këtë raport komisioni është shprehur se njësitë qendrore dhe monitorët të cilët janë dorëzuar nga disa punonjës, nuk kanë qenë më të përshtatshëm për tu përdorur, konkretisht 8 monitorë.

Gjithashtu në raport janë përshkruar dhe disa problematika që kanë qenë prezente në sheshparkimet dhe terminalët nën administrimin e Tirana Parking, për pajisje të dëmtuara si f/v steka, f/v njësi dalje, barriera hyrëse dhe dalje, sistemet e leximit të targave, ekrane të shfaqjes së çmimit për klientët, kamera etj.

Sipas raportit, sugjerimet që ka dhënë komisioni pas përfundimit të procesit të inventarizimit të vitit 2021, kanë qenë që inventarët e zyrave duhet të firmosen nga vetë punonjësit e zyrave dhe të vendosen në vende të dukshme; ngritja e një komisioni më të specializuar ku në përbërje të ketë specialistë në pozicionin IT, për konstatimin e pajisjeve elektronike, të cilat nuk kryenin siç duhej funksionin ose që nuk ishin më në gjendje pune. Komisioni ka propozuar gjithashtu se, për sheshparkimet dhe terminalët, të bëheshin zëvendësimet përkatëse për pajisjet e dëmtuara dhe të zëvendësoheshin pjesët përbërëse të konsumueshme të pajisjeve të sistemeve të parkimit, të cilat kishin kaluar afatet maksimale të përdorimit dhe që nuk ishin të mbuluara nga mirëmbajtja periodike e sistemeve të parkimit.

Bashkëlidhur me këtë raport është hartuar Procesverbal Nr. 1798/1 prot., datë 20.12.2021, që është mbajtur para fillimit të procesit të inventarizimit dhe Procesverbal Nr. 1798/2 prot., datë 31.12.2021, i mbajtur në pas përfundimit të inventarizimit.

Inventari i llogarisë 212, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, është në të njejtën vlerë si në raport, ashtu edhe në pasqyrën gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), konkretisht në vlerën 8,908,725 lekë. Pas amortizimit është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 6,202,875 leke.

Inventari i llogarisë 213, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, është në të njejtën vlerë si në raport, ashtu edhe në pasqyrën gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), në vlerën 163,163,681 lekë. Pas amortizimit është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 133,445,154 lekë.

Inventari i llogarisë 214, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, ka rezultuar në vlerën 27,527,694 lekë, ndërkohë që në pasqyrën gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), është paraqitur në vlerën 101,470,502 lekë. Diferenca rezulton në vlerën 73,942,808 lekë.

Inventari i llogarisë 215, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, është në të njejtën vlerë si në raport, ashtu edhe në pasqyrën gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto

historike), konkretisht në vlerën 5,927,009 lekë. Pas amortizimit është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 2,473,239 lekë.

Inventari i llogarisë 218, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, ka rezultuar në vlerën 396,720 lekë, ndërkohë që në pasqyrën gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), është paraqitur në vlerën 17,801,831. Diferenca rezulton në vlerën 17,405,111 lekë.

Inventari i llogarisë 312, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, është në të njëjtën vlerë si në raport, ashtu edhe në pasqyrën e pozicionit financiar, konkretisht në vlerën 21,203,113 lekë.

Inventari i llogarisë 327, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, është në të njëjtën vlerë si në raport, ashtu edhe në pasqyrën e pozicionit financiar, konkretisht në vlerën 2,317,117 lekë.

Për vitin 2022, bazuar në raportin e procesit të inventarizimit të përgatitur me Nr. 1959/3 prot., datë 30.12.2022, është realizuar inventarizimi fizik për këtë vit. Në këtë raport nga ana e komisionit është konstatuar se, ka pasur pajisje të cilat kërkonin rivlerësim si dhe pajisje për tu nxjerrë jashtë përdorimit, gjithashtu është bërë edhe inventarizimi i ambienteve të shërbimit të Tirana Parking.

Në raport është përshkruar se, gjatë inventarizimit fizik është konstatuar se disa prej tabelave sinjalizuese për institucionin, sheshet e parkimit mbi dhe nëntokë dhe për терминалет, që janë të vendosura për sinjalizimin e vendndodhjes së tyre, kanë qenë të dëmtuara. Fenomen ky, i cili ka qenë prezent edhe gjatë procesit të inventarizimit të vitit 2021, por në raport nuk specifikohet nëse bëhet fjalë për të njëjtat destinacione të tabelave si të vitit të kaluar, apo për tabela që janë evidentuar vetëm për vitin 2022.

Konstatime të mëtejshme janë bërë edhe për tabelat e parkimit publik me pagesë, që në shumicën e rasteve kanë qenë sipas planshetave, por në disa raste kanë pasur ndryshime dhe disa prej tyre kanë qenë të dëmtuara. Madje edhe disa kabina të shesheve të parkimit kanë qenë gjithashtu të dëmtuara.

Konstatimi tjetër ka qenë për njësitë qendrore dhe monitorët, të cilat janë paraqitur si të papërshtatshme për t'u përdorur për të kryer punët e nevojshme dhe detyrat funksionale të punonjësve. Ajo që u evidentua gjatë auditimit të dokumentacionit është se, edhe në procesin e inventarizimit të vitit 2022, bëhet fjalë për të njëjtat monitorë dhe njësi qendrore, të cilat ishin evidentuar si të papërshtatshme për tu përdorur edhe në inventarizimin e vitit 2021.

Kjo tregon se nga konstatimet e një viti më parë nuk është marrë asnjë masë për të kryer vlerësimin apo nxjerrjen jashtë përdorimit të këtyre aktiveve, duke bërë që procesi i inventarizimit të jetë i paplotë dhe i papërfunduar. *Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Kapitulli IV, pika 73-74 dhe pika 102.*

9. Titulli i gjetjes:	Në Drejtorinë e Tirana Parking nuk janë marrë në konsideratë konstatimet që ka bërë grupi i inventarizimit fizik një vit më parë (2021), për gjendjen e aktiveve të dëmtuara dhe ato të amortizuara, e si rrjedhojë të njëjtat konstatime kanë vijuar të jenë prezente edhe në raportin e inventarizimit fizik të vitit 2022.
Situata:	Në raportin e inventarizimit fizik për vitin 2022, komisioni i inventarizimit ka konstatuar se disa prej tabelave sinjalizuese për institucionin, sheshet e parkimit mbi dhe nëntokë dhe терминалет, që janë të vendosura për sinjalizimin e vendndodhjes së tyre, kanë qenë të dëmtuara. Fenomen ky, i cili ka qenë

	prezent edhe gjatë procesit të inventarizimit të vitit 2021, por në raport nuk specifikohet nëse bëhet fjale për të njëjtat destinacione të tabelave si të vitit të kaluar, apo për tabela që janë evidentuar vetëm për vitin 2022. Konstatime të mëtejshme janë bërë edhe për tabelat e parkimit publik me pagesë, që në disa raste kanë pasur ndryshime dhe disa prej tyre kanë qenë të dëmtuara, madje edhe disa kabina të shesheve të parkimit kanë qenë gjithashtu të dëmtuara. Konstatimi tjetër ka qenë për njësitë qendrore dhe monitorët, të cilat janë paraqitur si të papërshtatshëm për t'u përdorur për të kryer punët e nevojshme dhe detyrat funksionale të punonjësve.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pika 73 – 74 dhe pika 102.
Ndikimi/Efekti:	Duke mos marrë në konsideratë konstatimet e komisionit të inventarizimit fizik, nuk bëhet i mundur realizimi i plotë i të gjitha etapave të procesit të inventarizimit të aseteve, duke sjellë kështu rritje të vlerës së amortizimit ndër vite, si pasojë e mos nxjerrjes jashtë përdorimit të tyre e gjithashtu mbajtjen e materialeve të dëmtuara, që janë të papërshtatshme për t'u ripërdorur.
Shkaku:	Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga strukturat përgjegjëse të Tirana Parking, të merren masat që në vijimësi, të shqyrtohen konstatimet e komisionit të inventarizimit fizik të aseteve dhe procesi i inventarizimit të kryhet i plotë, duke kaluar nëpër të gjitha etapat e tij. Për asetet e amortizuara dhe materialet e dëmtuara, në kushte të papërshtatshme për t'u ripërdorur, të merren masa për kryerjen e vlerësimit dhe nxjerrjen jashtë përdorimit për të evituar, rritjen e vlerës së amortizimit të akumuluar në kontabilitet.

Gjithashtu në raport janë përshkruar dhe disa problematika që kanë qenë prezente në sheshparkimet dhe terminallet nën administrimin e Tirana Parking, për pajisje të dëmtuara si f/v steka, f/v njësi dalëse, barriera hyrëse dhe dalëse, sistemet e leximit të targave, ekrane të shfaqjes së çmimit për klientët, kamera etj. Kjo problematikë është evidentuar dhe ka qenë prezente edhe në vitin 2021.

Sipas raportit, sugjerimet që ka dhënë komisioni pas përfundimit të procesit të inventarizimit të vitit 2022, kanë qenë që inventarët e zyrave duhet të firmosen nga vetë punonjësit e zyrave dhe të vendosen në vende të dukshme; ngritja e një komisioni më të specializuar ku në përbërje të ketë specialistë në pozicionin IT, për konstatimin e pajisjeve elektronike, të cilat nuk kryenin siç duhej funksionin ose që nuk ishin më në gjendje pune. Komisioni ka propozuar gjithashtu se, për sheshparkimet dhe terminallet, të bëheshin zëvendësimet përkatëse për pajisjet e dëmtuara dhe të zëvendësoheshin pjesët përbërëse të konsumueshme të pajisjeve të sistemeve të parkimit, të cilat kishin kaluar afatet maksimale të përdorimit dhe që nuk ishin të mbuluara nga mirëmbajtja periodike e sistemeve të parkimit.

Komisioni pas përfundimit të procesit të inventarizimit, edhe për vitin 2022 ka bërë po të njëjtat sugjerime, që kishte bërë edhe për vitin 2021. Kjo tregon se nga viti 2021 deri në fund të vitit 2022, nuk është marrë në konsideratë asnjë nga sugjerimet që komisioni ka shprehur, qoftë për rivlerësim të aktiveve të konstatuara si të papërshtatshme për punë, apo edhe nxjerrje jashtë përdorimit të tyre. Kjo ka sjellë që kjo situatë të përsëritet edhe në vitin pasues 2022, duke sjellë në vëmendje po të njëjtat problematika dhe sugjerime. Madje bëhet fjalë për të njëjtat aktive që

ishin paraqitur edhe në raportin e vitit 2021, pasi identifikimi i tyre bëhet bazuar si në numrat serial identifikues të paraqitur në raport, por edhe nga sasia që është po e njëjta.

Inventari i llogarisë 212, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, është në të njëjtën vlerë si në raport, ashtu edhe në pasqyrën gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), konkretisht në vlerën 8,908,725 lekë. Pas amortizimit është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 4,962,300 lekë.

Inventari i llogarisë 213, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, është në të njëjtën vlerë si në raport, ashtu edhe në pasqyrën gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), në vlerën 163,163,681 lekë. Pas amortizimit është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 126,772,896 lekë.

Inventari i llogarisë 214, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, ka rezultuar në vlerën 46,464,457 lekë, ndërkohë që në pasqyrën gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), është paraqitur në vlerën 127,334,508 lekë. Diferenca në vlerën 80,870,051 lekë.

Inventari i llogarisë 215, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, është në të njëjtën vlerë si në raport, ashtu edhe në pasqyrën gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), konkretisht në vlerën 5,927,009 lekë. Pas amortizimit është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 1,978,591 lekë.

Inventari i llogarisë 218, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, ka rezultuar në vlerën 1,531,620 lekë, ndërkohë që në pasqyrën gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), është paraqitur në vlerën 22,698,771 lekë. Diferenca në vlerën 21,167,151 lekë.

Inventari i llogarisë 312, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, është në të njëjtën vlerë si në raport, ashtu edhe në pasqyrën e pozicionit financiar, konkretisht në vlerën 16,561,403 lekë.

Inventari i llogarisë 327, bazuar në të dhënat e raportit të sipër përmendur, është në të njëjtën vlerë si në raport, ashtu edhe në pasqyrën e pozicionit financiar, konkretisht në vlerën 3,363,008 lekë.

Bashkëlidhur me këtë raport është hartuar Procesverbal Nr. 1959/1 prot., datë 20.12.2022, i mbajtur në fillim të procesit të inventarizimit dhe Procesverbal Nr. 1959/2 prot., datë 23.12.2022, i mbajtur në pas përfundimit të inventarizimit.

Aktivet Afatgjata Financiare

Llogaria 231 “Investime për Aktive Afatgjata materiale”, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2019 është paraqitur në vlerën **9,296,826** lekë dhe në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2022 është paraqitur në vlerën **12,645,268** lekë. Përsa i takon viteve 2020 dhe 2021, kjo llogari nuk rezulton me vlerë monetare.

**Nga ana e përfaqësuesve të institucionit, nuk i janë vënë në dispozicion në formë elektronike llogaritë analitike të detajuara grupit të auditimit.*

Llogaria 230, “Investime për Aktive Afatgjata jomateriale”, për vitin 2019, në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të financimit është paraqitur në vlerën 0 lekë, ndërsa sipas të dhënave shkresore të kësaj llogarie ka rezultuar vlera 724,748 lekë. Diferenca në vlerën 724,748 lekë.

Llogaria 231, “Investime për Aktive Afatgjata materiale”, në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të financimit është paraqitur në vlerën 9,296,826 lekë, ndërsa sipas të dhënave shkresore të kësaj llogarie ka rezultuar vlera 11,608,639 lekë.

Llogaria 230, “Investime për Aktive Afatgjata jomateriale”, për vitin 2020, në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të financimit është paraqitur në vlerën 0 lekë, ndërsa sipas të dhënave shkresore të kësaj llogarie ka rezultuar vlera 288,897 lekë. Diferenca rezulton në vlerën (288,897) lekë.

Llogaria 231, “Investime për Aktive Afatgjata materiale ”, në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të financimit është paraqitur me tepricë në fillim të vitit 2020 në vlerën 9,296,826 lekë dhe tepricë në fund të vitit paraqitur në vlerën 0 lekë. Ndërsa sipas të dhënave shkresore të kësaj llogarie ka rezultuar vlera 30,110,645 lekë. Diferenca rezulton në vlerën (30,110,645) lekë.

Llogaria 230, “Investime për Aktive Afatgjata jomateriale”, për vitin 2021, në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të financimit është paraqitur në vlerën 0 lekë dhe është e njëjtë me të dhënat shkresore të kësaj llogarie.

Llogaria 231, “Investime për Aktive Afatgjata materiale ”, në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të financimit është paraqitur në vlerën 0 lekë, ndërsa sipas të dhënave shkresore të kësaj llogarie ka rezultuar vlera 16,192,133. Diferenca në vlerën (16,192,133) lekë.

Llogaria 230, “Investime për Aktive Afatgjata jomateriale”, për vitin 2022, në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të financimit është paraqitur në vlerën 0 lekë, ndërsa sipas të dhënave shkresore të kësaj ka rezultuar vlera 15,517,638 lekë. Diferenca në vlerën (15,517,638) lekë.

Llogaria 231, “Investime për Aktive Afatgjata materiale ”, në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të financimit është paraqitur me tepricë në fund të vitit në vlerën 12,645,268 lekë, ndërsa sipas të dhënave shkresore të kësaj llogarie ka rezultuar vlera 41,269,606 lekë. Diferenca në vlerën (28,624,338) lekë.

Përsa i takon diferencave të konstatuara, ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Urdhër nr.64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit.

10. Titulli i gjetjes:	Në drejtorinë e Tirana Parking, për vitet objekt auditimi, janë konstatuar diferenca për llogaritë 230 dhe 231.
Situata:	Për vitet objekt auditimi, janë konstatuar diferenca për llogaritë e investimeve 230 dhe 231, duke krahasuar të dhënat e paraqitura për secilën prej llogarive në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të financimit dhe faktit të paraqitur në dokumentacionin shkresor.
Kriteri:	Ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. Urdhër nr. 64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit.
Ndikimi/Efekti:	Mosparaqitje e saktë e vlerës së llogarive 230 dhe 231.
Shkaku:	Përgjegjësi e Drejtorisë së Financës.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Financës në Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, të paraqesë saktë dhe të bëjë sistemimet përkatëse, në mënyrë që vlera e llogarive të investimeve, të përkojë me vlerën e secilës prej llogarive, në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të financimit dhe pasqyrën e pozicionit financiar.

Pasivet (Detyrimet)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar, janë llogari të pagueshme, të cilat paraqesin detyrimet e Tirana Parking deri në 31 dhjetor të çdo viti, si pagat e punonjësve të muajit dhjetor, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2019 në vlerën prej 3,907,132 lekë, e cila përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime operative dhe kreditorët për shkak të mungesës së fondeve.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 në vlerën prej 4,041,605 lekë, e cila përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime operative dhe kreditorët për shkak të mungesës së fondeve.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën prej 62,112 lekë, e cila përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime operative dhe kreditorët për shkak të mungesës së fondeve.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën prej 3,057,398 lekë, e cila përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime operative dhe kreditorët për shkak të mungesës së fondeve.

Vlerat e kësaj llogarie në pasqyrën e pozicionit financiar të secilit prej viteve të përmendura më lart, rakordojnë me listën e kreditorëve në formatin excel, që i është vënë në dispozicion grupit të auditimit. Siç mund të vihet re vlera e kreditorëve nga viti 2019 në vitin 2020 ka ardhur duke u rritur, ndërsa në vitin 2021 ka pasur ritme rënëse në vlerë dhe në vitin 2022 vihet re përsëri një rritje në vlerën e kreditorëve.

Llogaritë 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2019 është paraqitur në vlerën 14,450,354 lekë. E njëjta llogari për vitin 2020, nuk rezulton me vlerë monetare, ndërsa për vitin 2021 është paraqitur në vlerën 12,312,821 lekë dhe për vitin 2022 është paraqitur në vlerën 13,978,168 lekë.

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2019 është paraqitur në vlerën 6,336,061 lekë. E njëjta llogari për vitin 2020 është paraqitur në vlerën 6,186,430 lekë, për vitin 2021 është paraqitur në vlerën 6,462,065 lekë dhe për vitin 2022 është paraqitur në vlerën 7,771,612 lekë.

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2019 është paraqitur në vlerën 438,762 lekë. E njëjta llogari për vitin 2020 është paraqitur në vlerën 427,776 lekë, për vitin 2021 është paraqitur në vlerën 459,049 lekë dhe për vitin 2022 është paraqitur në vlerën 548,289 lekë.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2019 është paraqitur në vlerën 1,636,221 lekë. E njëjta llogari për vitin 2020 është paraqitur në vlerën 2,979,869 lekë, për vitin 2021 është paraqitur në vlerën 4,033,809 lekë dhe për vitin 2022 është paraqitur në vlerën 5,450,479 lekë.

**Nga ana e përfaqësuesve të institucionit, nuk i janë vënë në dispozicion llogaritë analitike grupit të auditimit.*

Pasivet në pasqyrën e pozicionit financiar, për vitin 2019, kanë rezultuar në vlerën **31,440,990** lekë, ndërkohë që në akt rakordimet me thesarin janë në vlerën **27,897,230** lekë, vlerë kjo që përkon me vlerën e “Llogari të Pagueshme”.

Pasivet në pasqyrën e pozicionit financiar, për vitin 2020, kanë rezultuar në vlerën **20,994,153** lekë, ndërkohë që në akt rakordimet me thesarin janë në vlerën **14,737,913** lekë, vlerë kjo që përkon me vlerën e “Llogari të Pagueshme”.

Pasivet në pasqyrën e pozicionit financiar, për vitin 2021, kanë rezultuar në vlerën **32,014,668** lekë, ndërkohë që në akt rakordimet me thesarin janë në vlerën **25,758,428** lekë.

Pasivet në pasqyrën e pozicionit financiar, për vitin 2022, kanë rezultuar në vlerën **42,626,163** lekë.

Të tjera Pasive Afatshkurtra

Llogaria 475 “Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse”, për vitin 2019, ndërkohë që është e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën **3,543,760** lekë, në akt rakordimin me thesarin rezulton në vlerën **0** lekë.

Llogaria 475 “Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse”, për vitin 2020, ndërkohë që është e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën **6,256,240** lekë, në akt rakordimin me thesarin rezulton në vlerën **0** lekë.

Llogaria 475 “Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse”, për vitin 2021, ndërkohë që është e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën **7,529,115** lekë, në akt rakordimin me thesarin rezulton në vlerën **1,272,875** lekë. Diferenca në vlerën 6,256,240 lekë.

Llogaria 475 “Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse”, për vitin 2022 ndërkohë që është e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën **10,430,790** lekë, në akt rakordimin me thesarin rezulton në vlerën **1,272,875** lekë.

Përsa i takon mosrakordimeve me thesarin të konstatuara, ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Urdhër nr.64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit.

11. Titulli i gjetjes:	Mbi kontabilizimin e llogarisë 475 “Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse”.
Situata:	Llogaria 475 për vitet objekt auditimi, është paraqitur në vlerë të tjetër në pasqyrën e pozicionit financiar dhe ndërkohë këto vlera nuk janë të njëjta me rakordimet me thesarin.
Kriteri:	Ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” Urdhër nr. 64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit.
Ndikimi/Efekti:	Mospërputhje e saktë e vlerës së llogarisë 475.
Shkaku:	Përgjegjësi e Drejtorisë së Financës.

Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Financës në Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, të kontabilizojë saktë dhe në vlerë të plotë, vlerën e llogarisë 475 “Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse”, duke bërë regjistrimet përkatëse për këtë llogari.

Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar/Defiçiti i akumuluar)”, në bilancin e vitit 2019 është paraqitur në vlerën **321,476,637 lekë**. E njëjta llogari në bilancin e vitit 2020 është paraqitur në vlerën **330,399,747 lekë**. Në bilancin e vitit 2021 është paraqitur në vlerën **325,834,173 lekë** dhe në bilancin e vitit 2022 është paraqitur në vlerën **247,915,452 lekë**.

Llogaria 85 “Rezultati i Veprimtarisë ushtrimore”, në bilancin e vitit 2019 është paraqitur në vlerën **47,874,944 lekë**. E njëjta llogari në bilancin e vitit 2020 është paraqitur në vlerën **3,058,713 lekë**. Në bilancin e vitit 2021 është paraqitur në vlerën **-105,733,322 lekë** dhe në bilancin e vitit 2022 është paraqitur në vlerën **-3,595,819 lekë**.

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve (PASH)

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare, për vitin 2019 niveli i të ardhurave ka qenë në vlerën 217,474,077 lekë, ndërsa vlera e shpenzimeve të kryera ka qenë në vlerën 169,599,133 lekë. Në vitin 2020 vlera e të ardhurave të gjeneruara ka qenë 562,115,003 lekë, ndërsa vlera e shpenzimeve të kryera ka qenë në vlerën 559,056,290 lekë. (përfshirë derdhjen në buxhetin e shtetit)

Në vitin 2021 niveli i të ardhurave të gjeneruara ka qenë në vlerën 674,328,466 lekë, ndërsa niveli i shpenzimeve ka qenë në vlerën 780,061,788 lekë. Për këtë vit vihet re se shpenzimet që janë kryer kanë qenë në masë shumë më të madhe se të ardhurat, duke sjellë si pasojë që diferenca e PASH të rezultojë në vlerën -105,733,322 lekë. Kjo tregon se trendi i rritjes së nivelit të shpenzimeve për vitin 2021, ka qenë shumë më i lartë se një vit më parë, pra në 2020. (përfshirë derdhjen në buxhetin e shtetit)

I njëjti fenomen vihet re edhe në vitin 2022, ku vlera e të ardhurave të gjeneruara ka qenë 701,401,380 lekë dhe vlera e shpenzimeve të kryera (faktike) ka qenë 704,997,199 lekë, kjo tregon se shpenzimet e kryera (faktike) kanë qenë në nivel më të lartë se të ardhurat në dispozicion, duke sjellë si pasojë që diferenca e PASH të rezultojë në vlerën -3,595,819 lekë. Kjo tregon se trendi i rritjes së nivelit të shpenzimeve për vitin 2022, ka qenë i lartë, por jo në nivele më të larta krahasur me një vit më parë, pra në 2021. (përfshirë derdhjen në buxhetin e shtetit)

Viti 2019

- **Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjseve”**, në pasqyrën e performancës financiare është paraqitur në vlerën 79,476,572 lekë, ndërsa sipas faktit të realizimit të kësaj llogarie ka rezultuar vlera 79,225,573 lekë. Diferenca në vlerën (250,999) lekë.

- **Llogaria 601 “Kontribute të sigurimeve”**, në pasqyrën e performancës financiare është paraqitur në vlerën 13,240,954 lekë, ndërsa sipas faktit të realizimit të kësaj llogarie ka rezultuar vlera 13,196,615 lekë. Diferenca në vlerën (44,339) lekë.

- **Llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime”**, në pasqyrën e performancës financiare është paraqitur në vlerën 75,785,982 lekë, ndërsa sipas të dhënave shkresore të kësaj llogarie ka rezultuar vlera 39,479,440 lekë. Diferenca në vlerën 36,306,542 lekë.

- **Llogaria 606, “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”,** në pasqyrën e performancës financiare është paraqitur në vlerën 37,500 lekë dhe është e njëjtë me të dhënave shkresore të kësaj llogarie 37,500 lekë.

Viti 2020

Nga shqyrtimi i pretendimit të mësipërm, grupi i auditimit sqaron se, nga të dhënat e paraqitura gjatë periudhës së auditimit, ndaj grupit të auditimit, janë konstatuar diferenca për llogaritë e investimeve 230 dhe 231, duke krahasuar të dhënat e paraqitura për secilën prej llogarive në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të financimit dhe faktit të paraqitur në dokumentacionin shkresor. Për sa kohë nuk janë paraqitur fakte të reja ose prova shtesë nga ana juaj, për të vërtetuar të kundërtën e konstatimit të mësipërm (i cili ka qenë i sqaruar si situatë edhe në projekt raportin e auditimit), si rrjedhojë qëndron konstatimi i grupit të auditimit.

Për këto arsye, sa më sipër, pretendimi juaj nuk pranohet.

Pretendimi nr.9 (për Gjetje nga auditimi nr.11). Përsa më sipër ju sqaroj se në bazë të Udhëzimit nr.9 datë 29.08.2019 “Për Proçedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit” si dhe Udhëzimeve përkatëse Për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit për vitet në auditim, në zbatim të Ligjit Organik të Buxhetit gjatë periudhës janar-dhjetor degët e thesarit kryejnë veprime në SIFQ me paraqitjen e dokumentacioneve përkatës. Në periudhën e 13-të kryhet mbyllja e llogarive të klasës 6 dhe 7 me llogarinë 85 të rezultatit financiar, me paraqitjen e bilanceve të njëjësive në Thesar, specialistet hedhin vetem klasat 2, 3 dhe 4 për këtë arsye dalin edhe diferencat që ju pretendoni në projekt raportin tuaj.

Konsolidimi i pasqyrave Financiare të Institucionit tonë kryhet nga Bashkia Tiranë dhe nuk janë konsideruar diferenca apo mospërputhje të llogarive. Tepricat e llogarive janë në zbatim të kërkesave të Ligjit 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Nga shqyrtimi i pretendimit të mësipërm, grupi i auditimit sqaron se, llogaria 475 “Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse” për vitet objekt auditimi, është paraqitur në vlerë të tjetër në pasqyrën e pozicionit financiar dhe ndërkohë këto vlera nuk janë të njëjta me rakordimet me thesarin dhe për sa kohë nuk janë paraqitur fakte të reja ose prova shtesë nga ana juaj, për të vërtetuar të kundërtën e konstatimit të mësipërm (i cili ka qenë i sqaruar si situatë edhe në projekt raportin e auditimit), si rrjedhojë qëndron konstatimi i grupit të auditimit.

Për këto arsye, sa më sipër, pretendimi juaj nuk pranohet.

Pretendimi nr. 10 (për Gjetje nga auditimi nr.12). Më lejoni tju sqaroj se diferencat e konstatuara në llogaritë 600 “Pagat dhe përfitime të punonjësve” dhe llogarinë 601 “Kontribute të Sigurimeve” ndërmjet situacionit vjetor të thesarit dhe formatit nr. 8 të pasqyrës së numrit të punonjësve në pasqyrat financiare të vitit vijnë pasi në pasqyrat financiare pasqyrohen shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore që përfshijnë periudhën kontabël 1 janar deri në 31 dhjetor të vitit, ndërsa në situacionet e thesarit përfshihen shpenzimet faktike për paga dhe sigurime gjatë periudhës të vitit buxhetor 01 janar deri në 31 dhjetor. Duke e shpjeguar më qartë në fillim të janarit të vitit pasardhës kalojnë pagat e muajit Dhjetor të vitit paraardhës, ky shpenzim është llogaritur si detyrim për tu paguar në pasqyrat financiare por që si shpenzim faktik për efekt të vitit buxhetor kalon me faktin e Buxhetit të vitit pasardhës. Në zbatim të VKB nr.158 datë 26.12.2019 “Për Miratimin e Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës” që nga hyrja në fuqi e të cilit në 01.01.2020, sipas përcaktimeve të Kreu II Tarifa e Parkimit të Automjeteve, Neni 44 Fusha e zbatimit dhe mënyra e pagesës, pika 2 ku shprehimisht thuhet: “Të ardhurat e gjeneruara nga Tirana Parking kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës. Të ardhurat xhirohen në llogarinë e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës, dhe Tirana Parking kryen çdo muaj akt-rakordimet me Degën e Thesarit dhe raportin në Bashkinë e Tiranës”.

Përsa i përket mos paraqitjes së shumës 57.282.158 lekë në bilancin e vitit 2021 dhe 2022 ju sqaroj se vlera prej 57.282.158 lekë ka kaluar në fondet e Bashkisë Tiranë siç mund ta vini re në Akt Rakordimin mbi realizimin, përdorimin e të ardhurave për vitin 2020 dhe mbartjen për vitin 2021 të Bashkisë Tiranë me Degën e Thesarit Tiranë në datën 18.03.2021, K1 “TË ARDHURA PËR TU TRASHËGUAR” rrjeshti 1, Të ardhura të trashëguara nga Tirana Parking në vlerën 57.282.158 lekë. Pra që nga data 18.03.2021 këto të ardhura kanë kaluar në përdorim të Bashkisë Tiranë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Nga shqyrtimi i pretendimit të mësipërm, grupi i auditimit sqaron se, diferencat e krijuara nuk kanë të bëjnë me situacionet për muajt dhjetor dhe janar, por janë diferenca të vogla të cilat për shkaqe të ndryshme nuk janë njësoj.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni pranohet pjesërisht.

II.2.4. “Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve”

Tirana Parking bazuar në Regjistrin e Realizimeve vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit në Sistemin e Prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, për gjatë vitit 2019 ka realizuar 10 procedura prokurimi me vlerë të lartë në shumën 56,977,132 lekë pa tvsh, për gjatë vitit 2020 ka realizuar 8 procedura prokurimi me vlerë të lartë në shumën 40,361,209 lekë pa tvsh, për gjatë vitit 2021 ka realizuar 10 procedura prokurimi me vlerë të lartë në shumën 62,931,623, për gjatë vitit 2022 ka realizuar 13 procedura prokurimi me vlerë të lartë në shumën 58,555,628 lekë pa tvsh.

Bazuar në një analizë risku dhe në metodat e përzgjedhjes për auditim të procedurave të prokuruaru u vendos për auditimin e procedurave të mëposhtme:

	Procedura e Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik	Data e lidhjes së kontratës
2019	1 Rikonstrukcion i Sheshit të parkimit te Selman Stërmasi	15,242,949	15,005,877	5 k.	19.11.2019
	2 Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike elektrike, telefonike, ngrohje	1,080,000	1,026,000	C	2019
2021	3 Shërbim të Pastrimit dhe Gjelbërimir	8,429,587	8,315,505	F	19.5.2021
	4 Master Plani dhe Plan Biznesi për Parkimet në Qytetin e Tiranës	12,396,667	12,233,000	A R	22.11.2021
2022	5 Blerje Kabina Sherbimi	3,195,666	2,870,000	OBK	2022
	6 Sherbime te Pastrimit dhe Gjelberimit	8,769,799	8,298,666	CF	21.06.2022
	7 Blerje Makineri dhe Pajisje per Parkimet	13,743,000	13,259,000	AP	09.11.2022
	8 Zhvillimi i Platformes per Metodot Alternative te Pagesave te Parkimit.	10,756,666	10,550,000	I	

- **Procedura “Zhvillimi i Platformës për Metodot Alternative te Pagesave te Parkimit.” 2022**

Përshkrimi i procedurës

Objektivi i këtij projekti është të zhvillojë dhe implementojë një sistem softëare, i cili menaxhon në mënyrë të shpejtë, të sigurtë dhe të besueshme procesin e parkimit të rezervuar me pagesë në qytetin e Tiranës . Përmes këtij projekti synohet:

1. Krijimi i një sistemi të unifikuar software, me platformë web dhe një aplikacion mobile, në pronësi të Tirana Parking, i cili do të ofrojë informacion rreth shërbimeve të Tirana Parking, mundësojë mënyra shtesë pagese për qytetarët si dhe mundësojë ndërveprimin me palë të treta në të ardhmen.
2. Platforma web do të jetë e hapur për t’u ndërlidhur jo vetëm me operatorët e telekomunikacionit por gjithashtu për të ofruar mundësinë e pagesave nëpërmjet aplikacioneve të palëve të treta online banking (R., B., C., etj), apo platforma te tjera të pagesave (E., P., etj).
3. Aplikacioni mobile do të shërbejë jo vetëm si një mundësi për të kryer pagesën e parkimit, por gjithashtu do te ofrojë informacione dhe do të mundësojë Tirana Parking të dërgojë komunikime të ndryshme qytetarëve.
4. Kjo platformë do të jetë e hostuar në serverat e Tirana Parking dhe do të mirëmbahet 24/7 për të ofruar kontroll dhe siguri maksimale. Kjo mundëson shume thjesht shtimin e use-cases apo shërbimeve të reja; suport për institucionet partnere si dhe zgjidhje të shpejtë për ankesat e qytetarëve.

Fondi limit

Në vlerën 10,756,666 (dhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Zhvillimi i Platformes per Metodat Alternative te Pagesave te Parkimit” 2022		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 102, datë 09.06.2022		
Lloji i rocedures së Prokurimit: Procedurë e Hapur	2. Njësia e Prokurimit Z. E. M. Znj. L. L. Znj. V. D.	3. Komisioni për Përlogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: Z E. M. z. A. M. z. A. P.
4. Fondi limit (pa tvsh) 10,756,666 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti I shtetit	6. Data e hapjes së tenderit 08.07.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës OE “I. A.” 10,550,000 lekë b) kualifikuar: OE “I. A.” 10,550,000 lekë	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Znj.F. M. Znj. D. C. z. B. K.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 10,550,000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës 02.08.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 206,666 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës Znj. J. F. Znj. G. R. Znj. V. D. z. B. K. z. E. M.	14. Fletë hyrja	15. Afati I kontratës 6 muaj implementim + 2 vjet mirëmbajtje
16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/shërbimi Fatura 7/2023 dt. 01.02.2023 11,343,000 lekë me tvsh.		

Më konkretisht, detyrat që duhet të realizohen janë:

- Zhvillimi dhe Implementimi i Platformës web “Tirana Parking” sipas moduleve dhe komponentëve si më poshtë vijon:
 - Moduli i Administrimit të sistemit (Konfigurimeve/Parametrizime);
 - Moduli i Raporteve/Dashboard për manaxhimin e Institucionit;
 - Moduli i Supervizimit të inspektorëve të parkimit;
 - Moduli i Financës;
 - Moduli API për SMS për konsumimin e shërbimit nga operatorët telefonike (Vodafone, One etj.);
 - Moduli API për konsumimin e shërbimit për pagesat përmes palëve të treta;
 - Dokumentimi i hapave dhe teknologjisë për ndërlidhje me palët e treta;
 - Moduli i shitjes së “voucher” për qytetarët;
 - Moduli për kontrollin e mjetit nga Inspektorët;
- Zhvillimi dhe Implementimi i Platformës mobile “Tirana Parking e-ëallet”;
- Moduli i pagesës së parkimit direkt nga kioskat e Bashkisë Tiranë pa nevojën e aplikacionit mobile;
- Realizimi i trajnimeve për përdoruesit përmes sesioneve të trajnimit në ambientet e Tirana Parking, trajnimeve online si dhe nëpërmjet një udhëzues përdorimi të sistemit;

Pasi të gjithë modulet e sistemit të jenë testuar dhe çdo gjë të jetë në rregull, do të bëhet marrja në dorëzim e sistemit. Në marrjen në dorëzim do të përfshihen kodi burim, të gjithë komponentët e tjerë softëare, dokumentimi i konfigurimeve përkatëse, etj.

Realizimi i Mirëmbajtjes së sistemit për një periudhë 2 vjeçare

Realizimi i procedurës së mësipërme dhe dhënia e ofertave duhej sipas pikave të mëposhtme:

- Krijimi i platformës ëeb për Tirana Parking
- Aplikacioni Mobile për inspektoret dhe qytetarë
- Modalitetet e pagesave për palë të treta
- Trajnimi i përdoruesve
- Mirëmbajtje e sistemit

13. Titulli i gjetjes:	Nuk është përfunduar procesi mbi implementimin e platformës
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Zhvillimi i Platformës për Metodën Alternative të Pagesave të Parkimit”, nuk është zbatuar afati i zbatimit të kontratës nga ku data e lidhjes së kontratës është data 02.08.2022 dhe sipas kushteve të kontratës, duhej që shërbimi të ishte implementuar që me datë 02.02.2023 dhe të ishte në përdorim nga qytetarët. Gjatë analizimit të situatës dhe nga sqarimi i marrë nga grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, nga verifikimi i kryer rezultoi që aplikacioni mobile ishte krijuar por që pengesat ishin krijuar gjatë krijimit të modaliteteve për pagesat nga palët e treta (marrëveshjet me bankat dhe subjektet e tjera). Nga verifikimi i kryer nga ana e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës mbajtur Memo bashkëngjitur me Nr. Prot 330/2, datë 03.02.2023, me lëndë “Propozim për shtyrjen e kalimit online të metodës alternative të pagesës” me anë të cilit janë paraqitur arsyet teknike dhe ligjore dhe kushtet që duhen plotësuar nga Tirana Parking në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë për të kryer lançimin online të platformës.
Kriteri:	Nenin 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në cilësinë dhe zbatimin e shërbimit
Shkaku:	Koha e shkurtër për implementimin e një shërbimi të shtrirë në qytete të ndryshme
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Tirana Parking, grupi i ndjekjes dhe i zbatimit të kontratës, të marrë masat e menjëhershme që në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë të implementojë dhe të zhvillojë online platformën për Metodën Alternative të Pagesave të Parkimit dhe moduleve përbërëse të saj dhe aplikacioneve Android dhe iOS.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

Komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës znj. J. F., znj. G. R., znj. V. D., z. B. K. dhe z. E. M..

- **Procedura “Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike elektrike, telefonike, ngrohje” 2019**

Fondi limit

Në vlerën 1,080,000 (një milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike elektrike, telefonike, ngrohje " 2019		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 177, datë 13.09.2022		
Lloji i rocedures së Prokurimit: Procedurë e Hapur	2. Njësia e Prokurimit Z. E. M. Znj. J. F. Z. J. A.	3. Komisioni për Përlllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: Znj. F. M. z. K. ZH. z. A. M.
4. Fondi limit (pa tvsh) 1,080,000 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti I shtetit	6. Data e hapjes së tenderit 24.05.2019 (zhv)
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës OE "CC" 1,026,000 lekë b) kualifikuar: OE "CC" 1,026,000 lekë	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Znj. SH. H. Znj. E. M. z. B. K.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 1,026,000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës 26.06.2029	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 54,000 lekë	12. Ankimime S'ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës Znj. J. A. Z. K. ZH. Z. J. GJ.	14. Fletë hyrja	15. Afati I kontratës Nga data e lidhjes së kontratës deri më 31.12.2019
16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/shërbimi Fatura 84 dt. 05.08.2019 276,624 lekë me tvsh. Fatura 102 dt. 11.09.2019 121,944 lekë me tvsh. Fatura 131 dt. 02.12.2019 492,094 lekë me tvsh.		

Gjatë auditimit të procedurës së mësipërme u konstatua:

- Objekti i kontratës është gjithëpërfshirës dhe nuk përkon me preventivin bashkëngjitur dokumentacioneve të tenderit. Objekti sipas preventivit është "Riparim-mirëmbajtje e sistemit të ngrohje-ftohjes me chiller".
- Për kapacitetin teknik të O.E. pjesëmarrës në garë, nga ana e A.K. kërkohen kritere të cilat nën gjykimin e grupit auditues janë të ekzagjeruara dhe jo në proporcion me objektin dhe vlerën e kontratës, si më poshtë:
 - Për të garantuar cilësinë e punës operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij një numër punonjësish prej të paktën 12 (dymbëdhjete) personash".
 - Një drejtues teknik inxhinier mekanik.(Sistemi HVAC, i pajisur me license profesionale personale. I pajisur me Certificate per Auditim Energjetik te leshuar nga nje Institucion i akredituar Shqiptar. Diplome, Kontrate pune.
 - Një drejtues teknik inxhinier elektrik ose elektronik. Diplome, Kontrate pune .
 - Një drejtues teknik inxhinier mjedisi. Diplome, Kontrate pune.
 - I (një) inxhinier ndërtimi për ndërhyrjet e kërkuara në zërat e preventivit"
 - Licenca të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punimeve:
 - N.S – 4 (A) Punime rifiniture të muraturës dhe te lidhura me to

Disponimi i mjeteve të mëposhtme:

Lloji i makinerive	Sasia	Pronësia
Automjet ATP me aftësi mbajtëse deri ne 4.5 ton	copë 2	në pronësi ose me qira

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe dhe pikës 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

14. Titulli i gjetjes:	Objekti i kontratës jo në proporcion me përmbajtjen e saj
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike elektrike, telefonike, ngrohje”, objekti i kontratës, nuk përkon me përmbajtjen e procedurës, me preventivin dhe specifikimet teknike. Shkresa e ofertës së marrë nga O.E. fitues është me objekt “Riparim-mirëmbajtje e sistemit të ngrohje-ftohjes me chiller”, objekt i cili përkon me përmbajtjen e procedurës por që është ndryshe nga objekti i procedurës së prokurimit të kërkuar nga A.K. Për sa më sipër, në kundërshtim me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.
Kriteri:	Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”
Ndikimi/Efekti:	Pengon pjesëmarrjen e O.E. të tjerë
Shkaku:	Vendosja e zërit të buxhetit si objekt procedure prokurimi
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Tirana Parking, gjatë hartimit dhe zhvillimit të procedurave të prokurimit, objekti i kontratës të jetë në përputhje me përmbajtjen e procedurës së prokurimit, në mënyrë që O.E. e interesuar të aksesohen lehtë dhe që pjesëmarrja të jetë e lartë.

15. Titulli i gjetjes:	Hartimi i specifikimeve teknike jo në përputhje me objektin e kontratës
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike elektrike, telefonike, ngrohje” 2022, gjatë verifikimit të testimit. Gjithashtu një pjesë e specifikimeve teknike janë të ekzagjeruara dhe nuk mund të verifikohen nga anëtarët e KVO-së dhe të atyre të marrjes në dorëzim si dhe kanë një vlerë fikse duke mos përdorur termat ekuivalente, si më poshtë:
Kriteri:	Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”
Ndikimi/Efekti:	Pengon konkurrencën e drejtë
Shkaku:	Hartimi i specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta diskriminuese
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Tirana Parking, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke hartuar specifikime teknike të cilët janë gjithëpërfshirëse duke krijuar pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

Njësia e hartimit e specifikimeve teknike znj. F. M., z. K. ZH. dhe z. A. M., në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr. 10*, datë 12.06.2023

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 732/28 prot, datë 13.07.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës bazuar pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin, për sa i përket specialiteteve në çdo pozicion sqarojmë:

Inxhinier ndërtimi, është i nevojshëm për punimet ndërtimore të preventivit në zërat : Zëri nr.11, Zëri nr.12, Zëri nr.13

Inxhinier mekanik, është i nevojshëm për gjithë objektin e kontratës dhe ka të bëjë me punime të cilat kërkojnë domosdoshmërisht praninë e inxhinierit mekanik për zbatimin e saj

Për sa i përket certifikatës për Auditim Energjie jemi bazuar në ligjin Nr. 124/2015 Për Efiçencën e Energjisë (ndryshuar me ligjin nr. 5/2019, datë 7.2.2019) e detyrueshme për institucionet shtetërore)

Inxhinieri Elektrik/elektronik , është i nevojshëm për punimet elektrike të preventivit në zërat nr.6, 14, nga 29 deri 35 dhe zërin nr 50 .

Inxhinier mjedisi është i nevojshëm për sigurimin e vend depozitimit të materialeve të rrezikshme (gaz, bateri, etj) të cilat janë hequr dhe për arsye largimi/asgjësimi i tyre kërkon persona të kualifikuar për të mos shkaktuar dëme në mjedis.

Saldatori është i nevojshëm për realizimin e zërave për saldimin e tubave të cilët janë çelik, si dhe pjesë metalike të ndryshme, që u përkojnë zërave 41,42,43 të preventivit të punimeve.

Termoteknik dhe specialist kondicionimi , i gjithë objekti i kontratës ka të bëjë me punime të cilat kërkojnë domosdoshmërisht praninë e këtyre specialistëve për zbatimin e saj.

Elektriçist 2(dy) copë është i nevojshëm për punimet elektrike të preventivit në zërat nr.6, 14, 29-35 dhe në zërin nr 50 .

Për sa më sipër janë kërkuar 8 specialistë të cilët janë të lidhur ngushtë me zërat e preventivit, kohën e shkurtër të afatit të zbatimit të punimeve dhe katër punonjës të tjerë i përkasin administratës së operatorit ekonomik, si administrator, ekonomist, jurist si dhe punonjës të pa kualifikuar(ndihmës).

Për sa i përket pikës së licencës NS 4 A është licencë e lidhur ngushtë me zërat e preventivit Zëri nr.11, Zëri nr.12, Zëri nr.13, e kërkuar e kategoria A i përket minimumit të kualifikimit të një kompanie e cila do realizojë punime ndërtimore.

Për sa i përket kërkesës për dy kamioncina me kapacitet deri në 4.5 ton, është në përpjestim të drejtë me volumin e preventivit, si dhe me vendndodhjen e objektit të kontratës. Një automjet është i nevojshëm për transportin e materialeve dhe një për transportin e stafit teknik dhe punëtorve.

Në përmbledhje për sa më sipër, referuar arsyetimeve, kërkesat e vecanta të kualifikimit janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. (bashkëlidhur dokumentacioni përkatës)

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Pas shqyrtimit të observacionit nga ana e grupit të auditimit, në një procedurë prokurimi e cila është në kufirin midis blerjeve të vogla dhe zhvillimit të procedurave me vlerë të lartë, A.K. duhet të hartojë kritere më gjithëpërfshirëse që të stimulojë dhe përfshirjen e O.E. të tjerë me kapacitete më të vogla. Duke u nisur nga më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim si më sipër.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

- **Procedura “Blerje Makineri dhe Pajisje për Parkimet” 2022**

Përshkrimi i procedurës

Me shkresë Nr. 1404 Prot., datë 29.08.2022 të Drejtorisë së Administrimit të Shërbimit të Parkimit është bërë kërkesë, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, për blerje makineri dhe pajisje për dy parkime, konkretisht:

- Për parkimin nëntokësor “Bulevardi i Ri”, për arsye se janë konstatuar problematika në mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e sistemit të parkimit të instaluar në të, dhe kërkohet të krijohet mundësia për zëvendësimin e këtij sistemi parkimi dhe vendosja e një sistemi të ngjashëm parkimi me shesh parkimet e tjera dhe терминаlet e administruara nga Tirana Parking;
- Për parkimin nëntokësor “Kopshti Zoologjik”, duke qenë se në prej datës 01.06.2022 Tirana Parking ka marrë në administrim këtë parkim, i cili i është lënë në përdorim dhe mirëmbajtje nga Bashkia Tiranë, me anë të shkresës nr. 41457 Prot., datë 21.10.2021. Edhe për këtë parkim është kërkuar vendosja e një sistemi të ngjashëm parkimi me shesh parkimet e tjera dhe терминаlet e administruara nga Tirana Parking.

Fondi limit

Në vlerën 13,743,000 (trembëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e tre mijë) lekë pa TVSH

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje Makineri dhe Pajisje për Parkimet” 2022		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 177, datë 13.09.2022		
Lloji i rocedures së Prokurimit: Procedurë e Hapur	2. Njësia e Prokurimit Z. E. M. Znj. L. H. Z. B. K.	3. Komisioni për Përlogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: Z. B. K. Znj. F. M. Znj. A. LL.
4. Fondi limit (pa tvsh) 13,743,000 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i shtetit	6. Data e hapjes së tenderit 05.10.2022 (zhv)
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës OE “I” sh.p.k 13, 543, 785 lekë OE “F” sh.p.k 13,650,000 lekë OE “F. E.” sh.p.k 11,416,000 lekë OE “A. P.” sh.p.k 13, 259,000 lekë b) kualifikuar: OE “A. P.” sh.p.k 13, 259,000 lekë	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Znj. D. C. Znj.A. P. Z. E. M.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 13, 259,000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë furnizimi 09.11.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 484,000 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës Znj. J. F. Z. B. K. Z. E. L.	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 60 ditë nga lidhja e kontratës
16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi Fatura 2/2023 dt. 07.1.2023 15,115,260 lekë me tvsh.		

Për përlllogaritjen e fondit limit, Autoriteti Kontraktor (këtu e tutje A.K.), në relacionin përmbledhës Nr. 1404/6 Prot., datë 09.09.2022, është bazuar në studimin e tregut, pas marrjes së ofertave nga tre operatorët ekonomikë (këtu e tutje O.E.):

“I” sh.p.k. në vlerën 13, 846,000 lekë pa tvsh;

“P. S.” sh.p.k në vlerën 13,656,000 lekë pa tvsh;

“A. P.” sh.p.k në vlerën **13,727,000 lekë pa tvsh.**

Në këtë relacion, Komisioni i ngritur për përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike, ka përcaktuar vlerën 13,743,000 lekë pa tvsh për “Blerje makineri dhe pajisje për parkimet”, për dy sistemet e parkimit.

A.K ka hartuar procesverbalin e datës 13.09.2022 për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Në këtë procedurë prokurimi, të zhvilluar më datë 05.10.2022, kanë qenë pjesëmarrës katër O.E:

- “I.B.S.” sh.p.k me ofertën ekonomike 13,543,785 lekë pa tvsh;
- “F.E.” sh.p.k me ofertën ekonomike 11,416,000 lekë pa tvsh;
- “F.” sh.p.k me ofertën ekonomike 13,650,000 lekë pa tvsh;
- “A.P.” sh.p.k me ofertën ekonomike **13,259,000 lekë**

Me anë të formularit të njoftimit të fituesit me nr. 1481/4 Prot., datë 19.10.2022, u shpall fitues OE “A.P.” sh.p.k me ofertën ekonomike 13,259,000 lekë.

Oferta ekonomike e marrë nga OE fitues (në studimin e tregut) nuk përkon me ofertën ekonomike të paraqitur në zhvillimin e procedurës së prokurimit. Ka një diferencë prej 468,000 lekë.

16. Titulli i gjetjes:	Hartimi i kërkesave dhe të kriterëve të veçanta të kualifikimi jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje Makineri dhe Pajisje për Parkimet”, u konstatua: Nuk është kërkuar katalog për produktet e kërkuara me certifikatë për cilësinë e tyre, si dhe te përkthyer në gjuhën shqipe. Ky kriter është mjaft i rëndësishëm në një kontratë që lidhet me pajisjet dhe makineritë e nevojshme për parkimin si dhe në pikën 2.3.1 është kërkuar që OE duhet të vërtetojë se ka të punësuar në stafin profesional, minimalisht 2(dy)punonjës të trajnuar për mirëmbajtjen e sistemeve te parkimit të listuara në specifikimet teknike. Pra, janë kërkuar dy punonjës, pa përcaktuar kualifikimin apo arsimimin tyre për pjesën e zbatimit të kontratës (montimin e pajisjeve dhe makinerive) por është kërkuar që të jenë të trajnuar në këtë fushë. Për një kontratë të tillë të rëndësishme, ky kriter është i pa plotë dhe nuk ka argumentimin e duhur për të siguruar zbatimin e kontratës.
Kriteri:	Neni 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 2 e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.
Ndikimi/Efekti:	Pengon konkurrencën e drejtë
Shkaku:	Vendosja e kriterëve dhe kërkesave të kualifikimit jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Rëndësia:	E lartë

Rekomandimi:

Tirana Parking, gjatë hartimit të kërkesave dhe kriterëve kualifikuese të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke qenë gjithëpërfshirëse si dhe të krijojnë pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuose si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

Njësia e hartimit e specifikimeve teknike z. B.K., znj. F.M. dhe znj. A.LL., në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe Njësia e Prokurimit z. E. M., znj. L.H. dhe z. B.K. në mospërputhje me Neni 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 2 e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.

Vlerësimi i ofertave

KVO në proces-verbalin e vlerësimit të mbajtur më datë 18.10.2022, nga 4 O.E pjesëmarrës në procedurë, ka kualifikuar O.E A.P. si ofertë të suksesshme, ndërkohë ka vlerësuar se OE F. E., me ofertën më të ulët ekonomike nuk kualifikohet për këto arsye:

- Nuk ka plotësuar kriterin: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot).
Sipas KVO ky kriter nuk plotësohet pasi të gjitha punët e paraqitura nga OE janë jashtë objektit të prokurimit të vendosur nga AK. Gjithashtu në punët e kryera të realizuara me sektorin publik, operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës.
Nga shqyrtim i dokumentacionit rezulton se ky kriter plotësohet pasi ka një faturë që tregon një kontratë të ngjashme që përmbush 20% të fondit limit. Kontrata nr. Kontrata nr.39/8 datë 30.07.2021 “Blerje materiale për sistemin CCTV” në vlerën 5,071,200 lekë me tvsh.
- Nuk ka plotësuar kriterin: Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues i makinerisë ai duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi, **ose autorizim nga distributori i autorizuar prej prodhuesit**, për mallin “**Blerje Makineri dhe Pajisje për Parkimet**”, objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit / dhe distributorit të autorizuar prej prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
Sipas KVO, ky kriter nuk plotësohet pasi autorizimi i prodhuesit nuk përmban të dhëna të plota të prodhuesit / dhe distributorit të autorizuar prej prodhuesit si: telefon, fax, e-mail.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se në autorizimin e prodhuesit rezultojnë të dhënat (adresa dhe nr tel), të cilat gjenden në vulën e tij.
- Nuk plotësohet kriteri: Në mënyrë që të garantohet instalimi korrekt i sistemeve të parkimit në sheshparkimet ku u nevojitet Autoritetit Kontraktor, Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar në stafin profesional, minimalisht **2 (dy) punonjës** të trajnuar për mirëmbajtjen e sistemeve të parkimit të listuara në specifikimet teknike. Për plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesit duhet të paraqesin certifikatën e trajnimit, CV dhe kontratën e punës të vlefshme për të gjithë periudhën e kryerjes së shërbimit të kërkuar.

Sipas KVO, ky kriter nuk plotësohet pasi OE ka paraqitur vetëm certifikatën e trajnimit dhe nuk ka paraqitur CV dhe kontratat e punës për punonjësit.

Në dokumentacion rezulton se janë dy certifikime që tregojnë se punonjësit kanë kryer me sukses trajnimin për suport Teknik, instalim dhe vënie në punë të produkteve të tyre. Derisa kanë vërtetuar që kanë më shumë se 5 punonjës (9 të tillë) të punësuar, mosparaqitja e kontratës së punës dhe cv janë devijime të vogla, në bazë të pikës 3, të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në DST, ndërkohë që edhe në CV e OE të kualifikuar ka gabime e janë të paplota (rezulton qe të dy punonjësit të kenë kryer shkollën e mesme në të njëjtën kohë dhe sipas ditëlindjes së njërit prej tyre, rezulton që t’a ketë zhvilluar shkollën e mesme në moshën 4 vjeçare).

Më tej, KVO, me arsyetimin e verifikimit të përmbushjes së specifikimeve teknike, ka kërkuar nga O.E (konkretisht O.E A.P. sh.p.k dhe O.E F.E. sh.p.k), që t’a pajisi me dokumentacionin e plotë teknik të sistemeve të parkimit, duke u bazuar nenit 92, pika 1, të Kreut XI, të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 82, pika 2 ,të V.K.M-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), pasi specifikimet teknike të kërkuara nga AK janë të tilla që është patjetër e nevojshme paraqitja e dokumentacionit teknik, broshura, etj,nga enti prodhues i mallit që do prokurohet për tu përcaktuar përmbushja e specifikimeve teknike nga OE.

Më tej, në proces-verbalin e mbajtur nga KVO, argumentohet se KVO ka kryer kontrollin e specifikimeve teknike bazuar në dokumentacionin e kërkuar.

K.V.O ka renditur si arsye të mëtejshme skualifikimi të O.E F.E., se nuk përmbush dhe nuk ka dhënë asnjë informacion teknik për specifikimet teknike sipas DST.

KVO ka kualifikuar O.E “A.P.” sh.p.k pasi plotëson kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se kërkesa për dokumentacion është bërë nga A.K me email, dhe dy operatorët ekonomikë kanë përcjellë me email dokumentacion për specifikimet teknike të pajisjeve, kërkesë e bërë kjo në mospërputhje me pikën 2 të nenit 82 të V.K.M- së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe pikës 1 të nenit 92, të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

Procedura duhet të ishte anuluar, në mbështetje të pikës c, të nenit 98 të V.K.M- së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” pasi ka pas mangësi të rëndësishme në DST, të cilat nuk mund t’i kërkohen O.E pas afatit përfundimtar për hapjen e ofertave. Kërkesa për dokumentacion, në rastin konkret **katalogët**, të cilët nuk janë kërkuar në DST, nuk bën pjesë të objektit sqarim.

Arsyet e anulimit të procedurës janë edhe në pikën 26 E (2 c) të DST, ku parashikohet anulimi i procedurës, në rast se DST ka anomali ose mangësi të rëndësishme, pra procedura në kushtet kur nuk është kërkuar katalogu në DST (si dokument verifikues për përmbushjen e specifikimeve teknike), duhet të anulohet, e jo të kërkohet me email nga O.E

17. Titulli i gjetjes:	Vlerësim i procedurës së prokurimit nga ana e KVO, në mospërputhje me legjislacionin në fuqi.
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje Makineri dhe Pajisje për

	Parkimet”, nga e KVO, në momentin e hapjes së ofertave, është kërkuar me anë të emailit që tju vihet në dispozicion katalogu, dokumentacioni i cili duhej të ishte kërkuar që në hartimin e kërkesave dhe kritereve të vecanta të kualifikimit, pasi rëndësia e dokumentacionit katalog është i rëndësishëm së lartë.
Kriteri:	Pika c, të nenit 98 të V.K.M- së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” pasi ka pas mangësi të rëndësishme në DST.
Ndikimi/Efekti:	Zhvillim i garës në kushte të pabarabarta
Shkaku:	Mosnjohja e dispozitave ligjore nga ana e KVO
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Tirana Parking, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në momentin e hapjes së ofertave, të kryejë vlerësimin e tyre sipas dispozitave ligjore dhe në përputhje me to, si dhe të marrë në konsideratë të gjitha kriteret, kërkesat e kualifikimit si dhe specifikimet teknike duke krijuar kushtet e zhvillimit të një gare në kushtet e plota të konkurrencës.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

Komisioni i Vlerësimi të ofertave znj. D.C., znj.A. P. dhe z. E.M. në mospërputhje me Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr. 4*, datë 12.06.2023

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 732/28 prot, datë 13.07.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Lidhur me gjetjen e sipërcituar në pikën 2.2.1 ju sqarojmë se: Bazuar në Nenin 55 pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e prokurimit publik”, operatorit i është kërkuar xhiro jo më pak se 40% e fondit limit në përputhje me këtë VKM (VKM-ja përcakton kriteret që AK duhet ti kërkojë OE, e thënë ndryshe AK nuk mund ti kërkojë OE xhiro më shumë se 40 % të vlerës së kontratës së përlllogaritur), e njëjta gjë është e cituar edhe te pika 2.2.1 e Procesverbalit Tip të publikuar në APP.

Lidhur me gjetjen e sipërcituar në pikën 2.3.1, argumentimi është bërë në faqen nr.9 të “Proces verbalit të përcaktimit të kritereve të pranimit të kualifikimit” sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës. Eshte kërkuar që punë të ngjashme të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% (kufirin maksimal të tagrit ligjor), në përputhje me nenin 28, pika 3 “ Kontratat e shërbimeve”, të VKM-së Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, për sa i përket kufirit maksimal kemi marrë parasysh kontratat e publikuara në sistemin elektronik të APP-së të kësaj lloji natyre , të cilat kanë një vlerë shumë herë më të madhe se kontrata e pastrimit që prokurohen nga institucioni jonë.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Njësia e prokurimit ka kërkuar kusht të mjaftueshëm që O.E pjesëmarrës në procedurë të kenë staf të specializuar për montimin dhe vendosjen në punë të sistemeve të parkimit, çka mund të realizohet vetëm nga persona të cilët kanë trajnimin e duhur nga vetë prodhuesi i paisjeve të parkimit. Arsimi i stafit në këtë rast nuk shërben për të përcaktuar aftësinë e këtij të fundit për të zbatuar siç duhet kontratën, ndaj Njësia e Prokurimit ka vendosur si kriter vetëm çertifikimin e stafit për të realizuar me sukses procedurën e prokurimit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e dërguar, përsa i përket kritereve të pranimit të kualifikimit gjetjet janë të bazuara në legjislacionin përkatës dhe grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim në lidhje për sa më sipër.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

• **Procedura “Shërbim të Pastrimit dhe Gjelbërimit” 2022**

Përshkrimi i procedurës

Me shkresë Nr. 605 Prot., datë 23.03.2022 të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme është bërë kërkesë, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, për shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit në Sheshe mbi e nën tokë dhe Terminale, duke i'u referuar punës pa ndërprerje 24 orë përgjatë gjithë javës, që ofrohet në funksion të administrimit të shesheve mbi dhe nën tokë si dhe terminalat, të renditur si më poshtë:

- Sheshi i parkimit dhe Terminali i Autobusëve Ndërkombëtarë dhe të Kosovës pranë Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”
- Sheshi i parkimit dhe Terminali i Autobusëve të juglindjes pranë Qytetit Studenti
- Sheshi i parkimit “Avni Rustemi”
- Sheshi i parkimit pranë Digës së Liqenit
- Parkimi Nëntokësor pranë Sheshit Skënderbe
- Parkimi Nëntokësor Bulevardi i Ri te ish Stacioni i Trenit
- Parkimi Nëntokësor pranë Sheshit Italia
- Parkimi Nëntokësor pranë Kopshtit Zoologjik

*sip totale 51,064.10 m2 (në bazë të relacionit të NJHSP në relacionin përmbledhës nr. 605/3 prot., datë 15.04.2022)

Fondi limit

Në vlerën 8,769,799 (tetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbim të Pastrimit dhe Gjelbërimit” 2022		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 69 datë 20.04.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur e Thjeshtuar	2. Njësia e Prokurimit Znj. F.M. Znj. D.P. Znj. J.M.	3. Komisioni për Përllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: Znj. J.A. Z. A.M. Z. E.V.
4. Fondi limit (pa tvsh) 8,769,799 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i shtetit	6. Data e hapjes së tenderit 18.05.2022 (zhv)
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës BOE “CF” sh.p.k & “SHI” 8,298,666 lekë “PS” sh.p.k 8,578,666 lekë b) kualifikuar: BOE “CF” sh.p.k & “SHI” 8,298,666 lekë	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Z. E.M. Znj. D.C. Znj. E.C.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 8,298,666 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë shërbimi datë 21.06.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 471,133 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës Znj. D.C. Znj.A.B. (ka zëvendësuar znj.J.M.)	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës Nga lidhja e kontratës deri 31.12.2022

Z. E.N.		
16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/shërbimi		
Nr. 22/2022 14.07.2022 473,552 lekë me tvsh		
Nr. 25/2022 12.08.2022 1,277,922 lekë me tvsh		
Nr. 26/20022 06.09.2022 1,191,521 lekë me tvsh		
Nr. 30/2022 30.09.2022 1,165,746 lekë me tvsh		
Nr. 44/2022 31.12.2022 1,098,518 lekë me tvsh		

Për përlllogaritjen e fondit limit, Autoriteti Kontraktor (këtu e tutje A.K.), në relacionin përmbledhës Nr. 605/3 Prot., datë 15.04.2022, është bazuar në çmimet e Kontratës të Shërbimit Nr. 486/6 Prot., datë 19.05.2021. Në këtë relacion, Komisioni i ngritur për përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike, ka përcaktuar vlerën 8,769,799 lekë pa tvsh për “Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit për Sheshe mbi e nën tokë dhe Terminale”.

A.K ka hartuar procesverbalin e datës 26.04.2022 për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Në këtë procedurë prokurimi, të zhvilluar më datë 18.05.2022, kanë qenë pjesëmarrës dy O.E:

- BOE “CF” sh.p.k & “SHI” 8,298,666 lekë
- “PS” sh.p.k 8,578,666 lekë

Me anë të formularit të njoftimit të fituesit me nr. 797/8 Prot., datë 08.06.2022, u shpall fitues BOE “CF” sh.p.k & “SHI” me ofertën ekonomike 8,298,666 lekë pa tvsh.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të mësipërm u konstatua:

Në pikën 2.2.1 nga AK për kapacitetin ekonomik dhe financiar është kërkuar:

“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më të vogël se 40%** e vlerës së fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës”, në mospërputhje me shkronjën c¹⁴, pika 2, Neni 43 dhe pikën 4¹⁵, Neni 55, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilës vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit e hapur e thjeshtuar (për kontrata nën kufirin e ulët monetar). Përveç mospërputhjes ligjore të sipërcituar, nga NJP për këtë kërkesë nuk është dhënë argumentimi se si ndikon ky marzh në përmbushjen e kontratës së prokurimit. Për më tepër që edhe në shkresën e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-40%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 30% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3.

Në pikën 2.3.1 nga AK për përvojën e suksesshme është kërkuar:

¹⁴ vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës.

¹⁵ Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

“Shërbime të një natyre të ngjashme për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të vogël se 40%** e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”, në mospërputhje me shkronjën ”b”¹⁶, pika 4, Neni 55, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilës për kontratat e mallrave dhe të shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të madhe se 20%** të vlerës së përlloritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Pra, VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-20%. Sjellim në vëmendje sërish shkresën e APP nr. 3872, datë 10.06.202, si edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.1797/1 prot., datë 10.03.2022, pika 3.

Këto kritere, janë të ekzagjeruara dhe diskriminuese për OE, si dhe nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe dhe pikës 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

18. Titulli i gjetjes:	Hartimi i kërkesave dhe të kriterëve të veçanta të kualifikimi jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Situata:	<p>Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shërbim të Pastrimit dhe Gjelbërimit”, për vitin 2022 u konstatua:</p> <p>Në pikën 2.2.1 nga AK për kapacitetin ekonomik dhe financiar është kërkuar: “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës”, në mospërputhje me shkronjën c¹⁷, pika 2, Neni 43 dhe pikën 4¹⁸, Neni 55, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilës vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlloritur të kontratës.</p> <p>Në pikën 2.3.1 nga AK për përvojën e suksesshme është kërkuar: “Shërbime të një natyre të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”, në mospërputhje me shkronjën ”b”¹⁹, pika 4, Neni 55, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilës për kontratat e mallrave dhe të shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlloritur të kontratës.</p>

¹⁶ vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

¹⁷ vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës.

¹⁸ vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlloritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

¹⁹ vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kriteri:	Neni 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 2 e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.
Ndikimi/Efekti:	Pengon konkurrencën e drejtë
Shkaku:	Vendosja e kriterëve dhe kërkesave të kualifikimit jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Tirana Parking, gjatë hartimit të kërkesave dhe kriterëve kualifikuese të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke qenë gjithëpërfshirëse si dhe të krijojnë pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

Njësia e Prokurimit, znj. F.M., znj. D.P. dhe znj. J.M. dhe Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike znj. J.A., z. A.M. dhe z. E.V..

- **Vlerësimi i ofertave**

KVO ka vlerësuar se OE “P.S.” sh.p.k nuk ka plotësuar kriteret e veçanta të përcaktuara në DST:
 -makinë vetëshkarkuese me hapje të spondit anësor ose nga pas, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve dhe mirëmbajtje të parkimeve gjatë ditës, me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton, ka vetëm 1 nga 2 të kërkuar.

-Autobot uji ka vetëm 1 nga 3 të kërkuara.

KVO ka vlerësuar se BOE “CF” sh.p.k & “SHI” ka plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta.

Nga dokumentacioni rezulton se Shoqëria “CF” sh.p.k ka lidhur kontratë qiraje nr. Nr. 4530 Rep. Nr. 1194 Kol datë 16.05.2022 me Shoqërinë “F” shpk për disa mjete si më poshtë:

A20220513401328890

Nr.	Lloji i pajisjeve	Targa	Nr i tije Qarkullimi	Nr Sbasic	Të dhëna të tjera
1	Korrese bari cipe 5				Fature latimore Nr 2104 date 18.09.2014
2	Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fanilor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 1-1.5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6;	AA205T C	TRDA0149818	VWASF1Y24B212022 S	
3	Makinë teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 7-9 ton, të pajisur me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qëndrore rrual, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës.	AA329S Y	TRDA5473517	YS2PMX20002012105	
4	Makinë teknologjike e vogël për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës deri në 1 ton, të pajisur me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qëndrore rrual, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës.				Fature Tatimore Nr 83 date 30.11.2018
5	Makinë vetësharkuese, me hapje të spondit anësor ose nga pas, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve dhe mirëmbajtje të parkimeve gjatë ditës, me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton.	AA819T A	TRDA5727617	WDH9062531N53191	
6	Makinë vetësharkuese, me hapje të spondit anësor ose nga pas, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve dhe mirëmbajtje të parkimeve gjatë ditës, me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton.	AA154G O	TRDB3351113	WDB9044231P750928	
7	Makinë vetësharkuese, me hapje të spondit anësor ose nga pas, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve dhe mirëmbajtje të parkimeve gjatë ditës, me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton.	AA840T A	TRDA5727717	WD191061531N352082	
8	Makinë, me hapje të spondit anësor ose nga pas, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve dhe mirëmbajtje të parkimeve gjatë ditës, me kapacitet mbajtës deri 1.5 ton.	AA306Y S	TRDA3387816	AHTR22G806111501	
9	Makinëci pompe speciale për larje dyshemeje				Fature latimore nr 6 date 03.09.2019
10	Makinëci speciale për fshirjen e pllakave				Fature latimore nr 7 date 19.03.2019
11	Autobot për ujë të zezë	AA163N Z	TRDA2698616	YV2F5A6C7PA378568	
11	Autobot uji	AA702K A	TRDB7679914	YV2L7FSA4DA02424 4	
12	Autobot uji	AA842T	TRDB7625514	WDB6520042K124993	
13	Autobot uji	AA978T H	TRDA1689016	WMAH05Z244M3817 26	

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultojn se:

BOE fitues për mjetet e marra me qera sipas kontratës së mësipërme, në dokumentacionin përkatës të mjeteve ka paraqitur edhe certifikatë për transport mallrash për llogari të vet (në emër të “F” sh.p.k), pra certifikata e lëshuar nga njësi vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, qiradhënësi e ka për përdorim vetjak”.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”.

Dokumentacioni i paraqitur vërteton vetëm faktin se mjetet janë në pronësi të qiradhënësit, por përdorimi i tyre do të ishte i pamundur nga qiramarrësi si në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Mjeti me targa A T marrë me qira si makinë teknologjike e vogël për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës deri në 1 ton, të pajisur me dy fshesa anësore dhe një fshesë qëndrore rrual, sistem thithës së pluhurave dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës, rezultojn pa dokumentacion përkatës si mjet që shënohet në regjistër publik, duke e bërë të pamundur verifikimin e tij për përmbushjen e kriterëve të përcaktuar në DST.

Sa më sipër BOE fitues **nuk** plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet t'i kishte kualifikuar BOE "CF" shpk & shpk & "SHI" shpk, si dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", si më poshtë:

- neni 98 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika nr.1, germa (b), ku thuhet :

"Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastin kur në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme.

- nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3:

"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Gjithashtu në KVO nuk është asnjë ekspert i fushës në mospërputhje me nenin 58 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Komisioni i Vlerësimit të ofertave".

19. Titulli i gjetjes:	Vlerësim i procedurës së prokurimit nga ana e KVO, në mospërputhje me legjislacionin në fuqi.
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit "Shërbim të Pastrimit dhe Gjelbërimit", për vitin 2022, nga dokumentacioni rezulton se Shoqëria "CF" sh.p.k, fitues i procedurës së prokurimit të mësipërm, ka lidhur kontratë qiraje nr. Nr. 4530 Rep. Nr. 1194 Kol datë 16.05.2022 me Shoqërinë "F" shpk. Për mjetet e marra me qera sipas kontratës së mësipërme, në dokumentacionin përkatës të mjeteve ka paraqitur edhe certifikatë për transport mallrash për llogari të vet (në emër të "F" sh.p.k), pra certifikata e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar "Për llogari të vet, qiradhënësi e ka për përdorim vetjak". <i>Dokumentacioni i paraqitur vërteton vetëm faktin se mjetet janë në pronësi të qiradhënësit, por përdorimi i tyre do të ishte i pamundur nga qiramarrësi si në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit "Për Transportin Rrugor".</i>
Kriteri:	Pika 3, e nenit 92 të V.K.M- së Nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" pasi ka pas mangësi të rëndësishme në DST.
Ndikimi/Efekti:	Zhvillim i garës në kushte të pabarabarta
Shkaku:	Mosnjohja e dispozitave ligjore nga ana e KVO
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Tirana Parking, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në momentin e hapjes së ofertave, të kryejë vlerësimin e tyre sipas dispozitave ligjore dhe në përputhje me to, si dhe të marrë në konsideratë të gjitha kriteret, kërkesat e kualifikimit si dhe specifikimet teknike duke krijuar kushtet e zhvillimit të një gare në kushtet e plota të konkurrencës.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

Komisioni i Vlerësimi të ofertave z. E.M., znj. D.C., znj. E.C. në mospërputhje me Nenin 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

• **Procedura “Shërbim të Pastrimit dhe Gjelbërimit” 2021**

Përshkrimi i procedurës

Me shkresë Nr. 475 Prot., datë 16.03.2021 të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme është bërë kërkesë, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, për shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit në Sheshe mbi e nën tokë dhe Terminale, duke i'u referuar punës pa ndërprerje 24 orë përgjatë gjithë javës, që ofrohet në funksion të administrimit të shesheve mbi dhe nën tokë si dhe terminalet, të renditur si më poshtë:

- Sheshi i parkimit dhe Terminali i Autobusëve Ndërkombëtarë dhe të Kosovës pranë Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”
- Sheshi i parkimit dhe Terminali i Autobusëve të juglindjes pranë Qytetit Studenti
- Sheshi i parkimit të Stadiumit “Selman Stërmasi”
- Sheshi i parkimit “Avni Rustemi”
- Sheshi i parkimit pranë Digës së Liqenit
- Parkimi Nëntokësor pranë Sheshit Skënderbe
- Parkimi Nëntokësor Bulevardi i Ri te ish Stacioni i Trenit
- Parkimi nëntokësor 7 Xhuxhat në rrugën e Elbasanit
- Parkimi Nëntokësor pranë Sheshit Italia

*sip totale 48,364.00 m2 (në bazë të relacionit përmbledhës nr. 475/3 prot., datë 19.03.2021 të NJHSP)

Fondi limit në vlerën 8,429,587 (tetë milion e katërqind e njëzetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbim të Pastrimit dhe Gjelbërimit” 2021		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 41 datë 19.03.2021		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur	2. Njësia e Prokurimit Znj. J.A. Z. E. M. Znj. D.P.	3. Komisioni për Përlllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: Z. K. ZH.(specialist me pagesë) Znj. J.GJ. Znj. G. R.
4. Fondi limit (pa tvsh) 8,429,587 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i shtetit	6. Data e hapjes së tenderit 19.04.2021 (zhv)
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës “F” sh.p.k 8,315,505 lekë “D-A” sh.p.k 8,409,792.8 lekë b) kualifikuar: “F” sh.p.k 8,315,505 lekë	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Z. E.M. Znj. D.C. Znj. E.C.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 8,315,505 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë shërbimi datë 19.05.2021	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 114, 082 lekë	12. Ankimime S’ka
13. Struktura për ndjekjen e kontratës Znj. J.A. Z..E.N. Znj. DH. U. (ka zv. Znj.E.H.)	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës Nga lidhja e kontratës deri 31.12.2021
16. Situacioni përfundimtar/Faturëmalli/shërbimi Fatura nr. 48/2021 dt. 03.06.2021 561,324 lekë Fatura nr. 16/2021 dt. 09.07.2021 1,177,688 Fatura nr. 56/2021 dt. 10.08.2021		

1,243,482			
Fatura nr. 113/2021	dt.	15.09.2021	
1,249,257			
Fatura nr. 143/2021	dt.	06.10.2021	
1,181,190			
Fatura nr. 199/2021	dt.	04.11.2021	
1,193,821			
Fatura nr. 233/2021	dt.	06.12.2021	
1,183,249			

Për përlllogaritjen e fondit limit, Autoriteti Kontraktor (këtu e tutje A.K.), në relacionin përmbledhës Nr. 475/3 Prot., datë 19.03.2021, është bazuar në çmimet e Kontratës së suksesshme të Shërbimit Nr. 663/7 Prot., datë 28.05.2020. Në këtë relacion, Komisioni i ngritur për përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike, ka përcaktuar vlerën 8,429,587 lekë pa tvsh për “Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit për Sheshe mbi e nën tokë dhe Terminale”.

A.K ka hartuar procesverbalin e datës 26.04.2022 për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Në këtë procedurë prokurimi, të zhvilluar më datë 19.04.2021, kanë qenë pjesëmarrës dy O.E:

- OE “F” sh.p.k me ofertë ekonomike 8,315,505 lekë pa tvsh
- OE “D-A” sh.p.k 8,409,792.8 lekë

Me anë të formularit të njoftimit të fituesit me nr. 486/4 Prot., datë 10.05.2021, u shpall fitues OE “F.” sh.p.k me ofertë ekonomike 8,315,505 lekë pa tvsh.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të mësipërm u konstatua:

Nga AK nuk janë argumentuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në proces-verbalin përkatës (të mbajtur më datë 24.03.2021), në mospërputhje me pikën 2²⁰ të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

· **Në pikën 3.3.1** të DST, nga AK për përvojën e suksesshme është kërkuar:

“Shërbime të një natyre të ngjashme me objektin e prokurimit **me vlerë 40%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit,” në mospërputhje me pikën 2²¹, të Nenit 25, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilës për për të provuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në **një vlerë jo më të madhe se 40%** të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit. Pra, VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-40% (jo më të vogël se...) dhe jo barazia e vlerës maksimale në raport me atë të fondit limit. Gjithashtu, sikurse përmendur më lart, nuk është argumentuar se përse është kërkuar kjo vlerë për të vërtetuar përvojën e mëparshme të OE.

· **Në pikën a) 3.3.11 të DST**, nga AK është kërkuar licenca mjedisore e lëshuar nga QKL,për pastrimin, larje rrugësh, fshirje rrugësh(KODI iii 1 A), përveçse e pa argumentuar si kërkesë,

²⁰ Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht si dhe duhet të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre..

²¹ vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit..

ndër të tjera kjo leje mjedisore e tipit C, nuk ka në fokus të veprimtarisë së saj pastrimin, larjen e fshirjen e rrugëve por magazinimin dhe trajtimin e mbetjeve të ujërave të zeza, që nuk ka lidhje me objektin e prokurimit. *Gjithashtu, në bazë të pikës 3²² të nenit 10 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime të ligjit nr. 10448 datë 14.07.2011, “Për lejet mjedisore”, të gjitha instalimet të tipit C, të cilat nuk klasifikohen si leje mjedisi të tipit B, janë shfuqizuar.*

Në pikën 3.3.12 të DST, për kapacitetet teknike, nga AK është kërkuar një listë e makinerive që duhet që OE duhet të disponojnë OE, ku ndër të tjera janë kërkuar 3 (tre) makina vetëshkarkuese, me hapje të spondit anësor ose nga pas për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve dhe mirëmbajtje të parkimeve me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton, si dhe 3 (tre) makina me hapje të spondit anësor ose nga pas për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve dhe mirëmbajtje të parkimeve me kapacitet 1.5 ton, si dhe 1 (një) autovinc, kërkesa këto përveçse të pa argumentuara janë të ekzagjuruara dhe kufizojnë O.E (duke krahasuar dhe me prokurimin me të njëjtin objekt të vitit 2022, i cili rezulton si shërbim për një sipërfaqe më të madhe për pastrim e gjelbërim se i vitit 2021, ku janë kërkuar më pak mjete për këtë shërbim). Këto kritere, të cilat nuk i shërbejnë A.K. por kufizojnë O.E, nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, pikës 1, të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM me nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”.

20. Titulli i gjetjes:	Hartimi i kërkesave dhe të kriterëve të veçanta të kualifikimi jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shërbim të Pastrimit dhe Gjelbërimit”, për vitin 2021 u konstatua: Në pikën 3.3.1 të DST, nga AK për përvojën e suksesshme është kërkuar: “Shërbime të një natyre të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlloragitur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit,” në mospërputhje me pikën 2 ²³ , të Nenit 25, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilës për për të provuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlloragitur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit Në pikën a) 3.3.11 të DST, nga AK është kërkuar licenca mjedisore e lëshuar nga QKL,për pastrimin, larje rrugësh, fshirje rrugësh(KODI iii 1 A), përveçse e pa argumentuar si kërkesë, ndër të tjera kjo leje mjedisore e tipit C, nuk ka në fokus të veprimtarisë së saj pastrimin, larjen e fshirjen e rrugëve por magazinimin dhe trajtimin e mbetjeve të ujërave të zeza, që nuk ka lidhje me

²² Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit C, të cilat nuk klasifikohen si leje mjedisi të tipit B, sipas pikës 1, të këtij neni, me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen.

²³ vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlloragitur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit..

Kriteri:	objektin e prokurimit Neni 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 2 e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.
Ndikimi/Efekti:	Pengon konkurrencën e drejtë
Shkaku:	Vendosja e kriterëve dhe kërkesave të kualifikimit jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Tirana Parking, gjatë hartimit të kërkesave dhe kriterëve kualifikuese të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke qenë gjithëpërfshirëse si dhe të krijojnë pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

Njësia e Prokurimit, znj. J.A. z. E. M. dhe znj. D.P. dhe Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike, z. K.ZH., znj. J.GJ. dhe znj. G. R..

- **Procedura “Rikonstruktion i Sheshit të parkimit Selman Stermasi” 2019**

Përshkrimi i procedurës

Me shkresë Nr. 1002 Prot., datë 30.07.2019 të Drejtorit të Administrimit të Shërbimit të Parkimit me Pagesë është bërë kërkesë, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, për rikonstruktion të Sheshit të Parkimit Selman Stermasi, nisur nga vështirësitë e hasura në realizimin e detyrave për shkak të ngërceve në punë.

Fondi limit

Në vlerën 15,242,949 (pesëmbëdhjetë milion e dyqind e dyzetë e dy mijë e nëntëqind e dyzetë e nëntë) lekë pa TVSH

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruktion i Sheshit të Parkimit të Selman Stermasi” 2019		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 172 datë 01.08.2019		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur	2. Njësia e Prokurimit Z. E. M. Z. P.SH. Z. K.ZH.	3. Komisioni për Përlllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: Z. E. M. Z. P.SH. Z. K.ZH.
4. Fondi limit (pa tvsh) 15,242,949 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i shtetit	6. Data e hapjes së tenderit 18.09.2019 (zhv)
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës · KT sh.p.k 13,519,620 lekë · N sh.p.k 12,816,440 lekë · E 2” sh.p.k 11,257,231 lekë · SH-A” sh.p.k 11,714,609 lekë · KC” sh.p.k 10,489,512.64 lekë · S sh.p.k 14,308,397 lekë · B3 sh.p.k 13,554,868 lekë · F sh.p.k 14,359,537 lekë	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Znj. E.Q. Z. B.K. Znj. R.B.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 15,005,877.33 lekë

<ul style="list-style-type: none"> · B-I” sh.p.k 12,247,008 lekë · K” sh.p.k 12,230,891 lekë · BOE V K sh.p.k & “R. G. sh.p.k 15,005,877.33 lekë · S sh.p.k 13,023,239 lekë · b) kualifikuar: BOE V.K sh.p.k & “R.G.” sh.p.k 15,005,877.33 lekë 		
<p>10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë sipërmrrje Nr. 1026/1 datë 19.11.2019</p>	<p>11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 237, 071 lekë</p>	<p>12. Ankimime Ankesa për DST</p> <ul style="list-style-type: none"> · Ankesa nr. 1042 prot., datë 07.08.2019 “A” sh.p.k · Ankesa nr. 1054 prot., datë 13.08.2019 “KC” sh.p.k <p>Ankesa për zhvillimin e procedurës</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ankesa nr. 1312 prot., datë 04.10.2019 “KC” sh.p.k 2. Ankesa nr. 1350 daë 10.10.2019 “KC sh.p.k <p>Venndim KSHA nr. 1350/2 datë 14.10.2019</p>
<p>13. Struktura për zbatimin e ndjekjen e kontratës Z. J. F. Z..K.ZH. Znj. J.GJ</p>	<p>14. Fletë hyrja</p>	<p>15. Afati i kontratës 2 muaj nga data e lidhjes së kontratës</p>
<p>16. Situacioni përfundimtar/Faturëmalli/shërbimi Situacion nr. 82 dt. 10.12.2019 7,622,640 lekë Situacion nr. 04 dt. 22.0.2020 7,383,148 lekë</p>		

A.K ka hartuar procesverbalin e datës 01.08.2019 për hartimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, ku ndër të tjera bëhet me dije se për përlogaritjen e fondit limit është Drejtoria e e Administrimit të Parkimit Publik me Pagesë është mbështetur në “Studim dhe Projektim Ndërtimi i Sheshit të Parkimit të Selman Stërmasi” me nr. 530/5 datë 09.05.2019 dorëzuar pranë Tirana Parking nga Kompania e kontraktuar për përgatitjen e projektit sipas kontratës së nënshkruar me Nr. 530/3 datë 09.04.2019.

Nga KVO është shpallur si ofertë e vlefshme BOE VK sh.p.k & “R.G.” sh.p.k me ofertë ekonomike 15,005,877.33 lekë, si dhe është shpallur fitues me sjkresën nr. 1026/8 datë 28.10.2019.

Për procedurën ka pasur dy ankesa nga i njëjti O.E “KC” sh.p.k, pranë AK .

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të mësipërm u konstatua:

- Nga AK nuk janë argumentuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në proces verbalin përkatës (të mbajtur më datë 24.03.2021), në mospërputhje me pikën 2²⁴ të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
- Në pikën 2.2.2 të DST, nga AK për kapacitetin ekonomik dhe financiar është kërkuar “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore

²⁴ Hartimi i kërkesave të vecanta për kualifikim, duhet të argumentohet tekniksht dhe ligjërish si dhe duhet të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

për vitet financiare 2016, 2017, 2018, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë **jo më e vogël se 50%** e vlerës së fondit limit”, në mospërputhje me shkronjën b²⁵, pika 7, Neni 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, sipas të cilës në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nuk mund të tejkalojë 50% të vlerës limit të kontratës që prokurohet. Përveç mospërputhjes ligjore të sipërcituar, nga NJP për këtë kërkesë nuk është dhënë asnjë argumentim se si ndikon ky marzh në përmbushjen e kontratës së prokurimit.

- Në pikën 2.3.2 të DST, nga AK është kërkuar staf inxhinierik, ndër të tjera dhe “.....1 (një)inxhinier gjeolog” rezulton se kjo kërkesë nuk i shërben AK duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do realizohen për këtë rikonstrukcion, pra në preventivin e punimeve dhe në relacioni Teknik (nga gjendja ekzistuese e parkimit është propozuar të hiqet kabina ekzistuese, pllakat e sheshit të parkimit dhe nivelim të sipërfaqes.) nuk është parashikuar asnjë punim që kërkon ekspertizën e një inxhinieri gjeolog Kjo kërkesë për më tepër është e paargumentuar teknikisht e ligjërish në procesverbal, në mospërputhje me pikën 1 të nenit 46 të LPP si dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014.
- Në pikën 2.3.4 të DST, A.K. ka kërkuar “një punësim mesatar i të paktën 50 punonjësve me kohë të plotë pune, për periudhën prill 2018 – prill 2019”. Në procesverbal nuk është argumentuar teknikisht e ligjërish kjo kërkesë. Sa i takon shtrirjes kohore për një periudhë 13 mujore e kërkuar nuk është koherente në raport me kohën kur është parashikuar të zhvillohet procedura, Shtator 2019, si dhe shtrirja e kriterit për periudhën mbi 1 vit nuk i shërben AK. Gjithashtu numri i punonjësve të kërkuar prej 50 personash është një numër shumë i madh për tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet.

Këto kritere diskriminuese, të cilat nuk i shërbejnë AK por kufizojnë O.E, nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, pikës 1, të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM me nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”.

Sjellim në vëmendje që edhe nga APP, për këtë procedurë prokurimi, është rekomanduar ndër të tjera që kërkesat 2.3.2 dhe 2.3.4 të vlerësohen dhe nga AK, pasi kriteret e vendosura nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik. Rekomandimet për këto kërkesa nuk janë reflektuar në shtojcën e kriterëve të veçanta të kualifikimit.

²⁵ në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nuk mund të tejkalojë 50% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

21. Titulli i gjetjes:	Hartimi i kërkesave dhe të kriterëve të vecanta të kualifikimi jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i Sheshit të Parkimit të Selman Stermasi”, u konstatuan kërkesa dhe kriterë të vecanta të kualifikimit jo në proporcion me objektin dhe vlerën e kontratës, si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> · staf inxhinierik, ndër të tjera dhe “.....1 (një)inxhinier gjeolog” · “një punësim mesatar i të paktën 50 punonjësve me kohë të plotë pune, për periudhën prill 2018 – prill 2019.
Kriteri:	Neni 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 2 e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.
Ndikimi/Efekti:	Pengon konkurrencën e drejtë
Shkaku:	Vendosja e kriterëve dhe kërkesave të kualifikimit jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Tirana Parking, gjatë hartimit të kërkesave dhe kriterëve kualifikuese të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke qenë gjithëpërfshirëse si dhe të krijojnë pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

Njësia e Prokurimit dhe Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike, z. E. M., z. P.SH., z. K.ZH.

- **Vlerësimi i ofertave**

KVO ka vlerësuar se BOE V.K dhe R.G. ka plotësuar të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, duke e shpallur fitues të kësaj procedure.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton si më poshtë:

- Proces-verbali i mbajtur nga KVO dt. 01.11.2019, mbi verifikimin e dokumentacionit të fituesit, sa i takon pikës 10 të tij, mbi dokumentacionin e makinerive të BOE, është i paqartë në citimin e kontratave të qerasë, të cilat nuk përcaktojnë se cilat mjeteve i referohen konkretisht.
- Theksojmë se për O.E “KC” sh.p.k është argumentuar skualifikimi për mospajisjen me certifikatë për të tretë për mjetet e marra me qera.
- Ndërkohë për mjetin grejder, i cili rezulton me goma (sipas fotos), nuk ka asnjë dokumentacion, përveçse kontratës së shitblerjes Nr. 1 Rep Kol datë 23.03.2009 dhe një fature e paqartë e datës 04 korrik 2008, konkretisht për automjetin sheshues nivelizues e vetëlëvizës marka M 302 me regjistrim nr. R8 datë 04.07.2008. Pra mjeti përveçse nuk rezulton i blerë nga njëri prej dy OE të BOE, duhet të kishte dokumentacionin përkatës përsa kohë është mjet i regjistruar. Në provesverbalin e konfirmimit të dokumentacionit të fituesit, për mjetin grejder rezulton kontrata shitblerje nr. 14 rep kol dhe jo Nr. 1617 Rep Kol (sikurse është në dokumentet e dorëzuar).
- Për mjetin eskavator C në bazë të fotos bashkëlidhur rezulton të jetë me zinxhir (jo sipas DST ku kërkohet me gome) dhe certifikata për transport mallrash për llogari të vet dhe të trete është e

vlefshme deri dt 04.12.2019, pra nuk është e vlefshme, pasi mbaron pa u mbyllur punimet e kontratës dy mujore te lidhur më 19.11.2019.

Për kamionët AJ, AT(të marrë me qera nga “D” sh.p.k) certifikatat për transport mallrash nuk janë të vlefshme, te vlefshme deri dt. 16.10.2019. Për kamionin AF, dokumentet nuk janë të qartë për të lexuar kapacitetin mbajtës.

Nga KVO është skualifikuar O.E “KC” sh.p.k, me ofertë ekonomike 10,489,512 lekë, në diferencë prej 4,516,316 lekë nga BOE fitues, për arsyet e mëposhtme:

Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
-------------	--------	---------------------

Operatori ekonomik “KC” sh.p.k në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur Autobotin me targa AL.

Në përmbushje të kriterit 11 pika a) të kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, certifikatë e pronësisë, foto të mjetit si dhe certifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

“certifikata e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qiradhënësi e ka për përdorim vetjak. Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse. Dokumentacioni i paraqitur vërteton vetëm faktin se mjetet janë në pronësi të qiradhënësit, por përdorimi i tyre do të ishte i pamundur nga qiramarrësi si në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Gjithashtu vijon:

Makineri lëvizëse tip Karrel, me ndriçim fosforeshent dhe drita me table	1 copë	Pronësi ose me qera
--	--------	---------------------

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, që bie në kundërshtim me pikën 11gërma (a) te dst-së në të cilën sanksionohet “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (aktin e pronësisë) b)leje qarkullimi; c)certifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (aktin e pronësisë); b) leje qarkullimi; c)certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit,(i

vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerase/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes”.

“Operatori ekonomik “KC” SHPK në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur vetëm një faturë tvsh me nr. 282 datë.

Përsa cituam më lart paraqitja e dokumentacionit lidhur me mjetet: Makineri lëvizëse tip Karel, me ndriçim fosforeshent dhe drita me tabele , do të konsiderohet i paplotë dhe për rrjedhojë do të konsiderohet i pavlefshëm.

Përsa takon vlerësimit nga KVO mbi skualifikimin e OE “KC”, për mjetin Karrel, është argumentuar më sipër që bazuar në pikën 4 të nëni 56 të Ligjit nr. 8378 datë 22.07.1998 “Kodit Rrugor “, sipas të cilës karrel është mjet shtojcë që nuk kanë më shumë se dy rrota.....”. Edhe për BOE fitues, nga fatura e blerjes, kareli rezulton i blerë si pjesë e veçantë nga automjeti AL, për të cilin është bashkëlidhur gjithë dokumentacioni”.

Sa i takon argumentit për autobotin e ujit që certifikata e paraqitur për transport mallrash nuk është për llogari për të tretë, ky argument vlen edhe për disa mjete të BOE fitues, sikurse janë cituar më lart.

Në KVO nuk është asnjë ekspert i fushës në mospërputhje me nenin 58 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Komisioni i Vlerësimit të ofertave”.

22. Titulli i gjetjes:	Vlerësim i procedurës së prokurimit nga ana e KVO, në mospërputhje me legjislacionin në fuqi.
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shërbim të Pastrimit dhe Gjelbërimit”, për vitin 2021, nga dokumentacioni rezulton se BOE “V.K sh.p.k & “R.G.” sh.p.k, fitues i procedurës së prokurimit të mësipërm, nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, që bie në kundërshtim me pikën 11 gërma (a) të dst-së në të cilën sanksionohet “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (aktin e pronësisë) b)leje qarkullimi; c)certifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet: a)dokumentë që vërteton regjistrimin e tij (aktin e pronësisë); b) leje qarkullimi; c)certifikatën e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).
Kriteri:	Pika 3, e nenit 92 të V.K.M- së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” pasi ka pas mangësi të rëndësishme në DST.
Ndikimi/Efekti:	Zhvillim i garës në kushte të pabarabarta
Shkaku:	Mosnjohja e dispozitave ligjore nga ana e KVO
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Tirana Parking, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në momentin e hapjes së ofertave, të kryejë vlerësimin e tyre sipas dispozitave ligjore dhe në përputhje me to, si dhe të marrë në konsideratë të gjitha kriteret, kërkesat e kualifikimit si

dhe specifikimet teknike duke krijuar kushtet e zhvillimit të një gare në kushtet e plota të konkurrencës.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

Komisioni i Vlerësimi të ofertave znj. E.Q., z. B.K. dhe znj. R.B. në mospërputhje me Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 732/28 prot, datë 13.07.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Mbi këtë gjetje ju bëjmë me dije se, argumentimi është bërë në faqen nr.9 të “Proces verbalit të përcaktimit të kriterëve të pranimit të kualifikimit” sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës. Është kërkuar që puna e ngjashme të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% (kufirin maksimal të tagrit ligjor), në përputhje në nenin 28, pika 3 “Kontratat e shërbimeve”, të VKM-së Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, për sa i përket kufirit maksimal kemi marë parasysh kontratat e publikuara në sistemin elektronik të APP-së të kësaj lloji natyre , të cilat kanë një vlerë shumë herë më të madhe se kontrata e pastrimit që prokurohen nga institucioni jonë.

Kërkesa në lidhje me licencën Mjedisore të kërkuar nga AK është argumentuar në faqen 11-12 të procesverbalit të hartimit dhe përcaktimit të kriterëve me datë 24.03.2021, konkretisht neni 46, pika 1, germa b) e ligjit nr. 9643 dt.20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).

Makineritë janë kërkuar nga njësia e prokurimit mbështetur në Nenin 46, pika 1, germa b, të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Numri dhe lloji i makinerive dhe paisjeve është vendosur duke iu referuar zërave të preventivit, shpërndarjes gjeografike të 11 ambienteve, duke pasur parasysh që disa prej tyre janë nëntokësorë dhe kërkojnë kapacitete më të vogla për t’u aksesuar, sipas grafikut të detajuar dhe kohëzgjatjes së shërbimit. Makineritë e mësipërme janë të lidhura ngushtë dhe në përpjestim të drejtë me preventivin dhe natyrën e punimeve.(Bashkëlidhur dokumentacioni përkatës)

për sa i përket:

- staf inxhinierik, ndër të tjera dhe " 1 (nje)inxhinier gjeolog".
 - "një punësim mesatar i të paktën 50 punonjësve me kohë të plotë pune, për periudhën prill 2018-prill 2019
- 2 (dy) rul deri në 4 Ton dhe 3(tre) Rul mbi 8 ton, ju informojmë se:

Duke qënë se parkimi aktual ishte ndërtuar për të qene provizor dhe pllakat ekzistuese ishin vendosur mbi shtresa toke jo të qëndrueshme (duke marrë parasysh që më përpara kanë qënë fushat stervitore të ekipit Dinamo ,shtresa toke të buta dhe argjila) është vlerësuar nga AK domosdoshmëria gjatë zbatimit të punimeve e një inxhinieri gjeolog, për të vlerësuar formacionet gjeologjike të shtresave të tokës. Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet shprehimisht: 8.“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktues kërkon: b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kriteret mbi stafin janë vendosur në mbështetje të Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8,germa b) e VKM. Nr. 914 datë 29.12.2014 si dhe neni 46 pika 1, germa b) e ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimin Publik (I ndryshuar). Kërkesa prej 50 të punësuarve është në përpjestim të drejtë me preventivin e punimeve pas zberthimit të zërave të punës sipas manualit Teknik të ndërtimit të miratuara me Vendim Nr. 629, datë 15.7.2015 referuar dhe grafikut të punimeve të hartuar nga shoqëria konsulente. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin për zbatimin në afat dhe me cilësi të objektit të kontratës.

Gjithashtu kjo procedurë është një procedurë e rihedhur dhe si rrjedhojë DST kanë ngelur të pa ndryshuara nga procedura e mëparshme si kusht nga APP për arsye se anulimi ka ndodhur në kushtet e mos paraqitjes së asnjë oferte të sukseshme.

Ndërsa rulat 4 ton janë kërkuar për realizimin e punimeve ku si pasojë e vendparkimeve nuk mund të kalohet me

rrulat 8 ton, janë kërkuar 2 rrulat e vegjel nje per shtresat e asfaltit te llojit hekur – hekur dhe nje per shtresat e bazës të llojit gomë-hekur.

Për sa më sipër AK nuk ka specifikuar natyrën e rrulave por i ka lenë të përgjithshëm për të pasur një pjesëmarje të gjerë dhe gjithë përfshirëse në procedurë.

Referuar rekomandimeve të APP njësisë e prokurimit ka marrë në konsideratë sugjerimet dhe ka argumentuar kriteret nëpërmjet e-mail 16.06.2019 dërguar zyrës së kordinimit të APP.

Kërkesat për mjetet janë të lidhur ngushtësisht me zerrat e punimeve të Projekt-preventivit dhe specifikimeve teknike. Per sa I përket kërkeses për tre rrulat mbi 8 ton do të përdoren në zërat e punimeve:

-Shtresë cakulli 2x15 cm përhapur e ngjeshur me makineri zë ky që kërkon një rrul vibrues i llojit gomë-hekur dhe një rul me gunga me kapacitete mbi 8 ton, I njeiti arsyetim vlen dhe për zërin e punimeve shtrese stabilizanti t=10 cm, ndërsa rruli I tretë mbi 8 ton i llojit Hekur-hekur do të përdoret për zërin e punimeve sipas preventivit Shtresë binderi gur kave 5 cm me makineri dhe zërin Shtrese asfaltobetoni gure kave 3 cm me makineri.

Ndërsa rulat 4 ton janë kërkuar për realizimin e punimeve ku si pasojë e vendparkimeve nuk mund të kalohet me rrulat 8 ton, janë kërkuar 2 rrulat e vegjel një për shtresat e asfaltit të llojit hekur – hekur dhe një për shtresat e bazës të llojit gomë-hekur.

Për sa më sipër AK nuk ka specifikuar natyrën e rrulave por i ka lenë të përgjithshëm për të pasur një pjesëmarje të gjerë dhe gjithë përfshirëse në procedurë.

Referuar rekomandimeve të APP njësisë e prokurimit ka marrë në konsideratë sugjerimet dhe ka argumentuar kriteret nëpërmjet e-mail 16.06.2019 dërguar zyrës së kordinimit të APP.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Pas shqyrtimit të observacionit dërguar nga përfaqësuesit e institucionit, në lidhje me kriteret e vecanta të pranimit, ju bëjme me dije se i referoheni një VKM-je të shfuqizuar.

Për sa i përket forcës punëtore, për një procedurë prokurimi me vlerë 15,005,877 lekë pa tvsh, nuk u krijon hapësira për përfshirjen e O.E. të tjerë që mund ta kryejnë këtë punë.

Për sa i përket makinerive të kërkuar observacioni merret parasysh dhe do bëhen reflektimet përkatëse përgjatë materialit.

Në lidhje me pika e tjera të observimit, nuk janë sjellë prova apo fakte të tjera shtesë që provojnë të kundërtën me gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj pranohet pjesërisht.

• Procedura “Master Plan dhe Plan Biznesi për Parkimet e Qytetit të Tiranës” 2021

Përshkrimi i procedurës

Me shkresë Nr. 1118 Prot., datë 28.07.2021 të Drejtorisë së Administrimit të Shërbimit të Parkimit me Pagesë është bërë kërkesë, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, për hartimin e një master plani të përgjithshëm për parkimin publik, për arsye shtrirjes së gjerë të qytetit të Tiranës, shtimit të numrit të automjeteve, përqendrimit të popullsisë në qytetin e Tiranës, frekuentimit vazhdimisht të lartë të parkimeve si dhe problematikave të mungesës së hapësirës së parkimit në zona rezidenciale. Master Plani do të ketë si qëllim të vendosë në dispozicion të Tirana Parking, një dokument i cili përmban një analizë të të gjitha aspekteve të parkimit publik, në mënyrë që kjo e fundit të ketë mundësi për vendimmarrje në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve të parkimit.

Fondi limit

Në vlerën 12,396,667 (dymbëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Master Plan dhe Plan Biznesi për parkimet ” 2021		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 135, datë 16.08.2021		
Lloji i rocedures së Prokurimit: Shërbim Konsulence	2. Njësia e Prokurimit Z. B.K. Z. E. M. Z. K.ZH.	3. Komisioni për Përlllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: Zj. R.B. Zj. D.C. Z. A.M. Zj. F.M. Zj. A.L.
4. Fondi limit (pa tvsh) 13,743,000 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i shtetit	6. Data e hapjes së tenderit 07.09.2021 08.10.2021 dhe 22.10.2022 (propzimi teknik dhe ekonomik)
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës BOE “AR & SA4” sh.p.k OE “NG” sh.p.k BOE “A4” sh.p.k & “ SC” parakualifikuar të tre për fazën e parë b)Për fazën e dytë kualifikuar: BOE “AR” sh.p.k & “SA4” 12,233,000 lekë	8. Komisioni I Vlerësimit të Ofertave Zj. J. F. Zj. E.V. Zj. M.F. Zj. L.D. Zj. V. D. *Zj. M.F. dhe Zj. L.D. specialiste në sektorin e Kontrollit të Projekteve në D.P. Punëve Publike	9. Oferta fituese (pa tvsh) 12,233,000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë shërbimi (konsulence) nr. 1193/12 datë 22.11.2021 Amendim Kontrate nr. 427/2 datë 22.02.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,510,000 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e zbatimin e kontratës Zj. D. Ç. Zj. A. Ll. Zj. L. H. Zj. A. P. Zj. E. Ç. (ka zëvendësuar ish anëtarin Zj. I. M.)	14. Fletë hyrja	15. Afati I kontratës 4 muaj nga data e lidhjes së kontratës 2 muaj shtyrje afati, deri datë 22.05.2022
16.Situacioni përfundimtar/Faturëmalli/shërbimi Fatura nr. 01 dt. 20.05.2022 14,679,600 lekë		

Për përlllogaritjen e fondit limit, Autoriteti Kontraktor (këtu e tutje A.K.), në relacionin përmbledhës Nr. 1118/6 Prot., datë 28.07.2021, është bazuar në studimin e tregut, pas marrjes së ofertave nga tre operatorë ekonomikë(këtu e tutje O.E.):

“LA sh.p.k. në vlerën 11, 890,000 lekë pa tvsh;

“UA” sh.p.k në vlerën 12,200,500 lekë pa tvsh;

“F” sh.p.k në vlerën 13,100,000 lekë pa tvsh.

Në këtë relacion, Komisioni i ngritur për përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike, ka përcaktuar vlerën 13,743,000 lekë lekë pa tvsh për “Master Plani dhe Plan Biznesi për Parkimet në qytetin e Tiranës”.

A.K ka hartuar procesverbalin e datës 23.08.2021 për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, ku në pikën 2.1.4 është argumentuar se numri i punonjësve të O.E është kërkuar 5 persona, pasi mos disponimi i fuqisë punëtore pre 5 personash mund të mos garantojë implementimin e kontratës, afati i së cilës është 4 muaj.

Kontrata e shërbimit nr. 1193/12, midis AK dhe BOE fitues “A” sh.p.k & “S” sh.p.k është lidhur më datë 22.11.2021, me afat 4 muaj kalendarikë.

Më datë 21.02.2022 rezulton të jetë depozituar pranë AK, një kërkesë e Kontraktorit për shtyrje të afatit të kontratës për arsye se ka kërkuar nga disa institucione të dhëna shumë të rëndësishme që mund të cilësohen të domosdoshme për realizimin e një studimi të plotë gjithëpërfshirës. Konkretisht të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, INSTAT, si dhe Drejtoria e Transportit Rrugor pranë Bashkisë Tiranë, të cilat nuk i janë vënë ende në dispozicion, e që kanë rëndësi të jashtëzakonshme për realizimin e këtij projekti.

Kërkesa në fjalë është pranuar nga A.K dhe si rezultat, në po të njëjtën datë me kërkesën është lidhur Amendim i Kontratës (nr. 1193/12 datë 22.11.2021), për shtyrjen e afatit të saj për dy muaj, në datën 22.05.2022.

Nga dokumentacioni rezulton se nga AK nuk ka një vlerësim mbi arsyet e kërkesës për shtyrje nga ana e kontraktorit BOE fitues “A” sh.p.k & “S” sh.p.k. Nuk janë dokumentuar kërkesat e bëra nga Kontraktori drejtuar institucioneve të sipërcituara për të dhënat e kërkuara si edhe vonesat e përgjigjeve nga ana e tyre. Në nenin 19.5 të Kontratës nr. 1193/12, datë 22.11.2021 “Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit” përcaktohet qartë se “....Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Përgjegjës me shkrim për vonesën...”. Njoftimi rezulton të jetë bërë në datën që përfundon afati i kontratës dhe arsyetimi është i pa dokumentuar me shkresat përkatëse mbi të cilat mbështetet ky arsyetim.

AK duhet të kishte kërkuar likuidimin e dëmeve për dorëzimin e vonuar të shërbimit, në bazë të nenit 20 të Kontratës në fjalë.

23. Titulli i gjetjes:	Zgjatja e afatit të kontratës, pa arsyetim
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Master Plan dhe Plan Bisnesi për parkimet”, për vitin 2021, është kërkuar shtyrje e afatit të zbatimit të kontratës nga ana e O.E., e cila është miratuar por nga dokumentacioni rezulton se nga AK nuk ka një vlerësim mbi arsyet e kërkesës për shtyrje nga ana e kontraktorit BOE fitues “A” sh.p.k & “S” sh.p.k. Nuk janë dokumentuar kërkesat e bëra nga Kontraktori drejtuar institucioneve të sipërcituara për të dhënat e kërkuara si edhe vonesat e përgjigjeve nga ana e tyre.
Kriteri:	Nenin 19.5 të Kontratës nr. 1193/12, datë 22.11.2021 “Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit”
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në përmbushjen e objektivave të procedurës së prokurimit
Shkaku:	Mos zbatimi i kushteve të kontratës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Tirana Parking, Komisioni i ndjekjes dhe i zbatimit të kontratës, të marrë në konsideratë të gjitha kushtet e kontratës dhe të garantojë zbatimin e tyre me përpikmëri nga të dyja palët.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

Komisioni i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës zj. D.C., zj. A.L., zj. L.H., zj. A. P. dhe zj. E.C.

Sa më sipër është mbajtur *Akt konstatimi nr. 8*, datë 12.06.2023

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 732/28 prot, datë 13.07.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Për zgjatjen e afatit të kësaj kontrate jemi bazuar në Nenin 19, pika 19.5 i kontratës Nr1193/12Prot, datë 22.11.2021. Bazuar këtij neni, në datë 21.02.2022 është dorëzuar një kërkesë për shtyrje afati të punimeve, kërkesë e cila është bërë 30 (tridhjetë) ditë para përfundimit të kontratës dhe jo ditën e përfundimit të kontratës.

Gjatë takimeve periodike, kontraktori ka dhënë informacion të thelluar mbi ecurinë e punës dhe procesin e marrjes së këtyre të dhënave nga institucionet në fjalë dhe për vonesat e paparashikuara. Rrjedhimisht, gjatë takimeve periodike për monitorimin e kësaj kontrate, kontraktori ka kërkuar shtyrjen e afatit të dorëzimit në mënyrë që dokumenti i prodhuar të bazohej në të dhënat më të sakta të mundshme dhe të ishte në linjë me projektet e tjera që ishte duke implementuar Bashkia e Tiranës. (Bashkëlidhur dokumentacioni përkthës)

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Pas shqyrtimit të observacionit dërguar nga përfaqësuesit e institucionit, grupi i auditimit shprehet që për miratimin/ndryshimin e kushteve të kontratës duhet të analizohet mirë situata dhe pasojat që vijnë nga to. Përderisa janë vendosur afate në zbatimin e kontratës, A.K. nuk mund të shprehet që zgjatja e afateve nuk ka asnjë ndikim mbi punën dhe veprimtarinë e institucionit.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

II.2.5. “Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm”

Sa i përket masave organizative, pas verifikimit mbi zbatimin e rekomandimeve situata paraqitet si më poshtë:

Është zbatuar plotësisht rekomandimi nr. **2.1, 3.1 dhe 4.1**

Janë në proces zbatimi rekomandimet si më poshtë:

1.1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre (Trajtuar më hollësisht në faqet 10-12 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

24.Titulli gjetjes:	i	Rekomandime të cilat akoma nuk janë finalizuar.
Situata:		Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Operatorin e Sistemit të Transmetimit administruar në KLSH me nr. 1682/23 prot., datë 31.07.2019, janë rekomanduar gjithsej: - 4 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 3 masa, , në proces zbatimi 1 masë.
Kriteri:		Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “j”.
Efekti/Ndikimi:		Realizimi i rekomandimeve ndihmon Tirana Parking të arrijë objektivat dhe të përmbush misionin.
Shkaku		Nga ana e shoqërisë ka pasur përpjekje për realizimin e rekomandimeve, por nuk ka arritur t’i realizojë plotësisht.
Rëndësia:		E Lartë
Rekomandimi:		Tirana Parking të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të

lëna në auditimin e mëparshëm, me synim realizimin e objektivave dhe në përmbushjen e misionit të shoqërisë.

Sa më sipër është mbajtur *Akt Verifikimi Nr.1* datë 12.06.2023.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 732/28 prot, datë 13.07.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Ju sqarojmë se, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” Tirana Parking ka kthyer përgjigje me shkresën nr.2/1 prot date 04.02.2020 “Kthim përgjigje mbi verifikimin e zbatimit te rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. Me shkresën nr.2/4 prot datë 03.04.2020 “Kthim përgjigje mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit” si dhe kthimi i përgjigjes për raportin përfundimtar të rekomandimeve është kryer me shkresën nr.2/6 prot datë 25.06.2020.

Për sa më sipër, Tirana Parking, në zbatim të nenit 30, Pika 2, të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” ka kthyer përgjigje për rekomandimet në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh.

Oëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Pas shqyrtimit të observacionit dërguar nga përfaqësuesit e institucionit, në lidhje me të është sjellë i njëjti observacion për gjëra që janë reflektuar në fazën e projekt raportit.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Tirana Parking nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar dhe përditësuar kuadrin e plotë rregullator të shkruar për këtë qëllim. Për periudhën objekt auditimi nuk është krijuar GMS dhe caktuar koordinatori i riskut, nuk ka hartuar një strategji në menaxhimin e riskut, ku t’i kushtohet rëndësi menaxhimit dhe sigurisë së sistemeve të informacionit; mungesa e GMS ka sjellë mungesën e hartimit të planeve strategjike dhe vjetore të njësisë, planeve dhe raporteve vjetore mbi problematikat që hasen dhe parashikim për zgjidhjen e tyre gjatë veprimtarisë së njësisë publike, nuk ka krijuar një strukturë organizative efektive, mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manuali MFK miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i përditësuar me nr. 108/2016.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 6-32 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi 1.1. Drejtori i Përgjithshëm, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin e Planit Strategjik dhe Vjetor institucional dhe Rregullores së konfliktit të interesit, për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për krijimin e GMS dhe caktimin e koordinatorit të riskut, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, të përditësojë Rregulloren e brendshme, gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen

e objektivave të institucionit, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit të njësisë, ku ti kushtohet rëndësi e veçantë menaxhimit dhe sigurisë së sistemeve të informacionit të implementuara, hartimin e planit të kontrollit të brendshëm të unifikuar të njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 1.2. Nëpunësi Autorizues dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, të marrin masa për krijimin e një strukture efektive, ku të përcaktohen kriteret e veçanta për punësim të çdo pozicioni, njoftimin e vendeve të lira në AKPA.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 1.3. Nëpunësi Autorizues dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme të marrin masa për vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë, për të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që i atribuon ligji në dobi të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 1.4 Nëpunësi Zbatues të ofrojë te Nëpunësi Autorizues mbështetje me përgjegjësinë që i ngarkojnë aktet ligjore, në lidhje me ngritjen dhe zbatimin e sistemit të MFK si dhe në rritjen e cilësisë së proceseve të këtij Sistemi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 1.5 Njësia e Auditimit të Brendshëm Bashkia Tiranë, të rivlerësojë Tirana Parking me koeficient rrisht “të lartë”, për të ndryshuar frekuencën e auditimit mbi këtë njësi, me qëllim përmirësimin e performancës institucionale në dobi të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare, rezultoi se shënimet shpjeguese nuk janë të plotësuara me detaje dhe informacione sqaruese të nevojshme për t’u pasqyruar, përveç atyre informacioneve që paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të aktiveve neto/fondeve neto. Plotësimi i tyre është realizuar pjesërisht dhe nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, në të cilin jepen informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë dhe të qartë të pasqyrave financiare në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 3.7 “Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale”, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 32-35 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Tirana Parking, të marrë masat që shënimet shpjeguese të plotësohen në mënyrë të saktë dhe të detajuar, në përputhje me SKK, duke dhënë informacionin e nevojshëm dhe të domosdoshëm për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

Në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Për vitet objekt auditimi 2019 – 2022, në Drejtorinë e Tirana Parking nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit, duke sjellë si rrjedhojë mungesën e vlerësimit të gjendjes reale të aktiveve, amortizimit të tyre dhe përcaktimin për nxjerrje jashtë përdorimit, sipas gjendjes së vlerësuar dhe nevojës në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave

dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik te aktiveve”, pika 95 - 99.

Në raportin e inventarizimit fizik për vitin 2019, komisioni i inventarizimit ka konstatuar se në magazinën e Tirana Parking ka pajisje elektronike të cilat kanë rezultuar të amortizuara, si kompjuterë, ngrohës elektrikë, tableta dhe pajisje për sheshet. Nga ana tjetër, nuk është hartuar asnjë urdhër për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së këtyre aktiveve dhe gjithashtu nxjerrjen jashtë përdorimit të atyre aktiveve, të cilat janë konstatuar në kushte të papërshtatshme për t’u ripërdorur, si pasojë e dëmtimit të tyre përgjatë kohës së qëndrimit në magazinë si dhe në raportin e inventarizimit fizik për vitin 2022, komisioni i inventarizimit ka konstatuar se disa prej tabelave sinjalizuese për institucionin, sheshet e parkimit mbi dhe nëntokë dhe terminalet, që janë të vendosura për sinjalizimin e vendndodhjes së tyre, kanë qenë të dëmtuara. Fenomen ky, i cili ka qenë prezent edhe gjatë procesit të inventarizimit të vitit 2021, por në raport nuk specifikohet nëse bëhet fjale për të njëjtat destinacione të tabelave si të vitit të kaluar, apo për tabela që janë evidentuar vetëm për vitin 2022 në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik te aktiveve”, pika 73 – 74 dhe pika 102.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 37-45 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës në Tirana Parking të merren masat që në vijimësi, procesi i inventarizimit të kryhet i plotë duke kaluar nëpër të gjitha etapat si inventarizimi fizik, vlerësimi i gjendjes së aktiveve dhe nxjerrja jashtë përdorimit për aktivet sipas nevojës, duke u bazuar në gjendjen e tyre reale të amortizimit, të evidentuar gjatë procesit të inventarizimit.

Në vijimësi

4. Gjetje nga Auditimi: Në Drejtorinë e Tirana Parking, si kryetar i Komisionit të Vlerësimit, bazuar në Urdhër i brendshëm Nr. 263, datë 31.12.2020, nr. 1961/1 prot., “Për ngritjen e grupit të komisionit për vlerësimin e aseteve të propozuara për daljen nga përdorimi”, është vendosur Drejtori i Burimeve Njerëzore, që nuk ka qenë nëpunës zbatues i institucionit, siç parashikohet në kuadrin ligjor në fuqi jo në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 99.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 47-48 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, në komisionet e vlerësimit të aseteve, të vendosë si kryetar të këtij komisioni nëpunësin zbatues të institucionit.

Në vijimësi

5. Gjetje nga Auditimi: Duke marrë parasysh faktin që procesi i inventarizimit kryhet çdo vit, konstatimi se ka pasur në magazinë ende bileta të cilave u kishte kaluar afati i përdorimit, është bërë shume vite më vonë nga skadenca e tyre. Ndërkohë që duhet të ishin konstatuar shumë më herët në kohë dhe të ishin nxjerrë jashtë përdorimit vite më parë. Në Tirana Parking, komisioni i vlerësimit ka gjykuar se këto asete (biletat) kanë qenë të papërshtatshme për përdorim të mëtejshëm pasi u kishte kaluar afati i vlefshmërisë, që kishte qenë periudha e viteve 2016 – 2017 në mospërputhje me Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 74 – 80 dhe pika 102.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 48-50 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, pas përfundimit të procesit të inventarizimit të çdo viti, asetet të cilave u ka kaluar afati i vlefshmërisë së përdorimit, të nxirren jashtë përdorimit.

Në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Në Drejtorinë e Tirana Parking, vlera e inventarit për llogaritë 214 dhe 218 të klasës 2 të aktiveve afatgjata materiale dhe llogarisë 327, e paraqitur në raportin e inventarizimit nuk është pasqyruar saktë, pasi ka diferenca krahasuar me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe pasqyrës së pozicionit financiar jo në përputhje me Ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i Ndryshuar; Urdhrin nr. 64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-52 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, të paraqesë saktë dhe të bëjë sistemimet përkatëse, në mënyrë që vlera e llogarive të klasës 2 dhe 3, të paraqitura në raportin e inventarizimit, të përkojë me vlerën e secilës prej llogarive të klasës 2 dhe 3, në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe pasqyrën e pozicionit financiar.

Në vijimësi

7. Gjetje nga Auditimi: Për vitet objekt auditimi, janë konstatuar diferenca për llogaritë e investimeve 230 dhe 231, duke krahasuar të dhënat e paraqitura për secilën prej llogarive në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të financimit dhe faktit të paraqitur në dokumentacionin shkresor jo në përputhje me Ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i Ndryshuar; Urdhrin nr. 64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-56 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, të paraqesë saktë dhe të bëjë sistemimet përkatëse, në mënyrë që vlera e llogarive të investimeve, të përkojë me vlerën e secilës prej llogarive, në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të financimit dhe pasqyrën e pozicionit financiar.

Në vijimësi

8. Gjetje nga Auditimi: Llogaria 475 për vitet objekt auditimi, është paraqitur në vlerë të tjetër në pasqyrën e pozicionit financiar dhe ndërkohë këto vlera nuk janë të njëjta me rakordimet me thesarin, jo në përputhje me Ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i Ndryshuar; Urdhër nr. 64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 56-58 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, të kontabilizojë saktë dhe në vlerë të plotë, vlerën e llogarisë 475 “Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse”, duke bërë regjistrimet përkatëse për këtë llogari.

Në vijimësi

9. Gjetje nga Auditimi: Për vitet objekt auditimi, janë konstatuar diferenca për llogaritë 600, 601 dhe 602 duke krahasuar të dhënat e paraqitura për secilën prej llogarive në pasqyrën e performancës financiare dhe vlerës faktike të paraqitur në dokumentacionin shkresor vënë në dispozicion jo në përputhje me Ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i Ndryshuar, neni 5, 6, 7, 9 dhe 10; Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Urdhër nr. 64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-60 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Tirana Parking të marrë masat që në vijimësi, të paraqesë saktë dhe të bëjë sistemimet përkatëse, në mënyrë që vlera e llogarive të shpenzimeve, të përkojë me vlerën e secilës prej llogarive, në pasqyrën e performancës financiare.

Në vijimësi

10. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Zhvillimi i Platformës për Metodën Alternative të Pagesave të Parkimit”, nuk është zbatuar afati i zbatimit të kontratës nga ku data e lidhjes së kontratës është data 02.08.2022 dhe sipas kushteve të kontratës, duhej që shërbimi të ishte implementuar që me datë 02.02.2023 dhe të ishte në përdorim nga qytetarët.

Gjatë analizimit të situatës dhe nga sqarimi i marrë nga grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, nga verifikimi i kryer rezultoi që aplikacioni mobile ishte i krijuar por që pengesat ishin hasur gjatë krijimit të modaliteteve për pagesat nga palët e treta (marrëveshjet me bankat dhe subjektet e tjera). Nga verifikimi i kryer nga ana e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës mbajtur Memo bashkëngjitur me Nr. Prot 330/2, datë 03.02.2023, me lëndë “Propozim për shtyrjen e kalimit online të metodës alternative të pagesës” me anë të cilit janë paraqitur arsyet teknike dhe ligjore dhe kushtet që duhen plotësuar nga Tirana Parking në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë për të kryer lançimin online të platformës në kundërshtim me Nenin 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 65-90 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Tirana Parking, grupi i ndjekjes dhe i zbatimit të kontratës, të marrë masat e menjëhershme që në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë të implementojë dhe të zhvillojë online platformën për Metodën Alternative të Pagesave të Parkimit dhe moduleve përbërëse të saj dhe aplikacioneve Android dhe iOS.

Menjëherë

11. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike elektrike, telefonike, ngrohje”, objekti i kontratës, nuk përkon me përmbajtjen e procedurës, me preventivin dhe specifikimet teknike. Shkresa e ofertës së marrë nga O.E. fitues është me objekt “Riparim-mirëmbajtje e sistemit të ngrohje-ftohjes me chiller”, objekt i cili përkon me përmbajtjen e procedurës por që është ndryshe nga objekti i procedurës së prokurimit të kërkuar nga A.K. Për sa më sipër, në kundërshtim me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 65-90 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Tirana Parking, gjatë hartimit dhe zhvillimit të procedurave të prokurimit, objekti i kontratës të jetë në përputhje me përmbajtjen e procedurës së prokurimit, në mënyrë që O.E. e interesuar të aksesohen lehtë dhe që pjesëmarrja të jetë e lartë.

Në vijimësi

12. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike elektrike, telefonike, ngrohje” 2022, një pjesë e specifikimeve teknike janë të ekzagjeruara dhe nuk mund të verifikohen nga anëtarët e KVO-së dhe të atyre të marrjes në dorëzim si dhe kanë një vlerë fikse duke mos përdorur termat ekuivalente, jo në përputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 65-90 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Tirana Parking, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke hartuar specifikime teknike të cilët janë gjithëpërfshirëse duke krijuar pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përlllogaritet drejtë fondi limit.

Në vijimësi

13. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje Makineri dhe Pajisje për Parkimet”, nuk është kërkuar katalog për produktet e kërkuara me certifikatë për cilësinë e tyre, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe. Ky kriter është mjaft i rëndësishëm në një kontratë që lidhet me pajisjet dhe makineritë e nevojshme për parkimin si dhe në pikën 2.3.1 është kërkuar që OE duhet të vërtetojë se ka të punësuar në stafin profesional, minimalisht **2(dy)punonjës** të trajnuar për mirëmbajtjen e sistemeve të parkimit të listuara në specifikimet teknike. Pra, janë kërkuar dy punonjës, pa përcaktuar kualifikimin apo arsimimin tyre për pjesën e zbatimit të kontratës (montimin e pajisjeve dhe makinerive) por është kërkuar që të jenë të trajnuar në këtë fushë. Për një kontratë të tillë të rëndësishme, ky kriter është i pa plotë dhe nuk ka argumentimin e duhur për të siguruar zbatimin e kontratës, jo në përputhje me Nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 2 e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 65-90 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Tirana Parking, gjatë hartimit të kërkesave dhe kritereve kualifikuese të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke qenë gjithëpërfshirëse si dhe të krijojnë pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës.

Në vijimësi

14. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i sheshit të parkimit të Selman Stermasi”, për vitin 2021 u konstatua:

Në pikën a) 3.3.11 të DST, nga AK është kërkuar licenca mjedisore e lëshuar nga QKL,për pastrimin, larje rrugësh, fshirje rrugësh(KODI iii 1 A), përveçse e pa argumentuar si kërkesë, ndër të tjera kjo leje mjedisore e tipit C, nuk ka në fokus të veprimtarisë së saj pastrimin, larjen e fshirjen e rrugëve por magazinimin dhe trajtimin e mbetjeve të ujërave të zeza, që nuk ka lidhje me objektin e prokurimit si dhe gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shërbim të Pastrimit dhe Gjelbërimit”, për vitin 2021 u konstatuan kërkesa dhe kritere të vecanta të kualifikimit jo në proporcion me objektin dhe vlerën e kontratës, si më poshtë: staf inxhinierik, ndër të tjera dhe 1 (një)inxhinier gjeolog, një punësim mesatar i të paktën 50 punonjësve me kohë të plotë pune, për

periudhën prill 2018 – prill 2019, në kundërshtim me Nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 2 e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 65-90 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: Tirana Parking, gjatë hartimit të kërkesave dhe kritereve kualifikuese të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke qenë gjithëpërfshirëse si dhe të krijojnë pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës.

Në vijimësi

15. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Master Plan dhe Plan Bisnesi për parkimet”, për vitin 2021, është kërkuar shtyrje e afatit të zbatimit të kontratës nga ana e O.E., e cila është miratuar por nga dokumentacioni rezultoi se nga AK nuk ka një vlerësim mbi arsyet e kërkesës për shtyrje nga ana e kontraktorit BOE fitues “A” sh.p.k & “S” sh.p.k. Nuk janë dokumentuar kërkesat e bëra nga Kontraktori drejtuar institucioneve të sipërcituara për të dhënat e kërkuara si edhe vonesat e përgjigjeve nga ana e tyre në kundërshtim me Nenin 19.5 të Kontratës nr. 1193/12, datë 22.11.2021 “Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 65-98 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: Tirana Parking, Komisioni i ndjekjes dhe i zbatimit të kontratës, të marrë në konsideratë të gjitha kushtet e kontratës dhe të garantojë zbatimin e tyre me përpikmëri nga të dyja palët.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga Auditimi: Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Drejtorinë Tirana Parking, Bashkia Tiranë në KLSH me nr. 1682/23 prot., datë 31.07.2019, janë rekomanduar gjithsej 4 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 3 masa dhe është në proces zbatimi 1 masë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 98- , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Tirana pargim, Bashkia Tiranë të marrë masa për përshpejtimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve të pazbatuara akoma, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1682/23prot datë 31.7.2019 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Drejtorisë Tirana Parkim, Bashkia Tiranë”.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje Makineri dhe Pajisje për Parkimet”, nga e KVO, në momentin e hapjes së ofertave, është kërkuar me anë të emailit që tju vihet në dispozicion katalogu. Dokumentacioni i llojit “Katalog” është dokumentacioni i një rëndësie të lartë, i cili duhej të ishte kërkuar që në hartimin e kërkesave dhe kritereve të veçanta të kualifikimit, në kundërshtim me Pikën c, të nenit 98 të V.K.M- së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” pasi ka pas mangësi të rëndësishme në DST.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 60-98 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1 Rekomandimi: Tirana Parking, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në momentin e hapjes së ofertave, të kryejë vlerësimin e tyre sipas dispozitave ligjore dhe në përputhje me to, si dhe të marrë në konsideratë të gjitha kriteret, kërkesat e kualifikimit si dhe specifikimet teknike duke krijuar kushtet e zhvillimit të një gare në kushtet e plota të konkurrencës.

Në vijimësi

C. Masa për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficence dhe Efektivitet të Fondeve Publike.

1. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shërbim të Pastrimit dhe Gjelbërimit”, për vitin 2022, nga dokumentacioni rezulton se Shoqëria “C” sh.p.k, fitues i procedurës së prokurimit të mësipërm, ka lidhur kontratë qiraje nr. Nr. 4530 Rep. Nr. 1194 Kol datë 16.05.2022 me Shoqërinë “F” shpk. për marrjen e disa mjeteve me qera. Për mjetet e marra me qera sipas kontratës së mësipërme, në dokumentacionin përkatës të mjeteve ka paraqitur edhe certifikatë për transport mallrash për llogari të vet (në emër të “F” sh.p.k), pra certifikata e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, qiradhënësi e ka për përdorim vetjak”.

Dokumentacioni i paraqitur vërteton vetëm faktin se mjetet janë në pronësi të qiradhënësit, por përdorimi i tyre do të ishte i pamundur nga qiramarrësi si në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”, në kundërshtim me Pikën 3, e nenit 92 të V.K.M- së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” pasi ka pas mangësi të rëndësishme në DST, duke e konsideruar vlerën e kontratës prej 8,298,666 si vlerë e përdorur pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 60-98 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Tirana Parking, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në momentin e hapjes së ofertave, të kryejë vlerësimin e tyre sipas dispozitave ligjore dhe në përputhje me to, si dhe të marrë në konsideratë të gjitha kriteret, kërkesat e kualifikimit si dhe specififikimet teknike duke krijuar kushtet e zhvillimit të një gare në kushtet e plota të konkurrencës.

Në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i sheshit të parkimit të Selman Stermasi”, për vitin 2021, nga dokumentacioni rezulton se BOE “V.K sh.p.k & “R.G.” sh.p.k, fitues i procedurës së prokurimit të mësipërm, nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, që bie në kundërshtim me pikën 11gërma (a) të dst-së në të cilën sanksionohet “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (aktin e pronësisë) b)leje qarkullimi; c)certifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (aktin e pronësisë); b) leje qarkullimi; c)certifikatën e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme), në kundërshtim me Pikën 3, e nenit 92 të V.K.M- së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” pasi ka pas mangësi të rëndësishme në DST. Nga KVO është skualifikuar O.E “KC” sh.p.k, me ofertë ekonomike 10,489,512 lekë, në diferencë prej 4,516,316 lekë nga BOE fitues, e cila përbën vlerë të përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 60-98 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Tirana Parking, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në momentin e hapjes së ofertave, të kryejë vlerësimin e tyre sipas dispozitave ligjore dhe në përputhje me to, si dhe të marrë në konsideratë të gjitha kriteret, kërkesat e kualifikimit si dhe specififikimet teknike duke krijuar kushtet e zhvillimit të një gare në kushtet e plota të konkurrencës.

D. MASA DISIPLINORE:

E.1. Për punonjësit në marrëdhënie pune

E.1.2 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statute të parashikuara në ligje të veçanta

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; germat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm, Komisionit Disiplinor**, pranë Institucionit Tuaj, që bazuar në performancën e punonjësve dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

V. Lista e dokumentacionit të auditimit

1. Akt Verifikim nr.1, datë 12.06.2023 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëmi KLSH-së”
2. Akt Verifikim nr.2, datë 12.06.2023 “Të ndryshme të dala gjatë auditimit”
3. Akt Konstatim nr. 1, datë 12.06.2023 “Auditim mbi menaxhimin financiar dhe Kontrollit”
4. Akt Konstatim nr. 2, datë 12.06.2023 “Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit”
5. Akt Konstatim nr. 3, datë 12.06.2023 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve”
6. Akt Konstatim nr. 4-10, datë 12.06.2023 “Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave”

Shënim: Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë Raport Përfundimtar auditimi duhet t’u bëhet prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t’u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT